



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.03.2016, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i opinionit final të Komisionit të Venecias për reflektimin e rekomandimeve të tij në tekstin e rishikuar të projekt amendamenteve kushtetuese të përgatitura nga Ekspertët e Nivelit të Lartë

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Spartak Braho, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Fatmir Mediu

Mungon: Gent Strazimiri

Të ftuar:

Z. Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z. Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Meqenëse kuorumi formohet, duke përjashtuar zotin Strazimiri, mund të fillojmë normalisht mbledhjen e Komisionit të posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, sipas njoftimit që keni marrë për rendin e ditës.

Po ju bëj me dije që së bashku me zotin Halimi kemi zhvilluar një takim javën e kaluar, ditën e premte, në prani edhe të dy ambasadorëve të nderuar; ambasadores së BE-së, zonjës Vlahutin, dhe ambasadorit të Shteteve të Bashkuara, zotin Donald Lu, për të diskutuar dhe për t'u dakordësuar lidhur me metodologjinë për vazhdimin e mëtejshëm të këtij procesi, me qëllimin e vetëm për finalizimin e procesit në këtë fazë të rëndësishme. Është një moment i rëndësishëm, përcaktues për procesin. Kemi një projekt kushtetues, të rishikuar mbi bazën e raportit të ndërmjetëm të Komisionit të Venecias, mbi këtë projekt, të rishikuar dhe të hartuar nga grupi i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtar të atashuar pranë komisionit të posaçëm parlamentar. Komisioni i Venecias ka paraqitur ekspertizën e tij, duke e hartuar dhe miratuar më 11 mars të këtij viti opinionin final për projektin kushtetues që i është vënë në dispozicion. Pikërisht, bazuar mbi këto dokumente, është e nevojshme, që për të bërë gjithë diskutimin e duhur, t'i jepet rëndësia e merituar shprehjes së grupeve politike parlamentare, të përfaqësuara në këtë komision, lidhur me projektin kushtetues dhe vlerësimet që ka dhënë Komisioni i Venecias.

Kemi rënë dakord, së bashku me zotin Halimi dhe me dy ambasadorët e nderuar, që fillimisht të zhvillojmë këtë diskutim, këtë debat politik këtu në komision, ku grupet politike mund të shprehin komentet, vlerësimet, propozimet konkrete rreth këtij projekti dhe vlerësimeve të Komisionit të Venecias, duke diskutuar bashkërisht për zgjidhjet e mundshme, për çështjet që mund të na ndajnë në leximin apo në vlerësimin që u bëjmë çështjeve të caktuara të opinionit të Komisionit të Venecias dhe vetë projektit kushtetues. Nuk është detyrë e lehtë, është detyrë e vështirë, por besoj se me qetësi, me konstruktivitet dhe në funksion të qëllimit të mirë për të pasur një proces sa më të suksesshëm do të mund të japim zgjidhjet e nevojshme. Natyrisht, ky do të jetë hapi i parë.

Hapi i dytë do të jetë funksionimi ose më saktë procesi i rishikimit, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias mbi ato vërejtje dhe sugjerime që ka bërë Komisioni i Venecias dhe ato që do të sugjerohen edhe nga kjo tavolinë. Nga ana e ekspertizës është rënë dakord që këtë rol ta përmbushin dy misione shumë të respektuara, që asistojnë dhe

bashkëpunojnë intensivisht në këtë proces dhe që janë bashkautorë të tekstit aktual që kemi, tekstit kushtetues: misioni EURALIUS i BE-së, i drejtuar nga zoti Rainer Deville, i cili është i pranishëm këtu, faleminderit që jeni i pranishëm, si dhe misioni OPDAT, nën drejtimin e zotit Jon Smibert faleminderit, që jeni i pranishëm, të cilët kanë marrë përsipër detyrën e vështirë, që të reflektojnë në projekt vërejtjet e fundit teknike të paraqitura nga Komisioni i Venecias, por edhe propozimet dhe çështjet që do të trajtohen nga ky komision gjatë debatit politik.

Unë e vlerësoj shumë, besoj edhe në emrin tuaj, i falënderoj ata për këtë kontribut të jashtëzakonshëm që janë duke dhënë në këtë fazë të procesit, edhe për shkak se është një gjë shumë pozitive dhe është meritë e tyre personale fakti që të gjitha palët u kanë dhënë atyre besimin e duhur për ta bërë këtë gjë me shumë sukses.

Natyrisht, sot do të fillojmë me paraqitjen që do të bëjë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, pastaj me grupet e tjera politike, nëse ka tjetër nga opozita, që në rastin konkret është zoti Mediu, dhe në vazhdim nga grupet politike, përfaqësuese të maxhorancës në këtë komision. Siç ju thashë, do të jetë një diskutim ndërmjet nesh në nivel politik, natyrisht me gjuhën e nevojshme kushtetuese dhe ligjore për shkak se po flasim për një dokument kushtetues. Por për çështje që nuk do të arrijmë dakordësinë, kemi rënë dakord që t'u referohemi dy misioneve që do të asistojnë procesin, për të dhënë më pas versionin përfundimtar mbi çështjet që mund të ndahen. Kjo është pak a shumë metodologjia e përcaktuar. Kështu që mund të vazhdojmë më tej me bindjen se kemi hedhur një hap të parë të rëndësishëm, mirëkuptimi, për të shtruar një rrugë konsensusi për mbylljen me sukses procesi në këtë fazë finale.

Kështu që biem dakord t'ia kaloj fjalën zotit Halimi, për të paraqitur propozimet që ka grupi i tij politik lidhur me projektin.

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Dua të them edhe unë dy fjalë.

Sigurisht që takimi i datës 18 ishte shumë i rëndësishëm, i kërkuar me shumë insistim nga ne. Vendimet që u morën aty, në bashkëpunim me dy ambasadorët e nderuar, ishin vendime shumë të rëndësishme për të ecur më shpejt në procesin e implementimit të opinionit të Komisionit të Venecias. Çështjet që tha zoti Xhafaj, pra çështjet teknike, të cilat ekspertët e Komisionit të Venecias a kanë lënë detyrë parlamentit për t'i implementuar, pra si rekomandime, të trajtohen nga dy ekspertët, së bashku edhe me çështjet që do të dalin nga përfundimi i trajtimit të çështjeve politike.

Do të kërkoja, vetëm për pjesën e procedurës, sepse fola pak më parë me ekspertët, meqenëse pak a shumë në takim u la një afat 3-4 ditë, që ekspertët zoti Jon dhe zoti Rainer të përgatisnin një material për rishikimin e këtyre çështjeve teknike, në mënyrë që ne këtu të shmangim atë debatin teknik të ekspertëve. Pra, zoti Rainer dhe zoti Jon të përgatisin një *time table*, sipas takimeve me ekspertët, meqenëse u vendos që secila palë politike do të ketë ekspertët e saj dhe të diskutojnë. Pra, gjatë këtyre ditëve t'i takojnë ekspertët për çështje teknike, t'i sheshojnë gjërat çfarë ata kanë dhe nuk kanë dhe më pas ta minimizojmë takimin tonë të dytë kur do të jetë.

Lidhur me çështjet politike, për të cilat ne kemi kërkuar që të bëjmë një dialog me njëri-tjetrin, t'i shikojmë, t'i trajtojmë. Në fakt është hera e parë që ne ulemi për të dialoguar. Të gjithë e dinë që Kushtetuta është një marrëveshje politike, t'i shikojmë pa emocione. Ramë dakord me sugjerimin e bërë që të ishim pa media, duke ndjekur edhe procesin e dekriminalizimit, por edhe për të ecur më qetë me njëri-tjetrin. Ju e dini që ato 10 çështje janë, të cilat janë te dokumenti i shtatorit dhe i shkurtit, të cilat kemi ndenjur katër orë duke i lexuar dhe nuk ka asnjë shtesë. Pra, po j'ua kursej kohën, që t'i lexoj edhe një herë të gjitha, nga njëshi deri te dhjeta, janë çështje për të cilat nuk janë kushtet të reja, por nuk janë as kushte, janë çështje për të cilat ne kërkojmë t'i debatojmë dhe të gjejmë një zgjidhje. Ju me të drejtë, kërkon konsensusin, ne kërkojmë dialog që të gjejmë konsensusin për këto 10 çështje. Kështu që mendoj të mos i lexoj edhe një herë nga e para, sepse aty i keni dhe nuk kanë ndryshime.

Të fillojmë me një çështje, nëse ngecim, vazhdojmë te tjetra, më pas i rikthehem prapë, e njëjta metodologji për çështje politike.

Si çështje të parë do të doja të trajtonim çështjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund të jetë një çështje e thjeshtë dhe mund të biem dakord menjëherë. *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nga ato 10 çështje që kemi ne, kur të kalojmë më poshtë: Këshilli i Emërimeve, Struktura Institucionale, ILD-ja dhe Tribunali Disiplinor dua t'i përmbledh në një çështje, që ta ekonomizoj kohën, sepse kanë problematika të ngjashme. Ato kanë të bëjnë të gjitha me arkitekturën, me korporatizmin, janë çështje politike. KLGJ-ja dhe KLP-ja kanë një çështje politike. Pra, i kam grupuar të dhjetë çështjet në këtë formë, në mënyrë që të ecim pak më shpejtë.

Pra, çështja e parë që shtroj është çështja e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Si dhe çështje politike për ta diskutuar te seksioni "D", kemi "Ngritjen dhe varësinë", "Njësia e

pavarur hetimore”. Pra, çështja që kemi për të diskutuar është se në varësi të kujt do të jetë nga ajo që thotë: “Venecia”, do të jetë në varësi të Prokurorisë Speciale apo në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm? Këto janë dy paragrafët, do të jetë te njëra apo tek tjetra, ta vendosim se ku do të jetë dhe evadojmë menjëherë si çështje.

Çështjen e dytë që ngre “Venecia”, është varësia e strukturës hetimore dhe e ndjekjes penale kundër korrupsionit, ta marrin dhe ta zgjidhim ku do të jetë, si do të jetë.

Për sa i përket çështjes së tretë, hetimi dhe ndjekja penale, apo emërimi dhe kontrolli i Prokurorisë Speciale; ajo ua rekomandon ligjvënësve ta zgjedhin nëse është autonomi, apo është pavarësi. Ata preferojnë autonomi, ne çfarë do të vendosim? Më pas emërimi i prokurorit të Përgjithshëm është thënë dhe nuk kemi çfarë të themi.

Më pas ka edhe çështje teknike, pas përfundimit për këtë pikë, që ne mendojmë t’ua kalojmë ekspertëve, të cilat i ngre Komisioni i Venecias. Për shembull, kontrolli i thelluar i anëtarëve të strukturave hetimore penale të gjyqtarëve të strukturës së korrupsionit, mbikëqyrjen e rregullave të etikës ndaj prokurorëve, janë çështje që le t’i zgjidhim ekspertët më pas, mbajtja e përgjegjësisë së prokurorit të Përgjithshëm për performancën, detyrën. Këto janë çështje që ne... “Venecia” thotë se duhet t’i shohim, por unë besoj se këto gjëra i shikojnë ekspertët, nuk kemi se çfarë të vendosim. Por duhet të biem dakord për këtë çështje të parë dhe më pas vazhdojmë me çështjet e tjera.

Fatmir Xhafaj – Që të kuptohemi, cili është problemi që keni ju këtu, sepse ne nuk kemi ndonjë problem, ne jemi dakord me këtë? Të paktën unë nuk shikoj ndonjë problem, ju shikoni ndonjë problem? Sepse këtu nuk ka dy qëndrime.

Eduard Halimi – Ka dy. Aty thuhet: Thotë do të jetë nën varësinë e prokurorit të Përgjithshëm apo të Prokurorisë Speciale? Ku do ta lëmë? Ta vendosim tani.

Fatmir Xhafaj – Cila?

Eduard Halimi – Komisioni i Venecias thotë: “Byroja e Hetimit do të jetë nën Prokurorinë Speciale thotë apo nën Prokurorinë e Përgjithshme?”

Fatmir Xhafaj – Ku e ke te “Venecia”?

Eduard Halimi - Te pika 49 “Problemi i propozuar është i ndryshëm. Në disa raste prokuroria e posaçme mbetet formalisht si pjesë e strukturës së Prokurorisë së Përgjithshme, por si njësi e pavarur, kështu që nuk mund të marrë udhëzime nga prokurorë të tjerë. Në raste të tjera është krijuar një zyrë tërësisht e pavarur. Qartësimi i pavarësisë së prokurorëve të posaçëm nga Prokurori i Përgjithshëm që përmban projektndryshimi i rishikuar, në 143, është dispozitë e mirëpritur në zbatim e rekomandimit të ndërmjetëm”.

Fatmir Xhafaj – Ajo që kuptoj këtu është se Komisioni i Venecias ka thënë se kjo është një gjë e qartësuar dhe ka mbështetjen tonë, që do të jetë e pavarur.

Eduard Halimi – Ku do të jetë e pavarur? Do të jetë njësi e pavarur prokuroria?

Fatmir Xhafaj – Prokuroria e posaçme e pavarur me Kushtetutë, me të gjitha. Thotë se është dispozitë e mirëpritur. Pra rregullimi që i kemi bërë, për ne për ata është në rregull, nuk lë vend për diskutim.

Eduard Halimi – Pra, zyra do të jetë e pavarur, po Prokuroria e Posaçme? “Venecia” sugjerojnë që të jetë autonome.

Fatmir Xhafaj – “Venecia” thotë: “Qartësimi i pavarësisë së prokurorëve të posaçëm nga Prokurori i Përgjithshëm, që përmban projekt-ndryshimi i rishikuar, është dispozitë e mirëpritur në zbatim të rekomandimit të opinionit”. Pra, ne e mbyllim këtë dispozitë siç është, e ka vendosur këtu.

Eduard Halimi – Për prokurorinë e posaçme.

Fatmir Xhafaj - E lë siç është.

Eduard Halimi – Tani njësia e pavarur hetimore, ku do të jetë?

Fatmir Xhafaj – Byroja.

Eduard Halimi – Do të jetë te prokuroria e posaçme apo te prokurori i Përgjithshëm?

Fatmir Xhafaj – Patjetër do të jetë te Prokuroria e Posaçme, nuk ka diskutim për këtë. Do të jetë oficeri i Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë së posaçme.

Eduard Halimi – Po, pra se kemi dy opsione, kemi dy modele.

Fatmir Xhafaj - Po, pra siç është në Kushtetutë.

Eduard Halimi – Pra, sipas “Venecias”.

Të dhjeta çështjet sipas “Venecias” i kemi. Njësia hetimore do të jetë pranë Prokurorisë së Posaçme.

Fatmir Xhafaj – Sepse në funksion të asaj do të ngrihet edhe juridiksioni duhet të jetë i ngjashëm me të.

Eduard Halimi – Pika 50: Neni 148 parashikon zgjedhjen e Kryeprokurorit të Posaçëm mes anëtarëve të zyrës, por nuk parashikon autoritetin që bën zgjedhjet. Do të jetë e nevojshme të parashikohet një metodë për zgjedhjet që të përjashtojnë masën më të madhe, më të mundshme dhe jopolitike. Metoda e zgjedhjes duhet të marrë parasysh realitetin që ky zyrtar ndoshta duhet të ndjekë penalisht prokurorë dhe zyrtar të tjerë. Nuk është e qartë përpara kujt përgjigjet Prokurori i Posaçëm, nëse është i pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm. Pavarësia e Prokurorit të Posaçëm nuk do të thotë se ai nuk jep llogari përpara ndonjë autoriteti. Në rast të shkeljeve të rënda Këshilli i Prokurorisë duhet të jetë në gjendje

që ta largojë atë nga detyra, megjithatë pa i hequr atij autonominë që i nevojitet për çështje specifike. Gjithashtu do të ishte e dobishme që të shpjegohet deri në çmasë prokurorët e tjerë të posaçëm janë në juridiksionin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Ju keni ndonjë ide për këtë gjë? Ka ndonjë propozim, apo doni që ta them unë?

Eduard Halimi – Na i thoni një herë ju.

Fatmir Xhafaj – E doni nga ne? Po a e ngritët ju këtë çështje.

Eduard Halimi – Po them çështjet politike...

Fatmir Xhafaj – Si mendoni ju që e ngrini?

Eduard Halimi – Ne mendojmë se Prokurori i Posaçëm, duhet të jetë autonom.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, por nga duhet të zgjidhet?

Eduard Halimi - Prokurori i Posaçëm duhet të zgjidhet nga Këshilli i Prokurorisë.

Si mendoni ju?

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord.

Siç zgjidhet Prokurori i Përgjithshëm, të zgjidhet edhe ky, por i propozohet parlamentit. Ky do të zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Eduard Halimi – Lidhur me realitetin që ky zyrtar mund të ndjekë penalisht prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë nuk e kemi problemin politik këtu.

Fatmir Xhafaj – Mirë t’ua lëmë atyre ta zgjidhin.

Në rregull, ta diskutojmë. Nuk është tabu.

Eduard Halimi – Tani ky prokuror do të hetojë prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë. Do të vendosin 6 prokurorët për ta emëruar këtë prokuror. Jemi dakord? Ka korporatizëm këtu? Klubi i prokurorëve do të hetojë prokurorin që t’i hetojë vetë ata. Ka korporatizëm këtu, si mendoni ju?

Fatmir Xhafaj – Kjo është njësoj sikur gjyqtarët që zgjedhin anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mos shkojnë më në KLGJ. Po ku do të shkojnë gjyqtarët, ata e zgjedhin Këshillin e Lartë Gjyqësor? Prokurorët zgjedhin Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ata do të gjykojnë disiplinarisht dhe do të vlerësohen në karrierë po nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Cili është konflikti i interesit? Korporatizmi nuk krijohet për shkak të faktit se këta janë pjesë e kuorumit të zgjedhur, korporatizmi krijohet kur ka instrumente që u mundësojnë këtyre që të vendosin në mënyrë klienteliste, në mënyrë nepotike apo preferenciale, apo subjektive, pra instrumentet në vendimmarrje. Ai pa dyshim që do të dal nga këta.

Pastaj duhet të keni një gjë parasysh, që nuk janë vetëm 6 prokurorë, janë edhe 5 që vijnë nga jashtë sistemit të prokurorisë që do ta zgjedhin. Pra, balanca nuk është fort e lehtë

për ta bërë këtë gjë, plus kemi parasysh edhe faktin që prokurorët që zgjidhen janë 5 vjet, ky vazhdon me mandat shumë më të gjatë sesa këta. Kjo është një zgjidhje, në qoftë se keni një propozim tjetër?

Eduard Halimi – Ne kemi një problem të madh në të gjithë sistemin e prokurorisë dhe të gjyqësorit. Ku është problemi i madh që kemi, për të cilin ne edhe e nisëm reformën? Problemi i madh që ne kemi është korporatizmi.

Gjyqtarët dhe prokurorët veprojnë si korporatë. Ne kemi dështuar të gjithë, sepse gjyqtarët e korruptuar nuk i kemi hequr nga detyra apo kemi hequr një pjesë të vogël. Për shembull, kur njëri çonte 19 kërkesa, 3 i pranoheshin dhe 16 të tjerat i ktheheshin mbrapsht. Ky ishte dhe është problem. Pse?! Sepse mekanizmi i kontrollit dhe i balancës që kemi ngritur dështoi. Gjyqtarët, siç tha Fatmiri, zgjedhin anëtarët e KLGJ-së. Gjithmonë, me sa mbaj mend, në rastet kur politikat sulmonte ndonjë gjyqtar, ai gjyqtar fitonte me 90% në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Pse?! Logjika është e thjeshtë: na duhet ai më i keqi në krye, sepse, përderisa nuk e gjen gjë atë të keqin, ne të tjerët që jemi poshtë, jemi rehat. Kështu ka funksionuar, të paktën që nga viti 1998, kur unë jam bërë pjesë e sistemit dhe e njoh atë nga afër. Pra, ata zgjedhin njerëzit të cilët do t'i mbrojnë nesër. Kjo është pjesa e korporatizmit. Ka ndryshuar diçka në KLGJ: kemi bërë hapa në reduktimin e numrit të gjyqtarëve, si pjesëmarrja nga 9 kalon në 5 dhe dalja e tyre nga kohë e pjesshme në kohë të plotë etj. Për këtë çështje duhet ta mendojmë më mirë pjesën e mekanizmit “check and balance”, pra ata që e emërojnë dhe ata që e shkarkojnë. Në qoftë se do t'ia lëmë në dorë KLP-së pjesën e emërimit të prokurorit që do t'i hetojë këta gjashtë prokurorë (nuk po hyj tani të çështja nëse do ta kenë të vështirë apo jo), ky do t'i inspektojë dhe do t'i kontrollojë edhe këta të gjashtë, apo jo?! Do t'i kontrollojë edhe këta të gjashtë. Këta të fundit a e kanë mundësinë t'i thonë: “Shiko, ti na kontrollon ne, por ne të shkarkojmë për 5 minuta!”. Çfarë do të bëjë ai me gjyqtarët? “Ti na kontrollon ne. Unë jam anëtar i Këshillit të Prokurorisë dhe vjen ti e më turresh mua për një çështje, por unë të filloj procedurën e shkarkimit”. Kjo çështje nuk i përket opozitës. Nuk është shqetësim i opozitës kjo pjesë e mekanizmit. Ky është shqetësim im për këtë çështje, që ka të bëjë me korporatizmin. Unë do të pyes ndonjërin prej ekspertëve këtu, ndoshta Rainerin, sesi funksion. A mund të shikohet pjesa e korporatizimit tek emërimi dhe shkarkimi i Prokurorit të Posaçëm?

Fatmir Xhafaj – Që ta kuptoj unë më qartë, por edhe kolegët, të cilët mbase e kanë edhe më të qartë se unë. Çështja që ju po ngrini si shqetësimin tuaj personal, është fakti që, për efekt të luftës kundër korporatizmit në sistem, për ta bërë prokurorin e Prokurorisë së Posaçme shumë më eficient në kryerjen e detyrës, duhet të evitojmë një lloj konflikti që ai

mund të ketë me organin që e zgjedh dhe me organin që e shkarkon. A keni ndonjë propozim tjetër, veç këtij që thamë, që mund ta zgjidhe këtë? Besoj se kjo çështje do të shtrohet. Pra, ju e ngritët si shqetësim, por a keni një propozim sesi mund të jetë?

Eduard Halimi – “Venecia” thotë që duhet ta shohim.

Fatmir Xhafaj – Po, është e vërtetë.

Eduard Halimi – “Venecia” thotë që në pikën 50 të parashikohet një metodë për zgjedhjen, që të përjashtojë në masën më të madhe ndërhyrjen politike.

Fatmir Xhafaj – Pra, “edhe zgjedhjen, edhe ku jep llogari”. Te paragrafi i tretë ose i katër thuhet: “edhe ku jep llogari ky njeri”.

Eduard Halimi – Duke pasur parasysh realitetin që ky zyrtar do të duhet të ndjekë penalisht prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë, nuk është e qartë se përpara kujt përgjigjet Prokurori i Posaçëm dhe nëse është i pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm. Komisioni i Venecias, lidhur me pozicionin e prokurorisë, preferon të mos përdorë termat “pavarësi”, por “autonomi”. Pavarësia e kryeprokurorit të Posaçëm nuk do të thotë se ai nuk jep llogari përpara ndonjë autoriteti në rast të shkeljeve të rënda. “Venecia” sugjeron KLP-në. Do ta lëmë KLP-në si sugjerim apo do t’ia lëmë një autoriteti tjetër, që mund të ishte parlamenti?!

Fatmir Xhafaj – Ta zgjidhte?

Eduard Halimi – Jo, do ta zgjidhte. Shikoni se çfarë thotë “Venecia”: “Shqetësimi që kemi ne është llogaridhënia”. Pra, shqetësimi që kemi ne është se ne i emërojmë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, por ata japin llogari te Zoti. Ne i emërojmë edhe prokurorët, por ata japin llogari te Zoti.

Fatmir Xhafaj – Deri dje, kurse nesër do të japin llogari para Këshillit të Lartë Gjyqësor. Do t’i nënshtrohen disiplinës.

Eduard Halimi – Do ta shohim edhe atë pjesë nesër. Jam dakord dhe e përkrah atë pjesë.

Ku do të japë llogari prokurori?!

Fatmir Xhafaj – Ta ndajmë diskutimin. Ashtu siç e lexoj unë, janë tri pjesë: emërimi, shkarkimi dhe dhënia e llogarisë.

Emërimin e bën Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Për kuorumin mund të na japin ndonjë ide. Mund ta bëjmë me 51%, me 2/3, pra ta bëjmë më të përforcuar, që ai të ketë më shumë besim. Për mua, ai duhet të përpiqet të marrë 2/3 e votave në KLP. Ky mund të jetë një variant që mund ta diskutojmë. Kjo bëhet për të përforcuar rolin e tij, pra, nëse do t’i ndanim për një moment, të mos jetë peng as i pesëshes dhe as i gjashtëshes.

Për shkarkimi kemi dy mënyra. Logjikisht duhet ta bëjë organi, por edhe këtu duhet të ketë një kuorum të përforcuar.

Për llogaridhënien ka dy opsione: e para, për çdo rast ai do të japë llogari herë pas here, sepse kontrollohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për punën që i jepet. Çështja që shtrohet është: do të duhet të informojë apo duhet të japë llogari përpara parlamentit, siç bën prokurori i Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit?

Eduard Halimi – Kjo mund të jetë një zgjidhje.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, dakord.

Cili është shqetësimi tjetër? Pra, i dhamë një konfigurim të përgjithshëm. Në qoftë se keni ndonjë ide tjetër...

Eduard Halimi – Propozimi im për këtë çështje është që emërimi, zgjedhja mund të jetë me shumicë të thjeshtë, kurse shkarkimi duhet të jetë me shumicë të cilësuar, për ta mbrojtur. Pra, çfarë duam ne? Ne duam të mbrojmë një prokuror, i cili të mos i trembet as klubit të atyre që kontrollojnë në gjyqësor dhe as klubit të politikanëve që do të kontrollojë. Kështu e kuptoj unë. Emërimi i këtij prokurori, që të jetë i fortë, mund të bëhet larg nesh, sepse në këtë moment parlamenti do të ketë 5 anëtarë atje, por shkarkimi, që ai të mbrohet dhe të mos ketë frikë se do ta shkarkojnë nesër, mund të bëhet me një shumicë të cilësuar, që t'i japë sa më shumë garanci këtij prokurori që të mos e shkarkojnë këta.

Edhe pjesa e dhënies së llogarisë duhet të saktësohet. Një model do të jetë edhe ky që thotë Fatmiri. Pra, siç jep llogari prokurori i Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në parlament, mund të japë edhe ky prokuror për gjendjen e luftës ndaj krimit, që ne e kemi.

Fatmir Xhafaj – E informon.

Eduard Halimi – Edhe kjo mund të jetë një pjesë e shqetësimit të “check and balance”, në mënyrë që atë prokuror ta emërojmë aty dhe të mos ketë frikë as nga gjyqtarët, as nga prokurorët dhe as nga politikanët nesër, pra të bëjmë një prokuror të posaçëm të fortë. Kështu siç e lexoj unë “Venecian”, ajo sugjeron që prokurori i posaçëm të jetë i fortë dhe të mos ketë frikë as nga ata që e emërojnë. Kjo çështje mund të trajtohet edhe më vonë.

Çështjet që kisha unë ishin: vendosja e Byrosë Kombëtare të Hetimit pranë Prokurorisë Speciale; Prokuroria Speciale të jetë autonome nga prokurori, pra termi që përdor “Venecia”. Çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, me rregullat dhe pjesët e zgjedhjes, të emërimit, të llogaridhënies, të raportit “check and balance”, përgjegjshmërinë më tepër dhe forcën e tij mund t'i vazhdojmë këtu ose mund t'i trajtojmë edhe të tjerët.

Pikë tjetër që kam unë është politike. Sipas draftit që kemi këtu të amendamenteve, i bie që Byroja e Hetimit të ngrihet pas 8-9 muajve, pra brenda 6 muajve duhet të zgjidhen

anëtarët e Këshillit të Prokurorisë; anëtarët e Këshillit të Prokurorisë duhet të zgjedhin, anëtarët do të hapin vende dhe do të zgjedhin anëtarët e strukturës speciale, e cila do të zgjedhë drejtorin, kurse drejtori do të zgjedhë më pas anëtarët. Me këtë rreth i bie që Byroja të ngrihet pas 9 muajve. A mund të gjejmë një mënyrë më të shpejtë, që t'i shkurtojmë çështjet? Shqetësimi ynë politik është që Byroja të ngrihet sa më shpejt. Hetimi është proces i përkohshëm. Jemi dakord që do të jetë dhe nuk kemi asnjë shqetësim.

Ngritja e institucionit do të hetojë zyrtarët e lartë, gjyqtarët dhe prokurorët, pra prishmëria që kanë të gjithë qytetarët nga reforma, është largimi i këtyre gjyqtarëve dhe të zyrtarëve të korruptuar dhe shpënia e tyre në burg. Këtë presin qytetarët. Nëse u themi sot se këtë do ta bëjmë pas 9 muajsh, kjo nuk ka ndonjë... Ne duam që kjo strukturë të ngrihet sa më shpejt. A mund ta përshpejtojmë? Në qoftë se e kemi gjashtë muaj, të ngremë brenda 1 muaji. Disa ditë do të duhen të hartojmë edhe pjesën e ligjit (ekspertët tanë do ta kenë gati) për ta bërë sa më... Të mos hyjë byroja në fuqi pas 9 muajve apo 10 muajve siç është planifikuar këtu, por të hyjë për 1 muaj ose 2 muaj.

Fatmir Xhafaj – E para, nuk besoj se kjo është pjesë e projektit kushtetues, por meqenëse ju e hapët, le ta diskutojmë edhe këtë, sepse ka zënë vend edhe në retorikën politike. Nëse e kalojmë sot, do të miratojmë projektin që ka sjellë qeveria. Natyrisht që do të diskutojmë rreth atij projekti, siç për çdo projekt tjetër qeveritar, duke e bërë pjesë të debateve, propozimeve dhe ndryshimeve, por nuk mund ta miratojmë sot për një arsye fare të thjeshtë: është rënë dakord te projekti kushtetues, është e shkruar aty, është e konfirmuar edhe nga “Venecia”, e konfirmuam edhe ne që e mbështesim, që kjo byro do të jetë pranë Prokurorisë së Posaçme Antikorrupsion. Për sa kohë nuk është ngritur me Kushtetutë prokuroria, nuk mund të ngrihet byroja, se do t’i referohet asaj. Kjo do të thotë se menjëherë, me hyrjen në fuqi të normave kushtetuese, duhet të kalojë ligji. Ligji është duke u punuar nga ekspertët. Janë një set ligjesh që nuk do të kërkojnë më shumë se 1 muaj nga dita e miratimit, sepse nuk mund ta bllokojnë situatën. Është ligji për këshillat gjyqësorë, ligji për prokurorinë, ligji unik për gjykatat e posaçme antikorrupsion, ligji për prokurorinë e posaçme antikorrupsion dhe ligji për byronë, të cilat ose do të jenë një ligj i vetëm ose do të jenë të ndara. Varet se si do të vendosim të jenë. Tashmë ato janë në proces draftimi. Sapo të kalojë projekti kushtetues (besoj se edhe gjatë kësaj kohe është duke u punuar; janë ligje me tre të pestat) do të vijë në parlament. Koha 6 muaj është koha tavan dhe nuk është koha dysheme. Kjo do të thotë se edhe Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion dhe KLP-ja mund të bëhen edhe për një muaj pasi del Kushtetuta. Kjo është procedura. Tavani është lënë 6 muaj. Kështu që ne nuk mund të miratojmë byronë, pa miratuar Kushtetutën. Për të gjitha këto ligje që

folëm, ne do t'u lëmë detyrë ekspertëve të punojnë. Ne do të mblidhemi këtu pa pushim. Jo më shumë se 1 muaj nga dita kur Kushtetuta hyn në fuqi, ne duhet t'i kalojmë ligjet këtu, sepse ndryshe bllokojmë sistemin. Kështu që nuk besoj se i gjithë ky proces do të kërkojë më shumë se 2 muaj. Gjithsesi, kjo nuk është një çështje që duhet ta diskutojmë tani. Le ta bëjmë këtë diskutim kur t'i vijë radha. Një gjë është e sigurt: nuk mund të kalojë byroja, pa kaluar drafti kushtetues. Nuk kemi pse e diskutojmë këtë gjë, sepse është një gjë e njohim të gjithë ne, edhe si parlamentare, edhe si juristë.

Eduard Halimi – Byroja nuk mund të kalojë përpara ndryshimeve kushtetuese, në këtë format që vendosëm, pra do të jetë nën Prokurorinë e Posaçme.

Fatmir Xhafaj – Është vendosur ajo. Ashtu është. E mbështesim edhe ne.

Eduard Halimi – Komisioni i Venecias bëri rekomandimin. Ne e mbështetëm, u vendos apo jo. Pra, Byroja e Hetimit do të vendoset pranë Prokurorisë Speciale. Prokuroria Speciale nuk është ngritur. Varianti tjetër do të ishte që Byroja e Hetimit mund të vendoset në një nga alternativat e tjera... Nuk biem dakord që të jetë nën prokurorin e Përgjithshme, kështu që do të jetë nën Prokurorinë e Posaçme. Jam dakord. Nuk ka asnjë problem.

Fatmir Xhafaj – Pse ju e mbronit atë ide?

Eduard Halimi – E thotë “Venecia”, pra mund të jetë ose këtu ose aty.

Fatmir Xhafaj – Se nuk e kam kuptuar që nga fillimi dhe deri tani se cila është ideja juaj dhe propozimi juaj. A keni ndonjë propozim alternativ?

Eduard Halimi – “Venecia” jep dy variante.

Fatmir Xhafaj – Po ju vetë me kë jeni?

Eduard Halimi – Ne jemi vetëm me “Venecian”.

Fatmir Xhafaj – “Venecia” ka dy alternativa.

Eduard Halimi – Me të dyja jemi. Të jetë ose njëra, ose tjetra. Në qoftë se do të jetë nën prokurorin e Përgjithshëm, ngrihej sot byroja, sepse Prokurori i Përgjithshëm aty është. Nëse mendoni se do të jetë nën Prokurorinë e Posaçme, jemi dakord. Nuk do të miratohet një ditë para, por mund të miratohet një ditë pas ose po atë ditë.

Fatmir Xhafaj – Do të jetë paketë.

Eduard Halimi – Po, pra paketë. A mund të bëhen paketë edhe ndryshimet kushtetuese, edhe tri ligjet që do të jenë për byronë?

Fatmir Xhafaj – Të shohim si do të ecim.

Eduard Halimi – Në varësi të kësaj, këtë çështje politike unë e mbyll si çështje teknike. Po i pyes ekspertët edhe sa kohë duhet ta bëjmë paketën. Ne ramë dakord për këtë çështje dhe nuk ka më dyshim. Nuk ka ndonjë lëvizje për këtë. Sa ditë na duhen për byronë,

që ne të kemi gati ligjin për byronë, i cili do të jetë i diskutuar edhe nga ekspertët. Nuk besoj se do të kemi ndonjë problem, përderisa ramë dakord në parim. Këtë përgjigje do të na i japin ekspertët pas 3-4 ditëve, kur të jenë përsëri në komision.

Emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm e kemi...

Fatmir Xhafaj – Me çështjen, për të cilën ramë pak a shumë dakord me rregullimin që i ka bërë projekti kushtetues dhe që e mbështet “Venecia”, i dhamë zgjidhje edhe çështjes së llogaridhënies etj. A keni ndonjë gjë tjetër, jashtë kësaj që diskutuam?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Çështja e emërimit mund të jetë një propozim me shumicë të thjeshtë, çështja e shkarkimit mund të jetë me shumicë të cilësuar, për ta bërë më të fortë. Për këtë gjë ne do të marrim një *feedback* edhe nga ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Kur më pyetët në fillim si e mendoja unë, unë ju thashë që për mua, personalisht, duhet t’i ketë të dyja me kuorume, edhe zgjedhjen, edhe shkarkimin, pra kuorum të përforcuar. Pikëpamja ime me 2/3 i jep zgjidhje asaj që thatë ju: korporatizimit. Pra, nuk e zgjedhin 6 veta, por e zgjedhin 8 veta.

Eduard Halimi – Korporatizmi nuk është te zgjedhja, por është tek ajo që “unë të zgjedh, unë të shkarkoj”.

Fatmir Xhafaj – Po, unë të zgjedh dhe ata të shkarkojnë...

Eduard Halimi – Në qoftë se unë ia pres shkarkimin, pra nëse ne kalojmë te dy te tretat për zgjedhjen, atëherë detyrimisht do të futin duart edhe të emëruarit nga parlamenti. Dakord?

Fatmir Xhafaj – Është me votë të fshehtë...

Eduard Halimi – Ne të dy nuk flasim dot. Në KLD, në KLGJ dhe në KLP ashtu bëhen...

Fatmir Xhafaj – T’jua japim atyre të na japin një version final dhe ta mbyllim pastaj këtë gjë. Besoj se nuk kemi ndonjë çështje tjetër për këtë gjë.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Nuk dua t’u kthehem çështjeve, por besoj se komenti që bën Komisioni i Venecias në lidhje edhe më qartësimin e të terminologjisë që ne duhet të përdorim, nuk mund të lihet kollaj mënjanë. Ata flasin dhe sugjerojnë në mënyrë konkrete që ne të flasim për autonomi në Kushtetutë. Kjo ka të bëjë edhe me komentin që ata bëjnë në kuadër të thjeshtimit, jo vetëm duke hequr pjesë, por duke i bërë pjesët të funksionojnë në mënyrë organike. Kështu, nëse ne Prokurorin e Përgjithshëm, Prokurorinë Speciale dhe Byronë e Hetimit i shohim të shkëputura nga njëra-tjetra, mundet që sot të jemi të kënaqur,

por, pas 5 vjetësh, do të jemi të mërzhitur të gjithë bashkë, sepse pjesët po na përplasen. Për çfarë arsyeje?! Sepse ne sot ndoshta do të krijojmë shkëputje në sistemin e hetimit dhe me produktin që do të kemi nuk do të na funksionojë hetimi ndaj krimit të organizuar, korrupsionit dhe hetimi në përgjithësi. Kështu që gjykoj se duke e parë me kujdes termin, duke kuptuar që për prokurorët të flitet për autonomi, në fakt e thotë Komisioni i Venecias, por besoj se të gjithë e kemi këtë bindje, duke bërë hapa progresi në lidhje me atë që kemi sot, pra një prokurori të centralizuar në mënyrë të hekurt dhe duke ecur në këtë linjë që po diskutojmë së bashku, që mendojmë se është më e mira, duhet të garantojmë funksionimin e rrjedhshëm të të gjithë strukturës, duke filluar nga hetimi bazë, që do ta bëjë byroja, deri te përgjegjshmëria që duhet të kenë aktorët në sistem. Nëse do ta ngremë prokurorin që do të drejtojë Prokurorinë e Posaçme në nivel të barabartë me nivelin e Prokurorit të Përgjithshëm, atëherë po flasim për dy Prokurorë të Përgjithshëm. Madje, Prokuroria e Posaçme do të na bëjë hetimin e çështjeve kryesore, të paktën të atyre që ne shqiptarët kemi problem, që është krimi i organizuar dhe korrupsioni. Pra, nëse do t'ia heqim Prokurorit të Përgjithshëm, këto gjëra të rëndësishme, pastaj këtu do të shtrohet pyetja: Çfarë është Prokurori i Përgjithshëm? Përse na duhet, për më tepër me një shumicë të cilësuar në parlament, për të krijuar krizë në parlament, apo se na duhet një njeri, që jep përgjigjen për të gjithë sistemin?

Këtu, duke garantuar autonominë e hekurt të prokurorisë së posaçme dhe po ashtu, funksionimin e pavarur ose autonom dhe profesional të njësisë së posaçme të hetimit.

Kështu që besoj se nëse do të arrijmë ta ndajmë historinë midis pavarësisë dhe autonomisë, nëse biem dakord për autonomi, kjo do të thotë një rikonceptim të strukturës vertikale të të gjithës. Për fat e kemi mbyllur diskutimin dhe kemi vendosur që byroja do të jetë nën prokurorinë e posaçme. Besoj se këtu biem dakord, por e gjitha duhet të na bjerë në një linjë, pra a do të biem dakord që ta shohim me një lloj vertikaliteti, por me autonomitë që garantojnë që askush nuk i fut duart te kjo, apo do të shkojmë drejt diçkaje që nesër do të themi, se sot na u duk mirë në letër, por që nuk do të funksionojë nesër, se do të përplasen organet me njëra-tjetrën?

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Unë nuk dua të jap alternativa, sepse pastaj është teknike. Ne të gjithë mund të japim alternativa, por kemi rënë dakord që këtë gjë do të na e bëjnë ekspertët.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Fatmir, unë besoj se kur flasim për një autonomi të hekurt brenda prokurorisë së posaçme, kjo do të thotë që ka një raport vertikal, por te hetimi i prokurorisë së posaçme nuk mund t'i fusë duart Prokurori i Përgjithshëm.

Në qoftë se e ndajmë që byroja do të jetë nën prokurorinë e posaçme, e kemi zgjidhur këtë problem dhe e dimë si do të funksionojë.

Problemi lind nëse nuk e zgjidhim qartë këtë pikë dhe kemi dy prokurorë, ai i Përgjithshëm dhe ai i posaçëm, të dy të pavarur nga njëri-tjetri, problemi shtrohet se kush është ky Prokuror i Përgjithshëm dhe për çfarë na duhet dhe do të jemi në një *sui generis*, që mund të na përfundojë në një alteracion kushtetues më pas, prandaj t'i qartësojmë këto gjëra me njëri tjetrin, që ekspertët të dinë ç'të bëjnë, ta ndajnë midis pavarësisë dhe autonomisë të prokurorisë së posaçme, sepse këtë na e shtron edhe Komisioni i Venecias.

E dyta, e mbylla këtë si argument...

Fatmir Xhafaj – Dëshët të sqarojmë shqetësimin, që ky të ketë një lloj varësie nga Prokurori i Përgjithshëm.

Oerd Bylykbashi – Hajde, ta diskutojmë, se autonomia e ka një kuptim në këtë histori. Një lloj varësie e ka gjithmonë. Tani do ta shohim, sepse aty shtrohet edhe çështja: mirë prokurori, por këta janë të tillë nga prokurori apo nga KLP-ja? Ku do ta kenë shpatën e Demokleut këta?

Ku do të japin llogari këta njerëz, nga drejtuesi i prokurorisë së posaçme dhe deri tek anëtari më i thjeshtë? Nëse do t'ua lëmë ekspertëve, ata vërtet mund të gjejnë një zgjidhje, por përsëri mund të na vijnë me 2-3 zgjidhje dhe të na thonë se ata ashtu e mendojnë dhe na e lënë neve ta zgjidhim politikisht.

E dyta që desha të trajtoja, është se nuk ka asnjë lloj problemi ndërkohë që çështja e hetimit të korrupsionit është emergjente, që ne ta shohim të gjithë paketën nga Kushtetuesja dhe deri te ligji, brenda një kohe shumë të shkurtër. E miratojmë dhe e fusim në Kushtetutë dhe në këtë sezon reformash kushtetuese që kemi, e kompletojmë, por e kemi sot të qartë idenë se çfarë do të bëjmë me hetimin, pra nuk po shohim ndonjë pengesë që menjëherë me draftimin e amendamenteve kushtetuese dhe shumë shpejt të ligjit, sapo të jenë gati, të kryejmë edhe procedurën formale të ndryshimit të Kushtetutës, hyrjen në fuqi me kohën e mjaftueshme dhe miratimin e ligjit, por ne do të jemi të qetë, se jemi duke punuar edhe për çështje të tjera. Kështu e shoh unë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Si e shoh unë këtë diskutim që po bëjmë, lidhur me prokurorinë? Mua më duket se drafti, kushtetues e ka zgjidhur mjaft mirë organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni. Pse e ka zgjidhur drejt?

E ka zgjidhur drejt (për t'iu përgjigjur edhe shqetësimin që ngriti kolegu Bylykbashi), sepse në rast se nga e gjithë trupa e prokurorëve, të gjitha niveleve do të kalojë

nëpërmjet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe ky këshill, siç përcaktohet në draftin kushtetues do të jetë *full time*, pra me kohë të plotë. Duke qenë me kohë të plotë, edhe ata që do të vijnë nga radhët e prokurorisë, kanë momentin e parë një shmangie të konfliktit të interesit, pra ky organ do të funksionojë me kohë të plotë dhe vetë drafti kushtetues ka parashikuar që për prokurorët dhe gjyqtarët u garanton pavarësinë, llogaridhënien dhe disiplinën. Pra, çështja e llogaridhënies është zgjidhur në draftin kushtetues, por ky draft për ta shmangur deri në fund korporatizmin dhe konfliktin e interesit, siç e lexoj unë, ia ka dhënë mekanizmin e kontrollit një institucioni tjetër kushtetues, Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

Vijmë te shqetësimi. Nëse zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm drafti e çon në Kuvend, pasi kalon në KLP, drejtuesin e zyrës së posaçme sipas variantit që propozohet dhe më duket se kështu e ka lexuar edhe Komisioni i Venecias, KLP-ja e zgjedh brenda radhëve të prokurorëve të posaçëm. Pra, nuk ka si të kemi 2 piramida paralele dhe garantimi i pavarësisë është te varësia ndaj ligjit penal. Pra, në stadin final shkohet drejt zbatimit të ligjit penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Ky draft garanton funksionimin pavarësisë maksimale të zyrës së posaçme antikorrupsion dhe mua më duket se nga mënyra si është parashikuar në këtë draft, pothuajse kanë marrë përgjigje shqetësimet që ne kemi dhe është krejt normale që t'i kemi këto shqetësime.

Çështja e emërimit dhe e shkarkimit të drejtuesit të zyrës së posaçme, mua më duket se edhe varianti që kryetari thotë se mund t'i japim një mbështetje më të fortë në mënyrën si mund të zgjidhet brenda KLP-së. Vërtet do të zgjidhet nga radhët e prokurorëve të posaçëm, por çështja e mbrojtjes që mund t'i jepet drejtuesit të zyrës, për ta shmangur deri në fund korporatizmin, që ngre kolegu Halimi, është një çështje që mund ta diskutojmë, por mua më duket se gjithmonë në gjykimin tim, duhet të ketë një farë luajaliteti në mënyrën si do të zgjidhet hetuesi i zyrës së posaçme antikorrupsion, sepse secili nga prokurorët e asaj zyre mund të jetë i aftë për të ushtruar detyrën e drejtuesit të zyrës së posaçme, sepse në gjykimin tim, menaxhimi i punës së kësaj zyre është thjesht një drejtim administrativ, sepse kjo trupë prokurorësh do të jetë e pavarur në ushtrimin e ndjekjes penale gjatë hetimit të çështjeve.

Gjithsesi, mund të diskutohet mënyra si mund të komportohet KLP-ja për zgjedhjen e drejtuesit të kësaj zyre. A do të ndjekim të njëjtën metodë, që të njëjtin kuorum që emërohet, edhe do të shkarkohet, apo ndoshta në shkarkim mund t'i jepet ndonjë mbrojtje tjetër? Gjithsesi, kështu siç e lexoj unë draftin, të paktën për pjesën e prokurorisë, mua më duket se drafti e ka zgjidhur mjaft mirë.

Po të shohim edhe opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me këtë strukturë, shkon në këtë drejtim.

Sa i përket njësisë së posaçme, së cilës nuk ka rëndësi si do t'i vihet emri, është e qartë në draftin kushtetues, që ajo do të jetë tërësisht në funksion të prokurorisë së posaçme. Pra, një oficer hetimi pranë kësaj trupe hetimi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Më vjen një njoftim këtu që thotë se PD-ja ka nxjerrë lajmin, që kemi arritur marrëveshjen për byronë e hetimit. Kjo ka dalë në titra dhe nuk është fare korrekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nuk ka rëndësi. Do t'ju kërkoja mirëkuptimin që nëse duam të jemi korrektë dhe seriozë, të gjithë sa jemi këtu, nuk jemi duke punuar për lajmet, por jemi duke punuar për projektin.

Do t'ju lutesha shumë të jeni korrektë!

Eduard Halimi – E mbështes tërësisht qëndrimin e Fatmirit. Asnjëri nga anëtarët nuk duhet të dalë për të bërë lajme. Kur të mbarojmë, secili prej nesh mund të japë deklarata për mediet.

Fatmir Xhafaj – Kemi rënë dakord së bashku që: e para, nuk do të ketë medie në mbledhje dhe e dyta, nuk do të bëjmë deklarata për mediet.

Që kur ka filluar mbledhja unë nuk kam folur asnjë fjalë të vetme për mediet. Kemi rënë dakord për këtë gjë që atë ditë. Kur të mbarojmë procesin, do të themi që e mbaruam procesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në fund të fundit, më i rëndësishëm se mediet është projekti.

Eduard Halimi – Historia e nxjerrjes së mesazheve është histori e vjetër këtu te ne dhe te partitë. Unë them që asnjë nga deputetët, nuk i ka dhënë asnjë deklaratë askujt.

Fatmir Xhafaj - Ndoshta në selinë tuaj ka vajtur lajmi gabim. Po të them se lajmi e ka burimin nga PD-ja.

Eduard Halimi – Në lidhje me çështjen e nenit të draftit kushtetues, kemi edhe variantin e Komisionit të Venecias.

Në draftin kushtetues thuhet, se drejtuesi i prokurorisë së posaçme...

Unë mendoj që këtë njësi ta quajmë “byro të hetimit”, ashtu siç është quajtur dhe të mos themi: njësia e posaçme e hetimit në luftën kundër veprave të korrupsionit e të tjera me radhë.

Një çështje tjetër që thotë Komisioni i Venecias, se kemi byronë, kemi edhe gjykatën speciale, e cila mund të jetë te gjykata, por mund të jetë edhe te prokuroria, është cilësimi i nocionit të gjyqtarit të lartë që duhet ta përcaktojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, është politike, se zyrtar të lartë quajmë që nga Presidenti i Republikës, deputetët dhe deri në fund të gjithë të tjerët. Këtë gjë duhet ta themi.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kjo çështje është ngritur nëpër tryeza dhe nuk është bërë kurrë. Edhe ky përcaktim duhet të bëhet.

Ajo që thotë opinioni i Komisionit të Venecias, është se neni 148 parashikon zgjedhjen, por nuk parashikon autoritetin që bën zgjedhjen. Autoritetin duhet ta bëjë KLP-ja...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj - Ne i mbajmë shënim dhe do t'i zbardhim këto.

Eduard Halimi – Në nenin që kemi duhet ta vendosim.

Fatmir Xhafaj – E thamë këtë.

Eduard Halimi –Duhet thënë se ramë dakord.

Fatmir Xhafaj – Është rënë dakord dhe nuk është ndonjë gjë.

Eduard Halimi – E dyta është çështja që po diskutojmë tani, pavarësia dhe autonomia. Ku do të jetë prokurori i posaçëm? Ku do të jetë prokurori i Përgjithshëm?

Fatmir Xhafaj - Edhe ato i diskutuam dhe ramë dakord.

Eduard Halimi - Çfarë thotë Komisioni i Venecias? Ai kujton rekomandimin nr. 90 të opinionit, që thotë: “Autonomia, roli dhe kompetencat e organeve të posaçme duhet të përmenden të paktën shkurtimisht në Kushtetutë”.

Pra, duhen përmendur se çfarë kompetencash ka prokurori i posaçëm? Ai do të bëjë hetimin, do të shkojë deri në gjykatë, do ta çojë te Gjykata e Lartë. Këto duhen shkruar në Kushtetutë, se nuk i kemi shkruar. Këtë na thotë Komisioni i Venecias: të shkruajmë shkurtimisht në Kushtetutë rolin dhe kompetencat e prokurorit të posaçëm.

Ne jemi dakord me këtë.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, e mbyllim këtë diskutim këtu, meqë janë diskutime politike dhe duhen zgjidhur në mënyrë politike?

Eduard Halimi – Duhet shkruar. Dhe kur të vijmë të shkruara, do t'i diskutojmë se cili është roli dhe funksionimi, kur themi: pavarësi dhe autonomi.

Edhe sot prokurori i Përgjithshëm në dijeninë time, nuk jep urdhër për ndonjë çështje si zgjidhet ajo, por jep urdhra dhe udhëzime me karakter të përgjithshëm. Ju, zoti Manja duhet ta dini shumë mirë, se kështu ka qenë në këto 25 vjet. Kjo është autonomi dhe nuk është pavarësi.

Edhe atje prokurori i posaçëm që do të jetë, kush do ta kontrollojë? Do ta përcaktojmë në Kushtetutë këtë gjë.

Edhe aty duhet ruajtur një gjë e tillë. Edhe kryeprokurori i posaçëm duhet të ketë këtë lloj qasje ndaj prokurorëve të tjerë. Të gjitha këto duhet t'i rregullojmë në Kushtetutë, siç thotë Komisioni i Venecias.

Po jua përsëris se Komisioni i Venecias thotë se duhet t'i rregullojmë në Kushtetutë.

Po ju lexoj paragrafin nr. 12 dhe 13 në faqen 10. Pra, të gjitha këto çështje duhet t'i rregullojmë në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, a mbaruat zoti Halimi? Po përsërisni po të njëjtën gjë. A keni ndonjë merak tjetër?

Eduard Halimi – Jo nuk kemi asnjë merak tjetër politik për këtë pjesë. Këtë do ta shkruajnë ekspertët dhe ne do ta shohim.

Fatmir Xhafaj – Po, është e shkruar. Doni të bëjmë dispozita nga e para?

Eduard Halimi – Nuk është e shkruar fare, Fatmir, se kush do ta zgjedhë.

Fatmir Xhafaj – Po, do t'i vendosim 2-3 elementë.

Eduard Halimi – Nuk është e shkruar fare, Fatmir, se kush do ta shkarkojë. Nuk është shkruar fare roli dhe kompetencat e byrosë. Raporti ndërmjet tyre, autonomia dhe pavarësia, nuk janë shkruar fare. Të na vijë e shkruar dhe do ta diskutojmë. Çështjet në kuadratin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, prokurorisë së posaçme, kanë çështje politike që ne i diskutuam se ku do të jenë si arkitektura, kanë edhe çështje teknike që kanë të bëjnë me rolin dhe me zgjedhjen. Kur të na vijë të shkruara, do t'i diskutojmë përsëri.

Ata i dëgjuan dhe do të na i sjellin.

Fatmir Xhafaj – Po. Shpresoj që ata ta kenë kuptuar gjatë përkthimit nga shqipja në anglisht dhe unë jam i bindur që ata e kanë kuptuar dhe do ta bëjnë mirë këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju doni që prokuroria e posaçme të ketë një lloj varësie nga prokurori i Përgjithshëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, meqë më pyetët mua, a doni ta them?

Oerd Bylykbashi – Unë nuk ju pyeta.

Fatmir Xhafaj – Dakord, shpjegojeni ju!

Oerd Bylykbashi - Autonomia nuk është pavarësi. Autonomia do të thotë që t'i parashikojmë, duke filluar që nga Kushtetuta, një set kompetencash prokurorisë së posaçme, të cilat do të na krijojnë mundësinë që të shkojmë deri në të gjitha detajet, edhe atë që tha zoti Halimi, deri ku do ta çojë çështjen prokurori i posaçëm, pa i ndërhyrë askush, duke e parashikuar në mënyrë të tillë që kur prokurori i Përgjithshëm ta mendojë, ta heqë mendjen që mund të ndërhyjë në çështjen e hetimit, që e kanë këta në kompetencë.

Nëse do ta parashikojmë prokurorinë e posaçme si një organ të pavarur, që është komplet gjë tjetër, jemi para krijimit të një organi tjetër kushtetues, që nuk varet nga prokurori i Përgjithshëm. Kush e tha? A kemi arritur marrëveshje për këtë?

Fatmir Xhafaj - Po, e arritëm. Thamë që prokuroria e posaçme antikorrupsion nuk varet nga prokurori i Përgjithshëm. Kjo është një çështje e mbyllur. Vetëm duhet vënë në projektin kushtetues. Nuk e vëmë në diskutim këtë, edhe Komisioni i Venecias e mbështet.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Po ju pyes nëse buxhetin e prokurorisë së posaçme do ta parashikojmë më vete, apo do të jetë në kuadër të të gjithë strukturës?

Fatmir Xhafaj – Nuk është çështje buxheti.

Oerd Bylykbashi – A jeni të bindur që kjo do të funksionojë siç duhet? A mos jeni duke krijuar dy prokurorë të Përgjithshëm me këtë histori?

Një gjë është struktura, dhe një gjë tjetër është *checks and balances*.

Fatmir Xhafaj - Pavarësinë e zgjidhëm. Autominë e ai e ka të kondicionuar nga KLP-ja. Aty bashkohen të dyja.

Oerd Bylykbashi – Kur është i pavarur nuk ka më autonomi, por është më shumë se autonomia. Pavarësia është tjetër gjë. Kur është autonom ka një raport me KLP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Po, e ka me KLP-në.

Oerd Bylykbashi – Komisioni i Venecias po na flet për autonomi. *Checks and balances* është një koncept tjetër shtesë. Nuk është vetëm në aspektin e ndërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Duke e bërë ne këtë, ndoshta thjeshtojmë sistemin. Po ndërtuam 3-4 elemente, të cilat janë të pavarura nga njëra- tjetra, brenda të njëjtës detyrë, nesër do të kemi eventualisht një dështim të ndjekjes penale për çështje të rëndësishme dhe prokurori i Përgjithshëm, që jep llogari në Kuvend, nuk do të dijë se për ç'të japë llogari.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Oerd Bylykbashi – Po atë e ka shkruar Komisioni i Venecias. Ai ka thënë: autonomia. Hajde të zgjidhim ushtrimin!

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi – Qëndrimi është i qartë.

Arben Ristani - A bihet dakord që duhen shkruar aty edhe kompetencat, siç thotë *footnote* 14, në faqen 11 të materialit të Komisionit të Venecias?

Aty thuhet se të përmenden të paktën shkurtimisht në Kushtetutë roli dhe kompetencat e organeve të posaçme hetimore.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi – Nuk janë dhe duhet të shkruhen.

Arben Ristani - Gjithashtu, duhet të shkruhet në Kushtetutë se kush e emëron dhe me çfarë shumice e emëron, kush e shkarkon dhe me çfarë shumice e shkarkon, kompetencat në mënyrë të shkurtuar, siç i kërkon Komisioni i Venecias.

Eduard Halimi – Besoj se për 3-4 ditë ata do t'i shkruajnë dhe do t'i shohim, në varësi të opinionit të Komisionit të Venecias. Ndërkohë do të bisedojmë me ekspertët tanë për disa çështje teknike, që janë brenda kësaj pakete.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Po brenda byrosë, ka çështje për ekspertët.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Përveç këtyre çështjeve që lindën nga dakordësia politike, dolën edhe disa çështje të implementimit të opinionit të Komisionit të Venecias, lidhur me autonominë dhe me kompetencat, që duhet të shkruhen në Kushtetutë.

Duhet rishikuar edhe kontrolli i thelluar i anëtarëve të strukturave hetimore penale, gjyqtarëve të strukturës antikorrupsion.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Duhet riparë kjo çështje teknike te paragrafi 53, i cili i quan cenim të së drejtës private të tyre, dhënien e *carta bianca-s* shërbimeve të inteligjencës.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Këtu te kjo çështje, kemi çështje teknike dhe çështje politike. Këto gjëra duhet t'i shohim.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Unë do t'ua lë për detyrë t'i shohin.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Mbikëqyrja e rregullave të etikës për prokurorët. Unë po jua them dhe ju përsëri: “Kompetenca e prokurorit të Përgjithshëm për të kontrolluar respektimin e udhëzimeve të përgjithshme të lëshuara prej tij”.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

“Mbajtja e përgjegjësisë për prokurorin e posaçëm dhe Prokurorin e Përgjithshëm për performancën në detyrë”. Përkufizimi “zyrtar i lartë” të shkruhet qartë në Kushtetutë, ku ne biem dakord politikisht.

Kush është zyrtar i lartë në Kushtetutë?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Byroja do të hetojë zyrtarët e lartë. Byroja do të hetojë: gjyqtarët, prokurorët...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Zyrtarët e lartë: një, Presidentin.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Nuk lejohet në ligj. Ta themi këtu, të mos merremi me këtë gjë, se kjo na vjen neve: arrestojmë drejtorin e një komune...

(Deputeti Xhafaj ndërhyr pa mikrofon.)

E rënduam? Ku e rënduam?

Fatmir Xhafaj – Dakord, atëherë...

Eduard Halimi – Çështja është: po të mos hetojë byroja deputetët që marrin fonde. Çfarë do të thotë? Pse do t’i mbajmë prapë ne ata?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Po, sigurisht.

Pra, këto janë çështje...

Fatmir Xhafaj – Deputetë dhe ish-deputetët.

Eduard Halimi – Edhe ish-deputetët, po të gjithë pra zyrtarët: deputetë, ish-deputetë, ish-çfarë tjetër...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Të gjithë “ish-at”, të gjithë ata që kanë, të gjithë të rreshtohen, të mos fshihemi kot! Të rreshtohen të gjithë, kush janë zyrtarët e lartë që do të hetojë Byroja Kombëtare e Hetimit dhe ku do të jenë. Ta përcaktojmë në Kushtetutë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Këto janë çështjet teknike të pikës së parë që thashë unë.

Presim sigurisht *feedback*-un që pastaj...

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo çështje u mbyll tërësisht sipas “Venecias”, kështu që mund të vazhdojmë me pikën e dytë që ju kenë.

Eduard Halimi – Si pikë të dytë kam Këshillin e Emërimeve dhe strukturën institucionale, por kryesisht çështjen e Këshillit të Emërimeve.

Fatmir Xhafaj – Po, parashtrojeni juve.

Eduard Halimi – Çfarë kemi këtu tek emërimet?

Në Këshillin e Emërimeve shqetësimi që ka opozita, i shprehur herët, ka të bëjë me ngritjen e një institucioni shumë të fortë institucional, i cili ka listë emrash prapa dhe për të cilin janë vënë kritere selektive. Dikur është vënë gjyqtari më i vjetër në detyrë, dikur është vënë anëtari më i vjetër në moshë.

Heqja e këtyre kritereve e lehtëson diskutimin, në radhë të parë, për sa i përket përbërjes së Këshillit të Emërimit. Unë e di se argumenti mund të jetë që jo, por mund t'i mbarojë mandati njërit dhe të vijë tjetri, nuk e kam fare shqetësimin se kujt i vjen dhe kujt nuk i vjen mandati, madje është edhe i pabazuar, sepse anëtarit të Gjykatës së Lartë i ka mbaruar mandati prej tre vjetësh dhe vetëm për shkak të tij nuk emërohen as të tjerët, se duan ta mbajnë atje në krye, pra vazhdon të jetë atje edhe pse ka tre vjet që i ka mbaruar mandati. Po për këtë shkak është edhe anëtari më i vjetër në detyrë atje. Kjo trupë duhet të hiqet. Pra, të hiqet ky merak që ka opozita, sepse duke çuar emrat, të cilat na çojnë detyrimisht në afilacion të njëres anë, ne kemi pasur shqetësime se ky Këshill Emërimesh, ky institucion kapet.

Po t'i heqim emrat, zgjidhet ky shqetësim.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Po pra, gjyqtari më i vjetër në detyrë në Gjykatën e Lartë ka një emër, gjyqtari më i vjetër në detyrë në Gjykatën Kushtetuese ka një emër, anëtari më i vjetër në moshë në KLD ka një emër.

T'i heqim këto kritere, them unë, sepse janë selektive dhe mund të përdorim çdo lloj mënyre tjetër që të mos ketë kritere selektive; çdo lloj mënyre tjetër. Pastaj të kalojmë në një diskutim tjetër, që i përket Këshillit të Emërimeve, por të paktën të biem dakord për pjesën e përbërjes. Pastaj për ekzistencën dhe funksionin do të doja të diskutonim në një moment tjetër.

Fatmir Xhafaj – Unë mendoj fillimisht të diskutojmë për ekzistencën dhe funksionin, se në qoftë se nuk ekziston, nuk kemi pse të diskutojmë përbërjen. Ndaj diskutojmë në parim një herë ekzistencën dhe funksionet, pastaj vijmë te përbërja. Jeni dakord? Në qoftë se thua: ekzistenca ra, për çfarë e diskutojmë dhe e bëjmë gjithë këtë diskutim?

Eduard Halimi – Pse e them këtë? Sepse mund të ketë diskutime lidhur me ekzistencën dhe funksionet.

Fatmir Xhafaj – Hajdeni ta bëjmë diskutimin.

Eduard Halimi – Por në qoftë se ne kemi shqetësimin që e keni bërë me hile, në qoftë se i heqim hilenë, rrimë të qetë dhe vazhdojmë diskutimin normal.

Por në qoftë se ju e lidhni patjetër... Kur ju e vendosni Këshillin e Emërimeve me këta tre emra aty, sigurisht që diskutimi nuk do të ketë... Atëherë, diskutimi për funksionin dhe ekzistencën do të jetë problematik.

Unë po e kërkoj në formë analize.

Fatmir Xhafaj – Unë po e filloj me ekzistencën: jeni apo nuk jeni që të jetë Këshilli i Emërimeve? Cila është pikëpamja juaj?

Eduard Halimi – Çfarë qëndrimi keni për këtë gjë, për çështjen e përbërjes? Ja, shtrohet diskutimi, kemi diskutim.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Atëherë, po ju jap një përgjigje të prerë: ne, si dhe “Venecia”, i qëndrojmë parashikimit që ka bërë “Venecia” në, jo pak, 7-8 pika të opinionit, për ekzistencën dhe forcimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

E ka thënë qartë, jo vetëm ka kërkuar të forcohet roli i Këshillit të Emërimeve, nuk po hyj në detaje, e bëjmë edhe në detaje.

Për sa i përket përbërjes, jemi të hapur të diskutojmë në qoftë se ka një formulë tjetër, që e bën shumë më të fortë sesa është. Nuk ka asnjë problem. Propozoni formula konkrete, ekspertët le t’i shikojnë një, dy, tre, pesë variante, nuk ka asnjë problem. Nuk kemi ndonjë merak për formulimin.

Eduard Halimi – Atëherë, lidhur me përbërjen, ju nuk keni merak për pjesën e formulës që është bërë, ne kërkojmë që të mos jetë kjo formulë dhe jemi të hapur për një propozim tjetër.

Propozimi ynë lidhur me përbërjen është: kritere logjike, racionale, që mund të jenë ose ta zgjedhë vetë trupa, ose mund të jetë me short ndërmjet anëtarëve, që të heqim merakun e selektivitetit, por flasim për një anëtar të Gjykatës së Lartë, një anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe një anëtar të KLGJ-së apo çfarë është ajo që do të jetë atje.

Pra, që të heqim shqetësimin që kemi ne, sepse me këto emra ne mendojmë që kapet. Në qoftë se biem dakord për këtë, vazhdojmë diskutimin.

Ju bini dakord që të hiqen kriteret, këto që janë vënë dhe...?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, ne nuk kemi fare...

Eduard Halimi – Nuk e keni merak, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Ekspertët le të na japin një zgjidhje. Ne e quajmë çështje teknike, nuk ka çështje politike.

Eduard Halimi – Për mua është çështje politike, sepse janë emra.

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord, jepni një formulë. Edhe një herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, dakord, keni shumë të drejtë ju. Ashtu siç e lexoni ju po e lexojmë edhe ne, madje për t'ju hequr juve çdo lloj meraku, që ju ta bëni gjumin e pasdites dhe të darkës të qetë...

Eduard Halimi – Po.

Fatmir Xhafaj – Ajo që po ju themi ne është: bëni dy-tre propozime, jepuni ekspertëve dhe këta të fundit le të na thonë: ne i pamë tre propozimet dhe na pëlqeu ky. Dakord jemi dhe e mbyllim teknikisht këtë gjë.

Eduard Halimi – Por ju ikni nga kjo...

Fatmir Xhafaj – Ne nuk kemi...

Është çështje teknike për ne, jo çështje parimore.

Se është më i riu, se është më i vjetri, se është me moshë më të madhe, se është me short, se është me atë, cila të jetë më e dobishmja, më e mira, për të zgjedhur nga ata më të mirin, në funksion të përgjegjësive funksionale shumë të rëndësishme kushtetuese që ka ky institucion. Për të tjerat nuk na shqetëson kjo pjesë.

Eduard Halimi – Kjo është...

Fatmir Xhafaj – Çfarëdo propozimi që do të vijë nga dy zotërinjtë e nderuar, ne do ta pranojmë.

Eduard Halimi – Prandaj është e mirë tryeza, dialogu politik.

Fatmir Xhafaj – Po, madje po ju them edhe një gjë, se e kam lexuar me vëmendje: për të kaluar te më i vjetri në moshë është rekomandimi i Komisionit të Venecias në raportin e ndërmjetëm. Referojuni raportit të ndërmjetëm. Te ky raport Komisioni i Venecias ka kërkuar që të jetë më i vjetri në moshë.

Eduard Halimi – Ku, në KLD?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, te Këshilli i Emërimeve, e keni atje. Nuk ka rëndësi.

Eduard Halimi – Më i vjetri anëtar nga KLD-ja pastaj, se për atë e kemi kriterin.

Fatmir Xhafaj – Jo, mor, jo, më i vjetri në detyrë.

Eduard Halimi – Ashtu e kemi pasur.

Fatmir Xhafaj – Jo, mor, nuk ka qenë ashtu që në fillim.

Te raporti i ndërmjetëm është bërë kjo dhe mbi atë bazë është bërë, e kuptoj unë, tek i rishikuari. Gjithsesi, ne e mbyllëm këtë gjë, le të gjejmë një formulë tjetër që është më interesante, nuk ka problem. Jepni dy-tre opsione dhe ata le t'i vendosin. Nuk kemi asnjë merak të vazhdojmë tek ajo që është e rëndësishme: ekzistenca dhe funksionaliteti.

Eduard Halimi - Për ne ishte e rëndësishme.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Eduard Halimi - Nëse ti thua, se do të vësh Benin, unë kam të drejtën e Zotit si opozitë të them që prit, vetëm Benin mos e vë, sepse e vë në pikëpyetje të gjithë këtë institucion!

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Eduard Halimi – Ke listën me emra. Nuk është çështja as e Venecias as e ekspertëve ndërkombëtarë.

Fatmir Xhafaj – Shikoni raportin e ndërmjetëm, e rekomandon Venecia këtë dhe ata kanë bërë këtë zgjidhje.

Eduard Halimi – Nëse e rekomandon “Venecia”, “Venecia” nuk të rekomandon që për një institucion të jetë mosha, për një tjetër...

Fatmir Xhafaj - T'i unifikojmë si të doni ju, si është më mirë.

Eduard Halimi -....për ata anëtarë të cilët u ka mbaruar mandati, se nuk mund ta mbajnë zvarrë.

Tek Ardian Dvorani, keni mbajtur peng, tre vjet nuk i mbaron mandati....

(Nuk dëgjohet mirë.)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Eduard Halimi – E zgjidhëm shqetësimin për këtë.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me ekzistencën. Duhet të jetë KED-ja. Ju keni pikëpamjen që nuk duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Mendimi im është që KED-ja nuk duhet të jetë fare, sepse ne kemi një detyrim, për ta thjeshtuar skemën, për ta bërë funksionale: a mund të ketë një zgjidhje tjetër më të mirë në lidhje me KED-në? Unë besoj se po, por kurrë nuk e kemi bërë ushtrimin për të gjetur një gjë tjetër. KED-në të përkeqësuar me skemën që keni propozuar

ku është edhe qesharake, por mund ta zgjidhim këtë aspekt qesharak, ku diku është anëtari më i vjetër në moshë, diku është anëtari më i vjetër në detyrë.

Ju thatë: hajdeni ta thjeshtojmë, ta unifikojmë! Unë nuk besoj se kjo është zgjidhja. Nëse ne do të mendojmë se do ta mbajmë KED-në një version: KED-ja kështu apo një gjë e ngjashme me të, ne duhet të mendojmë që KED-ja nuk do të jetë ajo që shpreh shqetësimin të *footnote* numër 3 i këtij raporti përfundimtar të Komisionit të Venecias. Nëse KED-ja është këshill dhe do të na këshillojë ne për figurat më të mira që do të çojmë në sistemin e drejtësisë nuk mundet që KED-ja nga ana tjetër të jetë *de facto* organi emëruar i këtyre funksioneve. Kjo ndodh për faktin se ju e keni menduar KED-në si instrumentin që zhbllokon situatat e bllokimit të votimit në parlament.

Në momentin e parë na duhet një zhbllokim dhe jam shumë dakord, por nuk është ky instrumenti i vetëm, ka edhe të tjerë. KED-ja duhet të filtrojë dhe të skrejojë më të mirët, atëherë hajdeni të diskutojmë këtë! Për ta bërë këtë KED-ja duhet të ketë personalitete të një kalibri të lartë. Hajdeni ta diskutojmë këtë! Si për sa u përket kritereve se cilët do të jenë këta anëtarë të KED-së, si për sa u përket instrumentit se si do të përzgjidhen anëtarët e KED-së. A duhet të jetë KED-ja një instrument, i cili mund të çojë drejt kapjes politike si kjo e sotmja? Unë them, absolutisht jo. Duhet të tmerrohemi nga ideja dhe t'i qëndrojmë larg. Shorti që është i verbër midis trupash elitare, të gjyqësorit tonë, ndoshta mund të jetë një zgjidhje e mirë që është e kundërta e asaj që propozohet sot. A duhet të jetë KED-ja në fund në instancën e fundit organi që *de facto* na ka emëruar neve këta persona? Unë them që jo. Nëse do të më duhet të bëj një kompromis midis ekzistencës së KED-së apo jo, sepse në fund të fundit do të ngre edhe unë dorën time atje në parlament dhe të themi: "Hajdeni ta pranojmë KED-në", se nuk paskemi zgjidhje më të mirë se sa kjo, në mënyrë absolute KED-ja nuk mund t'i kthejë institucionet kushtetuese të emërimit në vulosë të thjeshta. Si? Është shumë e thjeshtë, e thotë deri në gjysmë të vërtetës *footnote* 3 i Komisionit të Venecias. Supozoni që për një arsye ose një tjetër me dashje apo pa dashje organi emëruar u bllokua dhe rasti më i keq është me dashje. Kur pas një rankimi detyruar ose një rankimi kualifikues sipas kritereve, që gjithsesi mbetet subjektiv, ne mund të kemi një dështim të qëllimshëm të organit emërtues siç është Kuvendi dhe për rrjedhojë do të shkonim automatikisht të rankimi. Kush e kapi organin? KED-në dhe nëpërmjet tij bëri rankimin siç i donte qejfi politikisht, nëpërmjet dështimit të mekanizmit ne do të shkojmë tek kjo. Këtë ta thotë *footnote* 3 që është i hidhur, helm. Pra, duhet që ne jo vetëm të vendosim në lidhje me ekzistencën apo jo, por duhet patjetër të diskutojmë për një mekanizëm tjetër emërimi.

Nga ana tjetër, duhet të themi: çfarë pune do të na bëjë ky? Do të na zgjidhë nga ajo te zh-ja hallet e drejtësisë? Jo. Të na bëjë vetëm shortlistimin e kandidaturave, nëse duhet të jetë Pandi dhe jo Oerdi, të jetë Pandi. Pse? Sepse ka një, dy, dhjetë më shumë sesa Oerdi, por jo të jetë edhe vulosësi në fund fare i listës, që të thotë është filani anëtari, sepse mund të kemi instrumente të tjera teknike që do të bënin atë që thotë *footnoti 3*, nuk do ta kthenin në një falsitet dhe nuk do bënin nul organin kushtetues, që është parashikuar për emërimin. Ky nuk është një diskutim i sotshëm, por është shumë i vjetër. Mund t'ju referoj te dokumentet e Komisionit të Venecias dhe të ODIHR-it të vitit 2003 në lidhje me këtë çështje, në lidhje me shqetësimin për kthimin në vulosës të thjeshtë të organeve kushtetuese të emërtesës. Është komplekse si çështje, nuk është vetëm një *tick*, një kryq te kutia dhe të themi se e diskutuam, do jetë apo nuk do të jetë, nuk po e thjeshtojmë sistemin, por po e rëndojmë sistemin. Nëse po, si do ta zgjedhim që të mos ketë selektivitet dhe kapje politike? Kompetenca e tij duhet të jetë edhe në kuadër të *checks and balances system*, duhet të jetë e shkëputur. Ky duhet të merret vetëm me një pjesë, por nuk do të na zgjidhë problemet të tjera. Ka instrumente të tjera për ta zgjidhur. Nëse ne do të duhet të zgjidhim problemin e bllokimit të votimit, duhet të mendojmë për formulat që zgjidhin çështjen e bllokimit të votimit. Ky diskutim bëhet më tutje në dokument.

Hajdeni të diskutojmë dhe ta zgjidhim këtë gjë, sepse pa zgjidhur këtë dhe vetëm të themi: “E kaluam edhe këtë çështje”, nuk kemi zgjidhur gjë.

Pandeli Majko - Unë mendoj se diskutimi ka hyrë në një vijë strukturore normale. Nga diskutimi që dëgjova, të paktën për KED-në, për Këshillimin e Emërimeve në Drejtësi, unë kuptoj se ka më shumë shqetësim për strukturën e brendshme të këshillit sesa për ekzistencën ose jo, të paktën unë kështu e kuptova.

Zoti Oerd, do të doja qartësisht nga Partia Demokratike, të na shprehni nëse jeni dakord me ekzistencën ose jo. Pastaj të kalojmë në një fazë tjetër që të diskutojmë strukturën.

Meqenëse e mora fjalën, do t'ju lutesha të shikonit edhe pikën 11 të Komisionit të Venecias që qartësisht është shprehur për ekzistencën e institucioneve që janë pjesë e draftit. Për sa i përket ndonjë shqetësimi tjetër në vazhdim për Këshillin e Emërimeve, do të shprehem pasi ju të na thoni nëse jeni për ekzistencën ose jo. Ju lutem, me një zë: jeni apo jo?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu - Unë nuk mendoj se ka nevojë për pyetje të tilla, sepse ajo që ngritën zoti Bylykbashi dhe zoti Halimi, shprehën qartë idenë e funksionimit që secili autoritet të ketë përgjegjësinë e tij për mënyrën se si funksionon. Pra, autoritetin që ka

parlamenti mos ta zhvendosim me autoritetin e Këshillit të Emërimeve. Emërimi ose personat në Këshillin e Emërimit të mos jenë paracaktuar paraprakisht. Kjo është. Nuk mbetet për të pyetur më për këtë, çështje. Mbetet për të parë si ta bëjmë funksionale.

Fatmir Xhafaj - Ju lutem, të dëgjojmë zotin Halimi!

Eduard Halimi – Këshilli i Emërimeve, është një debat i hershëm që e kemi pasur para se të fillonin ndryshimet kushtetuese u bë shkak edhe për bllokimin e emërimeve nga Presidenti në Gjykatën e Lartë dhe për mua kryeparagrafi i Komisionit të Venecias 11. Nga pikëpamja teorike është e vështirë të thuhet se cili nga këto institucione të reja nuk është i nevojshëm. I kemi parasysh: KLGJ-ja, KLP-ja, ILDKPP-ja, KED-ja, GJK-ja, GJLA-ja, GJLAD-ja është e vështirë të thuhet se cili nga këto institucione të reja nuk është i nevojshëm. Ka argumente të forta për ekzistencën e të gjitha institucioneve. Do t’jua lexoj të gjithën edhe pse do t’i ndryshojmë aty ku duhet. Në përfundim i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë sistemin e kontrollit dhe të ekuilibrave, kontrollin e balancës. Një sistem i prekur gjerësisht nga korrupsioni mund të ketë më shumë nevojë për mekanizma kontrolli të jashtëm se sa një sistem i shëndetshëm siç mund të jetë ai i Gjermanisë.

Për ta përmbledhur, Komisioni i Venecias është i përgatitur ta konsiderojë të pranueshme strukturën institucionale të propozuar siç është. Si e kuptoj me një fjali: Komisioni i Venecias thotë: “Këtë sistem dhe këtë arkitekturë që keni bërë ju e keni për vete dhe mbajeni për vete. Ne nuk kemi të bëjmë me ndërtimin e strukturës, është juaja, ne jemi të përgatitur ta konsiderojmë të pranueshme, prandaj e bëmë fjalinë e gjatë”. Ky sistem nuk mund t’u shërbejë edhe vendeve të tjera, sepse Komisioni i Venecias thotë dhe për vendet e tjera, por ju takon juve thotë nëse jua zgjidh hallin me kontrollin dhe balancat. Çfarë halli kemi ne? Hallin që kisha jua zgjidha politikisht. Unë mendoj që kishte një hile, më thonë se nuk ka, sepse ne e heqim, unë e zgjidha hallin. Çfarë problemi kanë të tjerët? Është politike, kontrolli dhe balanca.

Sa na i zgjidh ne Këshilli i Emërimeve kontrollin dhe balancat? Këshilli i Emërimeve përbëhet nga kryetari i Gjykatës së Lartë, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, kryetari i KLGJ-së, kryetari i KLP-së, Prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Dhomës së Avokatisë, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, pra janë në mos gaboj pesë gjyqtarë, dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe një prokuror. Kjo është pjesa e Këshillit të Emërimeve. Ky i fundit do të bëjë të gjithë procesin për diskutimin që nuk dua ta përsëris për të mos u mërzitur, te çështjet e tjera te tribunali dhe arkitektura, sepse këtu përmblihen. Këtu do jenë pesë gjyqtarë dhe dy të Gjykatës Kushtetuese, pra shtatë, do të kemi edhe gjashtë gjyqtarë që do të jenë të këshilli

gjqësor, te KLGJ-ja. Pra, shkuan 11, do të kemi edhe shtatë te Tribunali Disiplinor. Shqetësimi i Oerdit është legjitim, por është në lidhje me parlamentin, *check and balance* është interesant dhe shumë i drejtë, këto do të shkojnë te tribunali disiplinor të gjithë gjyqtarët, pjesa e (*incizim i dobët*) të gjyqtarëve dhe do të kemi inspektorin e lartë të drejtësisë i cili do të inspektojë edhe anëtarët e këshillit të KED-së, i ka nën hyqëm me përjashtim të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjithë anëtarët e Tribunalit Disiplinor, ky person i vetëm. E bukura është që sipas parashikimeve, me amendament edhe inspektorin e emërojmë ne, por e shkarkon tribunali. Këtë nuk e kuptoj shumë, e emëron parlamenti dhe e shkarkon Tribunali. Ky inspektor, i vetmi në këta 18 gjyqtarë të klubit të gjyqtarëve që do të vendosë edhe për emërimin, do të bëjnë rankimin, edhe propozimin, pastaj do të jenë po këta 18 gjyqtarë që do të mblidhen në KLGJ, që do të shikojnë nëse këto çështje të shkarkimit të gjyqtarëve, të ndonjë gjyqtari të korruptuar, ai që liroi trafikantin nga Franca, do ta shkarkojë apo jo? Pra, do të vendosin këta gjyqtarë, pastaj kundër vendimit do të shkojmë përsëri te klubi i gjyqtarëve, te Tribunali Disiplinor. Te Tribunali Disiplinor do të jenë përsëri gjyqtarët dhe shumë-shumë mos merret inspektorati, një tek që është, sepse dhe këtë e shkarkojnë nëse bën ndonjë kërkesë të çuditshme për shpërdorim detyre. E gjithë kjo skemë këtu sipas meje, është një skemë që nuk garanton *check and balance*, atë që thotë Komisioni i Venecias. Mund ta pranojmë politikisht të ngremë duart lart, ne do të mendojmë t'ia çojmë këtyre. Këta 18 gjyqtarë do të vendosin mbi gjithçka. Po hoqëm këta tre emrat që i hoqëm, emrat e tjerë janë me listë: kryetari këtu, kryetari këtu, të gjithë shefat. Ky organ “superfuqi” që thoshim ne, që thoshte në opinionin e ndërmjetëm Komisioni i Venecias: kujdes kujt ia jepni të gjithë këtë fuqi, sepse këta do të vendosin se çfarë do të bëhet, do të jenë këta qeveria e ekzekutivit, gjithçka. Këta do të shndërrohen totalisht në një korporatë. Unë e thashë dhe në fillim të 18 gjyqtarët janë që zgjedhin sot anëtarët e KLGJ-së dhe të gjithë piramidën tjetër, këta e zgjedhin. Ne e kemi problem, sepse sistemi gjyqësor është i sëmurë dhe ne po ia lëmë të sëmurit totalisht përgjegjësinë për t'u dalë në ballë. Ky është diskutimi, quheni filozofik, po të doni edhe idiot, nuk ka rëndësi.

Të kthehemi te KED-ja, nëse ne do t'u lëmë këtyre të marrin vendime siç është rankimi apo t'ia imponojmë parlamentit, këta zotërinj nga i pari deri tek i fundit, për vendimet duhet të kenë përgjegjësi apo jo? Nëse ne i lëmë të sugjerojnë çfarë të duan ata, të bëjnë rankime çfarë të duan ata dhe nuk japin llogari para askujt, ne nuk kemi bërë gjë të mirë, besoj. Pra, këta, po bëj një hap pas, do t'i pranojmë, sepse ky është diskutimi, nëse do ta mbajmë këtë skemë. Nuk doni ju, nuk është korporatë. Po eci për t'jua thjeshtëzuar: do japin përgjegjësi këta? Do të mbajë përgjegjësi kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sepse propozoi për

anëtar të Gjykatës Kushtetuese një bandit? Problemi i madh që ka sistemi, ne e dimë të gjithë është mungesa totale e llogaridhënies dhe e përgjegjshmërisë. E kemi zgjidhur për Gjykatën e Lartë, jam shumë dakord, do të japë llogari te KLGJ-ja, edhe për të tjerët, për vendimet. Po për procesin disiplinor do të kenë llogari këta? Kush do të mbajë përgjegjësi nëse trafikantin e drogës së Francës, inspektori e çoi në KLGJ, shkoi në Tribunalin Disiplinor dhe ia rrëzoi kërkesën, si do të dalë nesër Kryeministri, Basha, Rama, Majko, kushdo të jetë...*(incizim i dobët)* Pse? Sepse nuk funksionojnë. Pse nuk funksionon korporata. Ne jemi në një moment historik për të vendosur një raport *check and balance* në këtë proces. Ata njerëz nëse KED-së do t'i japin pushtet për të dhënë vendime, ata duhet të mbajnë përgjegjësi, nëse do t'i japim pushtet për të dhënë sugjerime, atëherë mund të mos kenë përgjegjësi, por nëse do të japin pushtet për të marrë vendime, për të bërë ankimin dhe çfarë kompetencash kanë.

Ne *(incizim i dobët)* verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore dhe profesionale, jo gjyqtar për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si edhe kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese që emërohen. Këshilli i Emërimeve shqyrton... *(incizim i dobët)* kandidatët. Ky është vendim. Emëron, e skualifikon, e kualifikon dhe bëra edhe renditjen. Pika 1, neni 149, germa “ç”. Unë dua që këta njerëz të mbajnë përgjegjësi nëse shkelin ligjin dhe mund të shkarkohen për këtë shkelje të kësaj pike. A mundet të mbajë përgjegjësi kryetari i Dhomës së Avokatisë para parlamentit? Çfarë pune ka kryetari i Dhomës? Nuk e kam fare me emra. Ika nga emrat, në momentin që ikën këta të tre u zhvesha nga emrat jam i ftohtë, nuk më intereson fare. Është sot kryetari i Gjykatës, do të jetë nesër një tjetër, nuk ka rëndësi, por nëse atyre do t'u japim këtë pushtet, ata duhet të japim llogari, sepse kontrollin dhe balancën te Këshilli i Emërimeve ne e kemi zero. Do të ketë pushtet parlamenti *check and balance*?

Lidhur me Këshillin e Emërimeve, po e mbajtëm kështu siç është për mua është korporatist. Po e pranuat korporatizmin, ne nuk besoj se do të themi nuk e votojmë këtë nen se është korporatist, nuk e di do të jetë vendim ndoshta i më vonshëm. Shqetësimi ynë ky ishte, heqja e emrave. Për korporatizmin do të dalë secili nga ne, sipas radhës nesër, do të mbajë përgjegjësi dhe do të thotë ne ndërtuam sistemin që ishte i gabuar. Prandaj e thotë paragrafin 11 Venecia.

E njëjta gjë do të jetë për ta lehtësuar diskutimin që të mos e marr fjalën edhe te tribunali disiplinor. Edhe te Arkitektura këtë diskutim kanë. Nuk hiqet KED-ja, edhe te tribunali disiplinor e kanë diskutimin më pas. Te tribunali disiplinor të gjithë thoshin përse të jenë të gjithë gjyqtarë. Edhe aty korporata është në majën e vet. Nuk kemi asnjë procedurë për *impeachment*, do bëjmë procedurë për *impeachment*? Kjo është çështje politike. Këtë e

diskutojmë ne, të na funksionojë sistemi, të na funksionojë makineria, sepse nuk na funksionon. Nuk na ka funksionuar, ka dështuar. Do të bëjmë këto për tribunalin disiplinor, për inspektorin e lartë të drejtësisë, është diskutimi politik i emërimit, do t'i them sërish ... (*incizim i dobët*) kërkesa e KED-së dhe pjesa e arkitekturës. Shqetësimi që kam për të dyja çështjet, prandaj i bashkova për të ecur pak më shpejt, pjesa që kam unë është: heqja e emrave për ne zhvesh problemin politik. Tek Tribunali Disiplinor janë vendosur emrat që do të jenë që sot, thotë duhet të jetë ky, ky, ndërkohë që mund të gjendet një mënyrë tjetër, besoj mund të bihet dakord që të mos jenë.....prandaj ...po ta di unë që në Gjykatë Tribunale do të kem gjithmonë Ulsin, Spartakun dhe Vasilikën, atëherë e kam të thjeshtë dhe do mundohem t'u gjej njerëz këtyre, por mund ta shkartojmë. Mund të jetë edhe me short. Ato gjëra mund të zgjidhen, që të mos jenë gjithë jetën këta. Për shembull, sa kohë të jetë Ulsi atje kryetar i Gjykatës, do të jetë tribunals?! Pra, mund ta shkartojmë atë.

Fatmir Xhafaj – Mos fol kështu, sepse duket sikur nuk e ke lexuar projektin. Nuk ka si të jetë ai, sepse për 3 vjet është kryetar i gjykatës. E zgjedh vetë trupa. Nuk ka si të jetë 30 vjet.

Eduard Halimi – Mirë, pra për aq vjet sa është.

Fatmir Xhafaj – Kjo tregon sikur nuk e ke lexuar projektin.

Eduard Halimi – Zoti Fatmir, unë e njoh germë më germë projektin dhe për këtë të jesh i bindur.

Fatmir Xhafaj – Me the që ai do të rrijë tërë jetën, por ai nuk rri më shumë se 3 vjet kryetar i Gjykatës Kushtetuese apo kryetar i Gjykatës së Lartë.

Eduard Halimi – Kryetar i Gjykatës së Lartë nuk është 3 vjet, por 9 vjet.

Fatmir Xhafaj – Nuk rri kryetar... Është këtu.

Eduard Halimi – Kur ta ndryshojmë ligjin?!

Fatmir Xhafaj – Jo, është këtu.

Eduard Halimi – Nëse do të bëhet me shkartisje për Tribunalin Disiplinor, le të bëhet. Mund të mos jenë ata. Ky është problemi që kanë Tribunali Disiplinore. Te Tribunali Disiplinor ia kemi lënë klubit të gjyqtarëve të gjitha.

Fatmir Xhafaj – Mbarojmë KED-në, sepse po ngatërrohem.

Eduard Halimi – Jo, nuk po e ngatërroj. Bëra diskutimin e Këshillit të Emërimit.

Fatmir Xhafaj – Është dakord të jetë KED-ja?

Eduard Halimi – Pjesën e KED-së e bëra të qartë: heqja e 3 emrave zgjidh problemin politik që kemi. Ekzistenca e Këshillit të Emërimeve pikë së pari forcon korporatizmin, nuk ka “*check and balance*” dhe, është ajo që thotë Komisioni i Venecias, të

cilën e lexoi zoti Bylykbashi, korporata do të përdorë një mënyrë për të mbuluar akoma më shumë, duke i vënë kusht parlamentit apo kushdo qoftë. Në këtë mënyrë sesi funksionon KED-ja është korporatë. Duhet dëgjuar edhe argumenti që nuk është korporatë. Nëse ngulni këmbë që është korporatë dhe që ta mbajmë korporatë, siç është, edhe ne më pas do të mbajmë qëndrimin politik për ekzistencën e saj. Isha i qartë, zoti Pandi?

Fatmir Xhafaj – Tani, që t’i marrim gjërat me radhë, paragrafi 11 që lexuat ju nuk ka të bëjë me KED-në, por me arkitekturën e sistemit. Nëse ju keni vërejtje për arkitekturën e sistemit, kjo është një çështje tjetër. Të gjithë në këtë vend thonë: rroftë “Venecia”! Kemi rënë dakord nga mëngjesi deri në darkë që i gjithë diskutimi do të jetë në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias. Kështu keni thënë?! Kemi rënë dakord të gjithë dhe nuk e kemi vënë në diskutim. Të vetmen gjë që i madh dhe i vogël në këtë vend, kryetar partie, Kryeministër, ish- kryeministër, President, deputetë bien dakord për një gjë: rroftë “Venecia”. Atëherë, kemi vënë një kornizë, jemi ulur këtu dhe kemi thënë: “Nuk do të dalim nga Komisioni i Venecias”, sepse nuk dalim dot më nga kjo histori për hir të së vërtetës dhe për këtë arsye praktike. Komisioni i Venecias e ka shkruar e zeza mbi të bardhë që kjo arkitekturë mbetet për ne. Ne e mbështesim këtë arkitekturë. Pra, ne e pranojmë këtë në kushtet konkrete. Po lidh me paragrafin e mëparshëm: “...një sistem i prekur gjerësisht nga korrupsioni mund të ketë më shumë mekanizma kontrolli të jashtme sesa një sistem i shëndetshëm. Për ta përmbledhur, “Komisioni i Venecias është i përgatitur ta konsiderojë të pranueshme strukturën institucionale të propozuar ashtu siç është”. Nuk kemi si e lexojmë ndryshe. Po ta lexojmë ndryshe, le t’u themi atyre zotërinjve që i pranuan në këtë rol, por ne kemi dy lexime. Për ne arkitektura nuk preket. Kështu e lexojmë këtë gjë.

Shkojmë te Këshilli i Emërimeve. Qofsha unë i gabuar! Çfarë është Këshilli i Emërimeve? Këshilli i Emërimeve është një organ konsultativ, pra konsulton dhe nuk ka vendimmarrje. Këshilli i Emërimeve është një filtër ndërmjet propozimeve që vijnë dhe organit të emërtesës. Por Këshilli i Emërimeve nuk e obligon parlamentin. Këshilli i Emërimeve thotë: “Për ne nga pikëpamja e vlerësimit të meritës janë 1, 2, 3, 4 apo 5”. Parlamenti mund të marrë edhe të pestin, nuk e pengon ai, por parlamenti do ta argumentojë publikisht dhe politikisht për qytetarët e vendit pse e bëri këtë zgjedhje? Pra, të thotë: “E bëra këtë zgjedhje, sepse renditja që kanë bërë ata nuk më pëlqen, sepse gjykoj se ky i treti është zgjedhja më e mirë”. Do ta bëjë me mënyrën e votimit që do të dojë parlamenti: me 2/3, me 3/5, me formulën A, me formulën B apo me formulën C. Pra, parlamenti do të jetë sovran në vendimmarrjen e tij. Ai nuk e kushtëzon, por e orienton dhe i thotë: “Në vlerësimin tonë, në bazë të meritës, duhet të jetë ky lloj rankimi, kjo lloj renditje, më pas parlamenti

është i lirë, sovran të vendosë. Por ju thoni: “Po nëse parlamenti nuk vendos dot”... Është i pafuqishëm të vendosë, është e pamundur ta thyejë...

Ka pesë propozime, nuk voton asnjëri, i rrëzojnë të gjithë. Po, duhet t’i zhblllokojë, sepse mund të vejë sërish si situata e sotme. Është i detyruar të zgjedhë një nga ata. Le të zgjedhë të dytin. Nuk zgjedh të dytin, zgjedh të tretin, nuk e pengon njeri parlamentin për këtë gjë. Parlamenti është sovran. Por situata duhet zhbllokuar, që të mos bllokohet nesër.

Tani, të vëmë pak më tutje. Kush janë këta?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Parlamenti. Dakord, por prit një sekondë. Nuk e marrin, dakord.

Por ata janë korporatë sipas teje, por nuk janë korporatë sipas meje. Pse nuk janë korporatë sipas meje? Sepse jo çdo bashkim gjyqtarësh dhe prokurorësh është korporatë, në konceptin e korporatizmit, sepse nuk do të kishim as KLGJ, as KLP, asnjë gjë prej gjëje, sepse ata, po të mblidhen tre veta, qenkan korporatë. Jo, korporatën nuk e dikton fakti i përbashkët që vijnë nga gjyqësori, e para.

E dyta, le t’i marrim me radhë. Kush janë këta? Është Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Kush e ka vënë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese? Trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese presumohet se do të zgjedhë më të mirin prej tyre. Pra, është Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i cili e bën mirë atë detyrë. Pra, nuk rri merret*(Nuk dëgjohet)*, siç thoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Është i lëvizshëm. Është Kryetari i Gjykatës së Lartë. Ka të njëjtin sistem, por është Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative. Të zgjidhen dy gjyqtarë në gjykatat respektive, por kriteri që është vënë qenka me emra. Por do ta bënim, siç thatë ju, me short, ku e di unë se çfarë, me zgjedhje nga vetë trupa, me çfarë të doni ju, nuk ka asnjë problem. Pra, do të thotë se këta janë njerëz që zgjidhen në mënyrë të rastësishme dhe nuk zgjidhen nga politika. Por çfarë bëjnë këta? Këta ndihmojnë që zgjedhja ndërmjet profesionistëve të jetë më e mira. Pra, nëse gaboit trupa kur e zgjedhi, kur e propozoi, ka një filter të dytë, që do ta ndihmojë parlamentin, që është trupa vendimmarrëse, se është parimi *check and balance* që do ta ndihmojë për ta balancuar këtë, që të arsyetojë sa më mirë në vendimmarrje.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, sepse vendimmarrja është e parlamentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Është pjesë e një pushteti, siç është pushteti gjyqësor. Pra, ky pushtet do të finalizohet me këtë përzgjedhje, me këtë ankim. Pushteti tjetër do të zgjedhë ndërmjet këtyre

të dyve. Në qoftë se njëri nga pushtetet është i paaftë të veprojë, ne nuk do ta lëmë situatën të bllokuar. Kjo është filozofia e gjithë këtij projekti.

Më duket se Venecia ka qenë shumë e qartë. Në qoftë se ka një insion, që nuk e ka vënë fare, fare, në diskutim, është Këshilli i Emërimeve. Madje, në mos gaboj, Venecia ka shkuar edhe përtej parashikimit që kanë bërë ekspertët, ka kërkuar që t'i japë më shumë rol Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pra, do të thotë se për Venecian, për arbitrin që kemi zgjedhur ne, Këshilli i Emërimeve jo që nuk diskutohet, por “duhet të forcohet”, - thotë Venecia.

A do ta forcojmë ne? Unë mendoj se do ta forcojmë, sepse do të dëgjojmë Venecian, sepse kemi rënë dakord ta dëgjojmë, e kemi pranuar që ta bëjmë sipas Venecias dhe Venecia na thotë: “Nuk mjafton kaq sa i keni dhënë, jepini edhe më shumë, që ai të jetë një filtër edhe te zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues, edhe te zgjedhja e vetë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. E thotë Venecia, e keni te paragrafët 16, 20, 24, 38, 40, 80, 82 e me radhë, që flasin për rolin e Këshillit të Emërimeve. Prandaj, ai thjesht është një organ konsultativ në këtë funksion që thatë. Nuk është absolutisht shqetësim sepse bëhet.

Sot është iksi Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, nesër nuk do të jetë, do të vijë tjetri. Sot është ypsiloni Kryetar i Gjykatës së Lartë, nesër nuk do të jetë, do të vijë tjetri. Ky nuk është një organ që ndërtohet për 3 vjet, për 4 vjet, apo për 9 vjet, është një organ që do të vazhdojë të ekzistojë.

Në këtë kontekst, unë mendoj dhe dua ta them me shumë sinqeritet, ju duhet t'i jepni një përgjigje pyetjes: ju jeni për opinionin final të Komisionit të Venecias, apo jo? E vini në diskutim opinionin? Nëse e vini në diskutim opinionin, po bëjmë një debat në boshllëk, një debat jashtë marrëveshjes publike dhe jopublike që kemi arritur. Venecia nuk e diskuton fare, në asnjë paragraf, rolin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përkundrazi, kërkon një rol të përforcuar. Që këtu ne duhet ta mbyllim diskutimin. Këshilli i Emërimeve duhet të rrijë, sepse është një organ që e ka çertifikuar Venecia dhe e kërkon ta përforcojë, Venecia. Që këtu mbyllët diskutimi.

A, ju thoni: a mund t'i japim një rol tjetër, qysh, tek? Dakord, mund të ketë ndonjë diskutim, por nuk shikoj këtu ndonjë gjë, ndryshe nga kjo që ka thënë Venecia. Do t'ju kërkoja që ta mbyllim këtë diskutim, në qoftë se ju realisht jeni për opinionin final të Venecias.

Eduard Halimi – Ne e kemi mbledhjen pa medien, për të folur sinqerisht me njëri-tjetrin, larg demagogjisë, po them, jemi kundër Venecias, jemi pro Venecias. Venecian, po them një fjali si demagog, e kemi kërkuar ne dhe jemi mbërthyer si macja pas xhamit pas

Komisionit të Venecias. Kështu që ne nuk dalim asnjë pikë dhe asnjë presje nga Komisioni i Venecias, ta kesh të qartë. Meqë bëra filozofi, e bëra edhe unë filozofi.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk bëra filozofi. Filozofia është tjetër gjë dhe qëndrimi politik është gjë tjetër.

Eduard Halimi - Lidhur me opinionin final dhe me paragrafin 11, prandaj ia lexova Pandit, sepse diskutimet tuaja janë racionale, unë e kuptoj që këtë e ka thënë Komisioni i Venecias. Për të qenë racionalë, zgjidheni vetë ju si ligjvënës parimin *check and balance*, sepse unë mendoj: tani unë jam ligjvënësi, kaq më tha Venecia. Në qoftë se ju bini dakord për *check and balance*, sepse këto mekanizma, nuk po jua lexoj edhe një herë, mund ta luftojnë më mirë korrupsionin, atëherë thotë: unë jam i përgatitur ta pranoj këtë si një zgjidhje tërësisht shqiptare, zgjidheni ju, e keni ju, Mali i Zi e ka tjetër e të tjerë. Jam i përgatitur ta konsideroj të pranueshëm, si edhe paragrafin 8, për çështjet që thotë se unë kam qenë kritik më parë, u qëndroj atyre. Tani the se “Venecia nuk ka folur kurrë ndonjëherë për Këshillin e Emërimeve”. Lexoje nëse nuk ka folur ndonjëherë Venecia për Këshillin e Emërimeve.

Fatmir Xhafaj – Nuk e ka vënë në diskutim si organ.

Eduard Halimi – Nuk e ka vënë në diskutim si organ.

Fatmir Xhafaj – E ke te opinionin final që unë po lexoja këtu.

Eduard Halimi – Thatë se asnjëherë nuk e kanë vënë në diskutim. Çfarë ka thënë Venecia në opinionin e ndërmjetëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Një minutë, ju lutem!

Nuk ka problem, po më hoqe emrat, do ta bëni më keq se ç’është. Bëjeni! Bëjeni dhe mbani përgjegjësi, Vasilika! Më keq do ta bëni. Po jua them, do ta bëni më keq. Emrat i hoqët? Unë u qetësova.

Çfarë thotë Pandi për këtë gjë? Thotë: “Krijimi i Këshillit të Emërimeve e komplikon strukturën e gjyqësorit dhe synon të pakësojë lirinë e zgjedhjes së organeve kushtetuese që përfshihen në procesin e emërimit”, atë që tha edhe Oerdi. Përbërja e këtij këshilli që diskutuam, Pandi, duhet shqyrtuar më afër në sistemin e propozuar të emërimeve, në KED, një organ shumë i vogël elitare, këtë që thashë. Pra, kryetari i gjykatës këtu, kryetari i gjykatës këtu, i cili vendoset në një pozicion shumë të fuqishëm, do të bëjë emërimet, madje do t’i tregojë dhëmbët edhe parlamentit. Një shumicë e 11-të anëtarëve të rinj, të lidhur ngushtë me gjyqësorin prej tyre, përfaqësojnë gjyqtarët. Pra, janë ata që thashë. Janë 6-të gjyqtarët e tjerë që përfaqësojnë gjyqtarët, - thotë. Dy të tjerët përfaqësojnë prokurorinë, një përfaqësues ministri, që e kanë hequr, dhe dy të tjerë përfaqësojnë profesionet e lira.

Nga njëra anë, kjo përbërje synon të mbrojë nga ndikimi politik, jam dakord, sepse i hoqëm emrat, po i hoqëm këta të tre, e zgjidhim këtë shqetësim që kanë, por në të njëjtën kohë, ajo rrit rrezikun e korporatizmit meqenëse anëtarët e lidhur me gjyqësorin janë me shumicë neto. Totalisht gjyqësori, janë neto, - thotë. Nuk është diskutimi im, Pandi, e mora dhe e hodha në kosh. Këtë e ka thënë Komisioni i Venecias.

Megjithatë, meqenëse 5 anëtarët e KLD-së nuk lidhen drejtpërdrejt me gjyqtarët, këta mund të ushtrojnë një element kontrolli, por kjo duhet të ngelet një çështje problematike. Pra, e ka thënë një herë Venecia këtë gjë, nuk është halli i opozitës sot, është halli i qeverisë nesër. Pra, ky shqetësim që ka opozita sot, është halli i qeverisë nesër, kanë hallin e Lulit nesër. Luli nesër, apo Pandi pasnesër, apo anasjelltas, do ta kenë të pamundur të luftojnë korporatizmin, korrupsionin te gjyqtarët dhe te prokurorët, sepse ky organ do të jetë byroja e tyre. Prandaj, doni ta mbani si kusht? Unë nuk e di, nuk e kam diskutuar me kolegët. Do ta diskutojmë sërish sot dhe nesër. Edhe mund ta lëmë në një moment, në qoftë se hiqen disa gjëra, sepse ashtu siç thotë Fatmiri, është vendim. Fatmiri, kur e thotë, thotë se do të japë sugjerime, por këtu e ka shkruar “vendim”. Pra, këtu thuhet: “Këshilli i Emërimeve kryen verifikimin e kushteve dhe kriterëve dhe të moralit të kandidatëve gjyqtarë për kandidatë të Këshillit të Lartë”. Në qoftë se këtu thuhet se ai e bën dhe mund t’ia sugjeroj iksit apo ipsilonit, hajde ta diskutojmë, sepse kjo gjë mund të jetë e pranueshme në qoftë se e shkruajmë ashtu siç thotë Fatmiri, që do të bëjnë sugjerime. Po u tha se do të jenë sugjerime, dakord. Po u la siç është, është kjo që thonë ekspertët, që janë shumë më të mirë se unë dhe se gjithë të tjerët, ata të Komisionit të Venecias, pra një organ shumë i fuqishëm që do të krijojë problem.

Zhveshja e komponentëve politikë për ne është një hap në këtë proces të shqyrtimit të kësaj pike. Çështjen e ekzistencës, ose jo, mendoj se ndoshta mund ta trajtojmë sërish nesër, të reflektojmë, t’i shikojmë.

Oerd Bylykbashi – Zotërinj anëtarë,

Zoti kryetar, unë thashë se do të bëja një kompromis për votën në favor të të gjithë arkitekturës, nëse do të bëjmë zgjidhje që do ta ndryshojnë këtë që kemi sot përpara, sepse Komisioni i Venecias e ka vazhduar dhe e ka ngulur gozhdën nga *Vinterin*, ka vazhduar te *footnote 3*.

Po e citoj, mos u mërzisni: “Nëse renditja është e detyrueshme, rregulli do të nënkuptonte që organet kushtetuese kompetente për zgjedhjen përfundimtare ose emërimin të privoheshin nga kompetenca për zgjedhje”. Ndoshta ky nuk është synimi i hartuesve, por duhet të qartësohet. Ju thashë edhe një herë, e ka huq të vjetër, me të drejtë, Komisioni i

Venecias këtë. Ia ka thënë Shqipërisë në ndryshimet që iu bënë Kodit Zgjedhor në vitin 2003 në lidhje me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe na detyroi të bënim ndryshime në Kodin Zgjedhor. Pra, Komisioni i Venecias është duke na thënë: “Nuk e ktheni organin kushtetues në një vulosës të thjeshtë”. Kështu si e keni hartuar, pa dashje, me dashje, shkojmë tek ata dy-tri emrat që diskutojmë këtu dhe të ketë kaq shumë emra që na dalin, nuk është rastësi, kështu që na lind nevoja për të diskutuar mënyrën se si do t'i përzgjedhim, sepse nuk është rastësi formula që është propozuar sot.

Unë e dëgjova me vëmendje kryetarin e komisionit, zotin Xhafaj, kur tha se këta nuk do të bëjnë gjë, janë konsultative, vetëm do të na thonë se renditja është kjo, këta janë më të mirët...

(Diskutime pa mikrofon).

A mund ta kem vëmendjen e kolegëve? Ky është diskutim. Unë po them një gjë që vlen ta diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Pesë herë do ta dëgjosh, derisa unë të bindem për këtë histori, se unë e di që ka kolegë të mi, të cilët, mund të vijë momenti që nuk e votojnë, siç nuk kanë votuar më përpara çështje më të rëndësishme. Nuk është çudi. Tani, që unë të jem i qetë kur ta ngre dorën time në favor të ndryshimeve kushtetuese, si të gjithë ne bashkë, ne po diskutojmë disa çështje.

Kryetari, zoti Xhafaj, tha këtë, që ky është organ konsultativ, do të bëjë një përzgjedhje sipas kriterëve, kriteret duhet të jenë të qarta dhe të forta, do të bëjë edhe një rendim, dhe ky është subjektiv, do të jetë në çdo rast subjektiv dhe momentin kur ne fillojmë dhe shikojmë edhe emra, atëherë e kuptojmë më shumë subjektivitetin, dhe ne dimë, gjithashtu, se kur dështon organi që do të zgjedhë, renditja e këtyre na qenka zgjedhja përfundimtare. “Po”, - thotë kryetari, dhe me të drejtë, nuk po e vë në diskutim, por unë kam problem për atë që thotë, sepse parlamenti duhet të japë llogari publikisht për emrat që zgjedh. Unë nuk do ta shtroj në formën e pyetjeve, por me sa di unë, përzgjedhja e këtyre funksioneve në parlament bëhet me votë të fshehtë, e për rrjedhojë, parlamenti nuk jep këtë lloj përgjigjeje.

Pra, nuk jam dakord edhe me atë që tha, se KED-ja do të orientojë parlamentin në votën e vetë. Cila është KED-ja që të orientojë parlamentin? Pse është organ që parashikohet nga Këshilli i Emërimeve, qenka *check and balance*? Jo. *Check and balance*, si parim, është midis organeve të ndryshme vendimmarrëse, që kontrollojnë njëri-tjetrin. Nuk është nga ai konsultativi që kontrollon vendimmarrësin, që nuk ka sens, nuk e kam parë ndonjë herë këtë.

Kështu që nuk mundet që ky grup elitar, dhe jo në kuptimin e keq, në fund të fundit, termi elitar, t'i thotë parlamentit: "Ore, kështu siç ju themi ne". Tani, ju thoni: prisni, një sekondë, sepse nuk është e thënë, mund të jetë edhe i dyti, edhe i treti, edhe i katërti... KED-ja që duhet të kondicionojë në mënyrë të tërthortë votën e parlamentit, duke thënë që X është më i mirë se Y. Jo, nuk ka fare detyrë për të bërë këtë. A duhet të përzgjidhen më të mirët?! Po. Sa duhet të jenë këta?! Të caktohet me ligj. Edhe kriteret e përzgjedhjes së tyre duhet të përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj, por, mes këtyre, ta vendosë parlamenti. Ne duhet të vendosim një instrument (unë e kam një propozim, por nuk kam pse të them tani) për një rrugëdalje, nëse parlamenti nuk e arrin dot këtë në votimin e tij të parë. Një zgjidhje mund të jetë që t'i lihet përsëri autoriteti parlamentit. Nëse ia keni dhënë, çojeni deri në fund për të dalë nga bllokimi, por nuk duhet që vendimmarrja të çohet në mënyrë de facto te KED-ja, që është një organ që nuk jep llogari askund.

Kthehemi te formula juaj. Nëse do të bëjmë kompromisin që të ekzistojë ky organ, do ta pranojmë nga A-ja te ZH-ja që është konsultativ dhe nuk ka punë tjetër. Do të bëjë një listim të më të mirëve, por nuk duhet të na tregojë neve arat, pra të na tregojë se çfarë duhet të bëjmë.

Nëse duhet të mbahet kjo formulë, duke bërë edhe këtë që sapo thashë unë, përveç kapjes politike dhe korporativizmit, do të kemi edhe një problem tjetër. Mendojeni, sepse nuk është një zgjidhje për sot, por është problem si do të jetë nesër. Do të transferohet beteja për kapjen e instrumentit të KED-së tek organet nga vijnë këta zyrtarët *ex officio*.

Po marrim shembullin e kryetarit të Dhomës së Avokatëve, që ju e mendoni si të thjeshtë. Vetëm mendoni betejën që do të bëhet politikisht. Pra, të bëjmë pis sistemin, sepse ai që do të kapë nëpërmjet instrumentit të zgjedhjes së kryetarit të Dhomës së Avokatisë, e paska të siguruar këtë, e tjetrin me radhë A e kuptoni ku po e hapim lojën? Sot nuk është ky që po parashikojmë të jetë. Nuk e kemi as në KLD. Pra, do të krijojmë probleme të tjera më valë koncentrike dhe për 10-15 vjet do të jemi ende duke diskutuar këtu si ta zgjidhim problemin.

Zoti Majko, paragrafi 11 nuk flet për asgjë të qartë në lidhje me atë që thatë ju për KED-në, sepse nuk e përmend askund. Paragrafi 11 thotë: "Në mos 5-ën, 6-ën po ta jap për sistemin" dhe ka vënë duart përpara, siç tha zoti Halimi, që këtë askush të mos e marrë si model për të thënë që zgjidhja në Shqipëri është e transplantueshme në vende të tjera. Pra, sikur të them unë që asnjë ekspert ndërkombëtar, duke filluar nga kjo sallë deri te Komisioni i Venecias, sistemin tonë nuk ia propozon dot një vendi normal. Pra, kemi një hall që duhet ta

zgjdhim. Nëse ky hall nuk zgjidhet në krye të 5 vjetëve, për shembull korrupsioni, kjo ngrehinë komplekse do të mbetet aty.

Komisioni i Venecias nuk ka thënë se nuk ekziston problemi. Balancat do t'i vendosim ne. Në qoftë se KED-ja do të jetë pjesë e “check and balance”, do ta vendosim ne. Nëse do të na duhet si instrument kualifikues elitare, mundet ta pranoj edhe unë, por, nëse ky, që parashikon ky draft kushtetues, do të jetë nesër organi që do të ndajë fatin e këtyre zyrtarëve të lartë, besoj se do të jetë një nga vendimet më të gabuara që mund të marrim ne sot. Unë nuk e mbështes dot, kështu që ulemi e diskutojmë. Nëse na duhet, do ta shohim si do të zgjidhet dhe deri ku i shkon hapi me kompetencën që ka, pa cenuar në asnjë sekondë kompetencën e Kuvendit dhe të kujtdo tjetër. Nëse është këshillues, do të mbetet vetëm si i tillë dhe nuk do të jetë asgjë tjetër që do të ndikonte në mënyrën si do të funksionojë sistemi. Nëse këta na zgjedhin emrat më të mirë, ne nuk kemi pse të vëmë në diskutim faktin që A-ja është më e mirë se B-ja dhe që A-ja do ta bëjë detyrën më mirë se B-ja në mandatin e saj. Kështu që kjo është një çështje për t'u zgjidhur, por që nuk mund të bëhet me një të rënë të lapsit. Faleminderit!

Pandeli Majko – Unë shpresoj që këto diskutime të botohen një ditë dhe ata, që do të na lexojnë, të shohin se çfarë ankthi kemi ne gjatë diskutimit të këtyre problematikave që shtrohen për ndryshimet kushtetuese.

Mendoj se në parim KED-ja (Këshilli i Emërimeve në Drejtësi) i largon përfundimisht duart e politikës (në mos gaboj është shprehur edhe Komisioni i Venecias për këtë punë) nga emërimet në gjyqësor. Sinqerisht, nuk dua të them ndonjë metaforë, por jam shumë i shqetësuar për mënyrën si mendoni të krijohet korporata e drejtësisë në Shqipëri. Po citoj: “...nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, nga kryetari i Gjykatës së Lartë, nga kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, nga kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga prokurori i Përgjithshëm, nga kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë”. Janë edhe dy tjerë, gjyqtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës së Lartë. Unë po përpiqesha ta kuptoja këtë gjë, por ende nuk e kam të qartë se si kjo trupë, ashtu si thuhet në krye të nenit, kryen verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve jo gjyqtarë për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kandidatëve jo prokurorë për anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatëve për inspektorë të lartë të drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që emërohen nga Presidenti dhe nga Kuvendi.

Kthehemi në terrenin ku jemi aktualisht. E kemi djallozur. Përballë keni dikë që ka qenë anëtar i komisionit të Kushtetutës të vitit 1998, që u minuta në nëntor të këtij viti. E kemi djallozur. Kemi futur duart dhe kemi bërë gjëra të paimagjinueshme. Ta fiksojmë mirë se çfarë do të thotë korporatizëm. Miqtë e mirë, korporatizëm në drejtësi, në çdo rast, do të thotë mungesë e rregullit dhe influenca të jashtme, të cilat deformatojnë ligjin dhe vendimmarrjen në kundërshtim me atë që shkruar. Të paktën kështu e kuptoj unë korporatizmin në drejtësi. Nëse ju mendoni se korporatizmi ka të bëjë thjesht duke thënë në paragrafin 3 “kryetari i këtij institucioni apo i atij institucioni” fiksojmë emra, kjo është shumë e gabuar. Ne nuk po e ndryshojmë Kushtetutën për 1 javë, për 2 javë, për 3 muaj apo edhe për 5 vjet. Ne po përcaktojmë një sistem, i cili na heq nga duart ne politikanëve çdo lloj përcaktimi se kush duhet të jetë anëtar i Gjykatës së Lartë, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, prokuror i Përgjithshëm, sepse ne kemi treguar në vijimësi, bazuar mbi Kushtetutën në fuqi, se jemi absolutisht subjektivë. Ky Këshill i Emërimeve në Drejtësi pikërisht të ashtuquajturin objektivitet apo fuqi të parlamentit na e heq nga duart dhe ia kalon elitës qeverisëse, *de facto*, të sistemit të drejtësisë. Kjo është elitë qeverisëse dhe nuk është elitë korporative. Por, ajo elitë nuk do të bëjë gjëmën, por thjesht do të na thotë se këta njerëz plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur, siç thotë edhe ligji. Jam sinqerisht i shqetësuar për mënyrën si dëshironi ta shikoni këtë. Kur të vijnë studentët e juridikut dhe të shikojnë ndryshimet që kemi që bërë ne dhe që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili është kaq i rëndësishëm, do të zgjidhet me gogla, vetëm se ne politikanët kemi frikë se kush do të jetë kryetar i Gjykatës së Lartë, kryetar i Gjykatës së Lartë, kryetar i Gjykatës Kushtetuese etj, kjo është qesharake. Nuk ka libër drejtësie që e përfshin këtë që po diskutojmë ne tani. Nga frika se mos ai dhe ajo, që janë në krye të funksioneve të institucioneve më të respektuar të sistemit gjyqësor, na paskan emra, ne do t’ua japim të drejtën goglave. Anëtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës Kushtetuese dhe anëtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës së Lartë nuk janë emra, por një parim, të cilin hajdeni ta diskutojmë. Kur ne ulemi dhe shkruajmë “anëtari më i vjetër në detyrë”, presupozojmë dikë me eksperiencë, që jep një opinion të shtuar në një gjykim, i cili, po e përsëris, kryen verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore e profesionale.

Prandaj, të nderuar kolegë, nëse biem dakord që infrastruktura apo arkitektura e institucioneve do të jetë kjo, vlen të diskutojmë apo të dëgjojmë propozime alternative nga ju, ose t’ia lëmë ekspertizës ndërkombëtare ta gjykojë këtë që është futur këtu dhe atë që do të sillni ju. Le ta gjykojnë ata se cila është më e favorshme. Por të diskutohet sikur në këto ndryshime kushtetuese po i bëjmë për 6 muaj apo derisa të bëhen zgjedhjet e tjera të përgjithshme, nuk besoj se këtu duhet të përqendrohemi te gjykimet politike të mandateve

tona 4-vjeçare, 8-vjeçare apo 12-vjeçare. Ne po diskutojmë një sistem, i cili efikasitetin e tij nuk do ta tregojë në 1, 2 apo 3 vjet por, sipas opinionit tim, diku pas 10-15 vjetëve dhe që në thelbin e saj, po përsëris edhe një herë, po kërkon të largojë duart joprofesionale të politikës në emërimet në sistemin gjyqësor dhe dëshiron që vendimmarrjen për sistemin gjyqësor ta kthejë brenda sistemit. Pra, të jetë sistemi që propozon dhe jo politika, e cila me këtë Kushtetutë në fuqi vendimmarrjen për sistemin gjyqësor e ka lënë jashtë sistemit gjyqësor, pra në duart e politikës. Duke qenë në duart e saj, ne kemi krijuar influencat që gjyqtarët të ndahen në të majtë dhe në djathtë. Kemi qenë ne ata që i kemi gjykuar politikisht në Komisionin e Ligjeve dhe u kemi thënë: “Ke marrë pjesë në fushatë; ke qenë në komision; ke qenë me taserë partie; ke qenë në qeveri”. Të biem dakord për një gjë: juristi dhe gjyqtari i mirë nuk ka rëndësi se çfarë taserë ka, sepse ai nuk do të gjykojë me statutin apo me programin e partisë të majtë apo të djathtë, por do të gjykojë me ligjin, me kodin. Mendoj dhe jam i bindur se ky Këshill Emërimesh do ta bëjë këtë.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, përqendrohuni vetëm tek opinioni i “Venecias”!

Fatmir Mediu – Ne po diskutojmë se çfarë funksioni do të ketë Këshilli i Emërimeve, në qoftë se do të ekzistojë, pavarësisht kontestimeve që kemi.

E para është struktura e Këshillit për Emërimet në Drejtësi. Ne kemi shqetësim mënyrën sesi është parashikuar. Pa dyshim që është nën influencë politike. Duke marrë në konsideratë atë që thotë zoti Majko, duket qartësisht një gjë: ato ju i përdorni si kritere parimore, nuk janë kritere për funksionalitetin e këtyre institucioneve kushtetuese. Kryetari i Gjykatës së Lartë ose i asaj Kushtetuese nuk zgjidhet ai që është më i vjetër.

Eduard Halimi – E trajtoji Pandi pak. Ne nuk kemi pretendimin për kryetarët, por vetëm për anëtarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht edhe nga ajo pikëpamje. Edhe një herë, çështja e të qenit më i vjetër nuk të jep apriori të drejtën për të qenë në një institucion tjetër. Pjesa e dytë ka të bëjë me funksionet e KED-së. Në qoftë se do t’i japim funksion konsultativ, këtë funksion duhet të ketë. Në qoftë se do t’i japim funksionin e emërimit, atëherë nuk ka nevojë për parlament. E heqim parlamentin fare. Domethënë, nga mënyra si është parashikuar në draft, i është dhënë funksion emërimi. Në momentin kur politika vendos të mos i votojë, atëherë absolutisht që mbetet vendimi i Këshillit të Emërimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përderisa rankohen, do të thotë që i kanë përmbushur kriteret. Edhe në gjykimin juaj subjektiv është. Atëherë, do t’i kthehem atij rankimi. Për mendimin tim, ata duhet të

përcjellin emrat që kualifikohen, pastaj i mbetet në dorë parlamentit të përcaktojë mekanizmin zhblllokues ,në rast se nuk ka konsensus për t'i zgjedhur. Ka mënyrë nga më të ndryshmet, qoftë edhe ajo mënyra që ju përjashtoni. Është shumë herë më objektiv një short i atyre të pestëve se sa një renditje e përcaktuar në mënyrë subjektive.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, e ka mbyllur Komisioni i Venecias këtë që po diskutojmë ne. Kemi rënë dakord. “KED-ja do të jetë”, thotë Komisioni i Venecias.

Fatmir Mediu – Nuk po flas për KED-në, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Po, pra Këshillin e Emërimeve në Drejtësi e thotë Komisioni i Venecias.

Fatmir Mediu – Po, por po flas nga pikëpamja e funksionalitetit të saj. Në qoftë se do t'i jepni funksion emërues, atëherë nuk ka pse ju duhet parlamenti.

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ju doni ta rrezoni, rrezojeni Komisionin e Venecias.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Në fakt, unë do të doja të theksoja edhe një herë atë që sapo tha zoti Xhafaj. Në qoftë se flasim për marrjen parasysh të raportit të Komisionit të Venecias, më duket se për çështje që kanë qenë të diskutueshme dokumenti bazë i punës do të jetë raporti përfundimtar dhe jo raporti paraprak. Raporti i ndërmjetëm do të jetë vetëm për ato çështje për të cilat që në fillim Komisioni i Venecias ka thënë se nuk i bën objekt të raportit përfundimtar, sepse janë qartësuar në raportin e ndërmjetëm.

Lidhur me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, nuk arrij të kuptoj, kolegë të opozitës, pse po e kundërshtoni sot, pasi deri më tani kemi thënë se procesi është i politizuar, kurse themi që, po t'ia kalojmë gjyqtarëve, ai proces do të bjerë në dorën e një korporate. Unë dua të sjell në vëmendje disa paragrafë të raportit përfundimtar të Komisionit të Venecias, i cili i jep Këshillit të Emërimeve tre-katër kompetenca më shumë se ato që ka përmendur në raportin e ndërmjetëm, të cilat i ka thënë në formë pyetjesh. Do të ishte më vend që, kur të kalojmë te çështjet konkrete, t'i diskutojmë.

Marrim shqetësimin tuaj të parë për përbërjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të tribunalit. Kolegu Halimi tha se fati i drejtësisë do të mbetet në dorën e 18 gjyqtarëve në tërësi. Në fakt, kur e dëgjova, mendova mos e kisha lexuar gabim nenin 147, germa “ç”, dhe nenin 147, germa “f”, sepse dukej sikur përbërja e tyre është e njëjtë, por rezulton se përbërja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe e Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë nuk është e njëjtë. Vetëm dy persona janë të njëjtët. Cilët janë ata konkretisht?! Është kryetari i Gjykatës së Lartë dhe kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative. Personat e tjerë nuk janë. Pra, duhet ta bëjmë pak të qartë që këta dy mekanizma që krijohen nuk kanë të njëjtën

përbërje. A kemi rënë dakord që ne politikanët nuk duhet të kemi dorë?! Pra, kemi rënë dakord.

Atëherë, po kaloj te pjesa e dytë: cilët do të jenë? A do të jenë këta gjyqtarë në trupë? A do të jenë ata që i kanë zgjedhur në krye të këtyre institucioneve? Do të jenë.

Po kaloj te shqetësimi tjetër. Të bëhemi pak praktikë. Po flas me filozofinë tuaj, se unë nuk mendoj se këtë ndryshim kushtetues në do ta bëjmë për aq kohë së kjo maxhorancë është në qeveri, se do të ishte katastrofë. Kush është anëtar Gjykatës së Lartë sot?! A mund ta paragjykojmë ne sot?! Nëse ka një njeri që mund ta paragjykojë, do të ishte kjo ana këtu, por ne nuk e kemi paragjykuar. Kush do të jetë nesër?! Pra, procedura se si do të zgjidhet është shumë e qartë. Nuk do ta zgjedhim ne politikanët.

Nga ana tjetër, ajo që më shqetëson mua është që shpesh gjyqtarin më të vjetër, kryetarin, drejtuesin më të vjetër, deputetin më të vjetër i përdorim në shumë institucione. Edhe në parlament, për të drejtuar seancën e parë zgjidhet deputeti më i vjetër. Ne nuk e kemi kundërshtuar ndonjëherë këtë. Pikërisht fakti se në këtë Këshill Emërimesh në Drejtësi mendohet të jetë gjyqtari më i vjetër në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën, nuk mund të hedhë poshtë të gjithë njohjen apo funksionin që Komisioni i Venecias i jep KED-së.

Unë dua të sjell në vëmendjen tuaj një pyetje shumë interesante, të cilën ne duhet ta diskutojmë me njëri-tjetrin. Në paragrafin e 20-të Komisioni i Venecias thotë: “Pse nuk kërkohet ndërhyrja e Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor?! Ose po sjell në vëmendjen tuaj paragrafin 40 të raportit përfundimtar të Komisionit të Venecias, ku thuhet: “Nuk është e qartë pse nuk kërkohet opinioni i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për 3 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese”. Po përmend paragrafin 16 lidhur me rolin që luan Këshilli i Emërimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve profesionale, morale të kandidatëve jo gjyqtarë. Po flas gjithmonë për raportin përfundimtar, sepse me të duhet të punojmë sot. Pra, jo vetëm që nuk e ka hedhur poshtë që duhet të ketë në këto struktura anëtarë që vijnë nga jashtë gjyqësorit, profesionistët më të mirë, por i jep kompetencë Këshillit të Emërimit t’i verifikojë, t’i shqyrtojë dhe t’i rendisë. Ajo që mua nuk më ka pëlqyer dhe do të jem shumë e sinqertë është se gjatë gjithë diskutimit shoh, ndoshta pa dashje ose jemi të lodhur, se po afron koha e drekës, sepse kjo është mbledhja e dytë, që ne përziejmë përbërjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me probleme të kompetencave që ai ky dhe nëse renditja do të jetë detyruese ose jo. Këto janë dy çështje të ndryshme. Unë pajtohem dhe bashkohem këtu 100% me një pyetje të ripërsëritur nga kolegu Majko: përfundimisht, meqë keni qenë jokonsistentë, si ju dhe zoti Halimi, në fillim të fjalës, a jeni dakord për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, po apo jo?

Nëse po, do të kalojmë te kompetencat. Renditja që do t'ju bëj anëtarëve jo gjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, kandidatëve jo prokurorë, do të ketë natyrë detyruese apo jo? E them këtë, sepse ose nuk jam shumë e qartë, ose nuk jam dëgjuar mirë, por ju, zoti Bylykbasi, por njëkohësisht edhe zoti Mediu, përmendët nëpër dhëmbë shpesh kontrollin “check and balance” (ndoshta e kam gabim, prandaj po ju kërkoj ndjesë) dhe përmendët herë pas herë rolin e parlamentit. Pra, kërkonit t'i rikthehemi edhe një herë një roli të parlamentit, për të cilin deri tani kemi thënë të gjithë se nuk duhet ta ketë në dorë. Tani çfarë do të bëjmë? Do të vazhdojmë t'i japim disa çengela, parlamentit që të ketë sa më shumë? Deri tani po thoshim: larg duart nga parlamenti. Të them të drejtën, një pjesë e mirë prej nesh jemi ndier të fyer apo jo që pse jemi bërë kaq mosbesues? Por meqenëse kjo është krijuar në opinionin publik, pranuar të gjithë që jemi fajtor dhe hajde t'ua lëmë gjyqtarëve dhe prokurorëve.

E fundit, dhe për ta mbyllur, për mendimin tim, dhe nuk e ndërroj këtë mendim, suksesi i kësaj reforme do të fillojë te procesi i vetingut. Në qoftë se ky proces do të kryhet me sukses, procesi i verifikimit, vetingu pra do të largohen gjyqtarët me kualifikim të ulët, por mbi të gjitha të korruptuar, me pasuria që nuk i justifikojnë dot, në lidhje me botën kriminale, e gjithë kjo strukturë më pas do të shikoni se sa e pastër do të jetë. Asnjë nga ne këtu, në qoftë se do të jemi në parlament, nuk do të themi sa gabim bëmë që ngritëm dorën për këtë proces, për këtë përbërje të këtij komisioni, sepse të gjithë këta persona do t'i nënshtrohen kontrollit të figurës, morale, ligjore, pasurisë, lidhjes me botën e krimit, edhe me ligjin që sapo ne kaluam, të pastërtisë së figurave, shumë e shumë hallka të tjera. Prandaj të mos e shikojmë këtë përbërje të shkëputur nga tërësia, nga filozofia e kësaj reforme, që është pastërtia mbi të gjitha dhe midis atyre që do të jenë më të pastrit, që do të jenë 100% të pastër dhe jashtë ndikimit të politikës dhe botës së krimit do të përzgjidhen të gjithë, kandidatë, që besoj se do t'u vijë radha të ndryshohen në vitet në vazhdim. Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – E vetmja pyetje shtesë që kam: është më rankojnë mua gabim këta, jam gjyqtar, për shembull, a kam të drejtë të ankojem në ndonjë vend, që mund të jetë vendimi final për mua? Defektet e rënda që ka kjo që propozoni ju, janë të rënda. Kompromisi për të pranuar KED - në për mua, po flas edhe një herë për veten time, është që ne të shikojmë një KED që funksionon me qëllimin që ka, konsultative, jo vendimmarrëse.

Tani, zonja Hysi, unë nuk fola nëpër dhëmbë e thashë shumë qartë: sa kohë dispozitat kushtetuese që propozohen sot e kësaj dite mbajnë rolin substancial të Kuvendit në vendimmarrje, është kështu. Nëse ju e keni kuptuar ndryshe, unë ju them ta rilexoni këtë gjënë. Parlamenti, sot e kësaj dite, vendos me votën e tij se kush do të jetë në fund fare. Nëse ne, 140 burra dhe gra, vendosim për një person, KED-ja nuk ka punë fare, e ka bërë punën

eventualisht kur i përzgjedhi. Por po ju kthej përsëri te paragrafi 16, që ju lexuat, ky proces nominimi, sepse thotë nuk është vetëm mekanizmi, por edhe procesi i nominimit, është i rëndësishëm (dhe besoj se për këtë biem të gjithë dakord duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrohet të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar dhe jo të emëruarve politikë. Pra, është vetë Komisioni i Venecias që na i ka ndarë që parlamenti bën zgjedhje, duhet të jetë i detyruar që ta zgjedhë midis më të mirëve profesionalisht. Mund të ketë edhe zgjidhje tjetër për KED-në, por nëse do ta pranojmë, duhet të shkojmë te *footnote* 3, që është i këtij paragrafi. Pra, *footnote* 3, që unë referova vazhdimisht, ka lidhje pikërisht me momentin kur përmendet KED-ja dhe thotë: “Renditja nuk mund të jetë e detyrueshme, sepse përndryshe i heq kompetencën emëruese organit kushtetues”. Kujt? Parlamentit. Pra, këtë jemi duke thënë: nëse do të ngremë një sistem që funksionon, nuk mund t’i vëmë shkopat nën rrota njëri-tjetrit dhe as njëri ka më shumë vlerë se sa tjetri, duke u fshehur pas maskës. Kaq kisha.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Në mbyllje të kësaj çështjeje unë besoj se u gjet konsensusi për të hequr kriteret për tre anëtarët, sipas kundërshtimit të opozitës, të cilat ishin kriteret selektive. Jo për kryetarin, zoti Pandi, të Gjykatës së Lartë, por për tre anëtarët e tjerë. Anëtari më i vjetër në moshë këtu, anëtari më i vjetër në detyrë këtu dhe anëtari më i vjetër, dhe anëtari më i vjetër në KLD. Këto tre kriteret ishin selektive. Për këtë u gjet konsensusi dhe u tejkalua. Ky zgjidhi një nga problemet që opozita kishte ngritur që në shtator lidhur me këtë çështje, sepse kishte të bënte me mosbesimin e funksionimit të këtij institucioni.

Problemi i dytë besoj se ngelet i pazgjidhur, ka të bëjë me funksionet e Këshillit të Emërimeve. Siç e lexojmë ne këtu, Këshilli i Emërimeve merr vendime. Siç e tha zoti Fatmir, Këshilli i Emërimeve jep sugjerime. Në qoftë se gjendet dakordësia për atë që thotë zoti Fatmir, që Këshilli i Emërimeve do të jetë një organ konsultativ, sepse e tha më parë, atëherë edhe këtë çështje unë mendoj se ekspertët mund të rishikojnë, të na sjellin variantin që Këshilli i Emërimeve do të jetë konsultativ dhe ne më pas do ta shikojmë pjesën e shqetësimeve, që me të drejtë ngre zoti Bylykbashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është vendim ky këtu nuk është konsultativ, unë mund ta konsultoj. Po them parlamenti që këto janë njerëzit që mendojmë se do të jenë të tillë dhe ndaj një vendimi konsultativ. Për shembull, në qoftë se e përjashtojmë zotin Pandi, nga kandidimi, një gjyqtar ai është sugjerim parlamenti ka të drejtë të thotë prit se e ke bërë gabim dhe mund ta rishikoj. Në qoftë se ne do të kemi vendimmarrje.... Zoti Pandi, e kam shumë seriozisht. Këtu qëndron

çudia, se ne jemi në opozitë dhe po përpiqemi si e si që parlamenti të ketë forcë, sepse nuk po mendojmë për opozitën, por po mendojmë për qeverinë nesër, këtu e kemi hallin. Prandaj jemi ne në atë pozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk jemi të rrezikshëm, ne mendojmë se bëjmë punën e duhur. Pra, në qoftë se do të marrë vendim ajo, atëherë do të bëjmë edhe përgjegjësinë e këtyre njerëzve që marrin vendime, këtu besoj se biem dakord, apo jo sepse po morën vendime ata, duhet të mblidhemi dhe të themi: si e morët këtë vendim. Duhet të ketë një organ që të marrë vendim, apo jo? Pra, në atë që thoni ju, zoti Majko, mirë apo keq, që e keni bërë në vitin 1999, ju ia keni dhënë Presidentit të Republikës përzgjedhjen, është kështu? Por ai ka përgjegjësi publike. Në qoftë se bën emërimë të gabuara, një herë i gjuani ju kur jeni në pushtet, një herë e gjuajmë ne kur kemi qenë në pushtet. Por ama ka përgjegjësi publike ai edhe kur bën emërimë të gabuara, propozime të gabuara, edhe kur merr pjesë dhe vë kritere të gabuara, edhe kur procesi ka të bëjë me transparencën, por ka përgjegjësi publike. Po kujt do t'ia kërkosh t'i përgjegjësinë publike? Kryetarit të Dhomës së Avokatisë, kryetarit të Gjykatës së Lartë, kryetarit të Gjykatës Kushtetuese? Këtë përgjegjësi nuk kërkon dot. Pra, në qoftë se do të marrë vendime ky institucion, duhet të parashikohet edhe e drejta e ankimit diku, siç thotë zoti Oerd, edhe çështja e përgjegjësisë së tyre, sepse ky është raporti i përgjegjshmërisë.

E fundit, korporata zoti Majko, unë *hapa wikipedian*, sepse mendova mos e kam kuptuar unë gabim këtë korporatën, siç e thotë Pandi, sepse thotë korporatën kush do ta bëjë kryetari i Gjykatës së Lartë, apo jo? Hapa *wikipedia dhe* lexova çfarë është korporativizmi. Korporativizmi është pikërisht mbledhja e grupeve të interesit për të mbrojtur interesat e tyre ndaj zbatimit të ligjit. Këtë thotë korporativizmi te wikipedia. Pra çfarë kemi ne shqetësim të madh? Shqetësimi i madh që ne kemi:

E para, luftë ndaj korrupsionit në sistemin gjyqësor.

E dyta, luftë ndaj korporativizmit.

E treta, sistem gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm.

Çështjen e sistemit të paanshëm dhe të pavarur ne po e zgjidhim, si opozitë. Luftën ndaj korrupsionit e zgjidh problemi që thotë, zonja Vasilika, si moment që është vetingu, por që është i përkohshëm për 2-3 vjet, më pas do të ngremë institucionet, sepse nuk do të bëjmë veting pas 5 vjetësh prapë. Pra, duhet të ngremë institucione që ta kenë, siç po ngremë Byronë dhe këto të tjerat. Pra, kur them, zoti Majko, që Këshilli i Emërimeve është korporatë, nuk them me emra të veçantë, por po them se ato emra, të gjithë janë pjesë e klubit. Pra, janë pjesë e klubit të gjyqtarëve dhe prandaj të lexova pikë për pikë atë që ka thënë në dhjetor

“Venecia”, sepse ishte pak a shumë ky shqetësim. Pra, ky organ elitar, që përbëhet nga anëtarë të klubit, të cilët mund të jenë njerëz me shumë integritet, por nuk e vë fare në dyshim, qoftë kryetari i Gjykatës së Lartë, qoftë i Gjykatës Kushtetuese, qoftë prokurori i Përgjithshëm, por janë pjesë e klubit dhe si pjesë e klubit të gjyqtarëve në Këshillin e Emërimeve, si pjesë e klubit thotë “Venecia” e 6 gjyqtarëve që jo domosdoshmërisht mund të jenë horra, mund të jenë njerëz shumë të mirë, që do të zgjidhen në Këshillin e Lartë Gjyqësor, do të jenë pjesë e klubit. Si pjesë e klubit që do të jenë përsëri në Tribunal Disiplinor, që do të marrin ata shqyrtimin, gjithë kjo pjesa e klubit, klubit, gjithë anëtarësisë së klubit, për ne përbën shqetësimin e korporatizmit, që nuk ka lidhje me shqetësimin 3, që kishim ne, kapjen politike, se e zhveshëm, por ka lidhje me korporatizmin.

Ndaj, në përfundim dua të them, meqenëse zgjidhëm dy çështjet që u dakordësuan që në fillim, çështjen e Byrosë dhe çështjen tjetër, për pjesën e korporatizmit, llogaridhënies, a mundet edhe për pjesën e vendimmarrjes, pra në qoftë se do u japin vendim atyre, duhet të bëjmë një mekanizëm që të japin llogari, përgjegjësi ata, u dhamë pushtetit, prit të japin edhe llogarinë, kushdo që ta ketë, sot ju, nesër ne, e me radhë. T’u kërkojmë llogari, u dhamë pushtetin, t’u kërkojmë llogari. Për këtë pjesë do të sugjeroja që ekspertët të mendojnë diçka gjatë këtyre ditëve, derisa të jetë mbledhja e ardhshme, në fillim të javës tjetër, kur mund të jetë, që do të zgjidhin çështjet teknike, të shikojmë pjesën e problemit të korporatizmit, në këto institucione: në KED, Tribunal Disiplinor, KLGJ, sepse me KLGJ thashë përgjithësisht është zgjidhur korporatizmi, sepse është *check and balance*. Pra, jemi bërë 6 me 5, kurse këtu në KED jemi zero. Të jeni të qartë se nuk do të çojmë njerëz atje, jo se do të bëjmë institucione mbi partizane, nuk po them të çojmë deputetët, por po them të zgjidhin çështjen e llogaridhënies, këta duhet të japin llogari diku. Çështjen e llogaridhënies ne duhet ta zgjidhim, sepse e kemi të pazgjidhur. Po na dhanë llogari këta, të nderuar kolegë, ne e kemi të zgjidhur një problem. Kjo është në të mirë të atyre që do të na lexojmë më pas. Unë u referohem shpesh diskutimeve që janë bërë në vitin 1998 për Kushtetutën atje dhe asnjëherë nuk kam ofenduar ndonjë njeri, kam qenë në mendime racionale, shpresoj që edhe neve të mos na shajnë nesër për këto që do të bëjmë. Por na ka dështuar sistemi për shkak të korporatizmit. Kështu ka qenë. Çdo ministër që shkon në KLD, mbyllet, shko në Gjykatë të Lartë, mbyllet dhe të gjithë dështojnë, me radhë, në mënyrë spektakolare. Ne duhet ta zgjidhim këtë problem. Mendoj se ekspertët, nëse munden, të na japin një lloj zgjidhje për këtë shqetësim që e kemi, që thashë nuk ka lidhje me kapjen politike, por me korporatizmin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Për ta mbyllur më duhet të bëj 2-3 sqarime që janë të rëndësishme.

Së pari, ne ramë dakord që të njësojmë kriterin mbi të cilin do të jenë anëtarët e gjykatave në këtë, mbi më i vjetri në moshë apo më i vjetri në detyrë, apo i zgjedhur me votim ndërmjet trupës e tjerë. Por duhet t'ju them se nga erdhi kjo, thjesht për korrektesë. Erdhi te kjo zgjidhje, sepse në pikën 71 të opinionit të ndërmjetëm thuhet shprehimisht: “Prania e tri anëtarëve nuk është domosdoshmërisht zgjidhja më e mirë, anëtari më i vjetër mund të jetë emëruar më vonë dhe jodomoshmërisht më me përvojë. Një opsion më i mirë, nëse përvoja e gjatë shihet si avantazh, do të ishte që në çdo rast të emërohej anëtari që ka shërbyer më gjatë në gjykatë”. E ka thënë Komisioni i Venecias në opinionin e ndërmjetëm dhe kjo, me sa duket, i ka çuar ekspertët në këtë zgjidhje. Nuk është zgjidhja që ne shikojmë me emra e tjera ramë dakord të gjejmë një zgjidhje tjetër. Absolutisht si të jetë më mirë, është aq teknike sa që nuk kemi arsye që ta kthejmë në çështje politike.

Për sa i përket KLD-së mua më duket se nëse ka një organ që të dyja opinionet e Komisionit të Venecias kanë qenë të qartë, është Këshilli i Emërimeve të Drejtësisë. Por ka edhe një veçori, në paragrafin 24 është theksuar shprehimisht: “Në thelb pranohet modeli i propozuar në projekt. Projektndryshimet e rishikuara gjithashtu parashikojnë një mekanizëm zhblllokues, që mendohet se do t'i japë një shtysë parlamentit për të arritur një marrëveshje, sepse përndryshe zgjidhja do të vendoset diku tjetër”. Pra, e ka pranuar si zgjidhje zhblllokuese rolin e KED-së, Komisioni i Venecias. Madje në opinionin final shkon pak më tutje, thotë: “Pjesëmarrja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në përzgjedhjen paraprake të kandidatëve që do të emërohen në Gjykatë Kushtetuese nga Presidenti dhe parlamenti, ul me tej rrezikun e emërimeve politike.” Pra, e quan rol shumë të rëndësishëm për politizimin, për kapjen politike. “Venecia” thotë: duhet që KED-ja të mos kapemi politikisht.

Eduard Halimi – Edhe ne këtë po themi.

Fatmir Xhafaj – Gjithashtu në paragrafin 40 thotë: “Nuk është e qartë pse nuk kërkohet opinioni i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që zgjidhen nga Gjykata e Lartë dhe nga Gjykata e Lartë Administrative”. Pra, një herë duhet të mbyllim çdo diskutim për sa kohë që bashkohemi tek opinioni i Komisionit të Venecias, që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një institucion mëse i nevojshëm dhe i mbështetur fort nga “Venecia” në projektin e tij.

Ka edhe diçka tjetër që dua ta them. Në gjithë këto struktura që e quani ju, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është i vetmi, institucion që nuk ka ndikim politika. Është i vetmi kudo: te prokurori i Përgjithshëm, te inspektori i Drejtësisë. Ky është i vetmi ku ne nuk fusim

hundët. Tani, ju thoni, meqenëse ne këtu nuk arrijmë të futemi nga dera, le të futemi nga dritarja. Këtë nuk mund ta pranojmë. Është i vetmi institucion ku nuk përfshihet politika, i vetmi që nuk ka rol politika dhe nuk ndikojnë në produktin e tij, sepse nuk e zgjedh politika, e zgjedhin këta.

Të shkojmë te çështja e korporatizmit. Së pari, mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm. Këtu nuk bëhet fjalë për klub gjyqtarësh, bëhet fjalë për pushtet gjyqësor, sepse po të ishim nga ky kriteri, i bie që dhe parlamenti mund të ishte një lloj klubi, klubi parlamentar. Unë nuk e besoj kështu. Unë besoj që ky është një pushtet legjislativ, ky është pushtet gjyqësor. Ne po flasim për një institucion brenda këtij pushteti gjyqësor, i cili, pikërisht, për shkak të nivelit të lartë të përfaqësimit, mënyrës së zgjedhjes, faktit që është tërësisht jashtë ndikimit politik do të na japë mundësinë që të funksionojë në mënyrë efeciente dhe në luftë kundër korporatizmit. Këta nuk zgjidhen nga masa e gjyqtarit që ta shërbejë po të njëjtëve gjyqtar, të njëjtës trup, siç është rasti i KLGJ-së dhe i KLP-së, që të kishte një lidhje korporatiste që një grup interesash të bashkohen për disa qëllime të caktuara. Absolutisht, nuk jemi para këtij rasti. Nga çdo pikëpamje, ky është një organ që është totalisht i larguar ose jashtë ndikimit të politikës. I larguar nga interesat korporatiste, për shkak të mungesës së lirë dhe të shkurtër, me grupe të caktuara profesionistësh, gjyqtarësh apo prokurorësh. Besoj se është një zgjidhje shumë e arsyeshme, që do ta ndihmojë procesin e seleksionimit për të respektuar atë që thotë “Venecia” dy element: përzgjedhjen profesionale, përzgjedhjen më të mirë, dhe e dyta, për të na liruar nga efekti bllokues, që është një problem shumë i madh që kemi sot.

Kështu që ne mbetemi te Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas “Venecias”, me dy funksionet që ai ka, njëri funksion është thjesht rankimi dhe efekti i dytë, është zhbllokimi në rast se parlamenti nuk është i zoti të gjejë rrugën dhe mënyrën e duhur për t’i shkuar procesit deri në fund. Gjithsesi, në qoftë se ju ngelet ndonjë çështje teknike, le t’ia lëmë detyrë, siç e ngritët, ju dhe e mbyllim këtë diskutim në parim për këtë çështje.

Eduard Halimi – Unë e çmoj të panevojshme për të vazhduar debatin për pjesën e dytë të Këshillit të Emërimeve. Dua t’i them ekspertëve nëse mund të na japin ata pas disa ditësh zgjidhjen e këtyre dy çështjeve për Këshillin e Emërimeve, që ne kemi debat, ndoshta nuk është debati politik. Nëse Këshilli i Emërimeve, do të ketë vetëm rol sugjerues dhe jo vendimmarrës, sigurisht atë çështjen e zgjidhjes së tre anëtarëve ju do ta zgjidhni siç duhet. Nëse ka vendime për të marrë Këshilli i Emërimeve, të paktën, ne si opozitë të kërkojmë të gjeni mekanizmat e kontrollit të vendimmarrjes dhe të ankimit . Pra, në qoftë se dikush do të gjendet para një vendimi të Këshillit të Emërimeve, kushdo qoftë ai, më i drejti, më i bukuri,

më i gjati, kundër këtij vendimi, çdo gjyqtar i vendit, çdo jurist, çdo qytetar i këtij vendi ka të drejtë që të ankohe kur të merret vendim.

E treta, për çdo vendim të këtyre këta duhet të japin llogari diku. institucione që nuk japin llogari kurrkujt, nuk mund t'i ngremë, sepse kjo do të ishte gafë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çdo njeri që do të veshë kostumin e zyrtarit të gjyqësorit pas ndryshimeve kushtetuese, ai, për çdo ditë dhe për çdo vendim që duhet të marrë, qoftë administrativ, qoftë gjyqësor siç e ka, duhet të jap llogari. Ne institucione që i japin llogari Zotit, nuk mund t'i lëmë. Ju shikoni modele gjatë këtyre ditëve, në qoftë se ka modele që kanë institucione të tilla, që nuk i japin llogari askujt, dakord, edhe ne do ta shikojmë qëndrimin tonë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, zotin Rainer e kemi këtu dhe le ta shikojë modelin gjerman, kujt i jep llogari: i jep llogari Jezusit apo Muhamedit?

Eduard Halimi – Në qoftë se në Gjermani do të kishte korporatizëm nuk do ta pyesja fare zotin Rajan.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka zgjidhur “Venecia” nuk ka.

Në rregull, e mbyllim në orën 18:00 do të vazhdojmë me çështjet e tjera. Zoti Halimi, me çfarë do të vazhdojmë në orën 18:00?

Eduard Halimi - Në orën 18:00 do të vazhdojmë me çështjet e tjera, sipas rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.03.2016, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i opinionit final të Komisionit të Venecias për reflektimin e rekomandimeve të tij në tekstin e rishikuar të projekt amendamenteve kushtetuese të përgatitura nga Ekspertët e Nivelit të Lartë

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Spartak Braho, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Fatmir Mediu

Mungon: Gent Strazimiri

Të ftuar:

Z. Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z. Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Vazhdojmë me pikat e tjera të paraqitura nga Partia Demokratike.

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Pika 3, që ne duam të trajtojmë, ka të bëjë me pjesën e strukturës institucionale. Është në vijim të diskutimit që ne bëjmë paradite lidhur me këshillin e emërimeve dhe për të zgjidhur problemin në lidhje me kapjen politike. Shpresojmë që

problemi i kapjes politike, që kap Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë të gjejë zgjidhje në një moment tjetër. Çështja e sotme ka të bëjë me pjesën e konfliktit të interesave apo korporatizmit ndërmjet KLGJ-së dhe Tribunalit Disiplinor.

Në pjesën e amendamenteve kushtetuese, kur flitet për ILD-në, dispozita 147 “f”, thuhet: “Tribunali Disiplinor përbëhet nga kryetari i Gjykatës së Lartë, 2 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit, kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, 2 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë Administrative sipas ligjit dhe një prokuror i zgjedhur nga radhët e prokurorëve sipas ligjit.”

E para, ne nuk kemi problem në ekzistencën e tribunalit disiplinor, pra çështjet që ne ngremë nuk kanë të bëjnë me ekzistencën e tribunalit. Ai le të jetë, nuk ka problem. Ne kemi problem dy çështje që kanë të bëjnë me përbërjen.

a) e para, kjo përbërje të mos jetë në këtë formë, pra kryetari i Gjykatës së Lartë, 2 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit. Përbërja duhet të përcaktohet në Kushtetutë, të mos i lihet një ligji të mëpasshëm, sepse ashtu si të gjitha organet e tjera, duhet të përcaktohet këtu.

b) e dyta, anëtarët e Tribunalit Disiplinor të japin llogari për vendimet që do të marrin, pra çështja e përgjegjshmërisë së këtyre anëtarëve për çështjet disiplinore. Pra, dështimi i gjithë këtyre viteve për të larguar gjyqtarët nga sistemi i drejtësisë, kur ata kryejnë shkelje, nuk ka ndodhur në të shumtën e rasteve për shkak se ministrat kanë qenë apatikë. Ata kanë bërë kërkesa dhe kanë dështuar në KLGJ, e cila përsëri ka në përbërje të vet gjyqtarë; kanë dështuar pastaj sërish në Gjykatën e Lartë, kur është mbledhur këshilli, kolegji dhe nuk shkonte ministri, por shkonin ata që ishin dëmtuar. Ky mekanizëm ka dështuar jo për shkak se ministrat në këta 25 vjet nuk kanë qenë aktivë, por për shkak të korporatizmit që ka funksionuar brenda, pra për shkak të konfliktit të interesit; këtu korporatizmi dhe konflikti i interesit ruhet. Më e keqja është se anëtarët e tribunalit disiplinor nuk japin llogari askund për rastet e procedimit disiplinor.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ankimet kundër vendimit? Jo, ajo është procedura e ankimit në Gjykatën Kushtetuese, ku thuhet e kanë dhënë mirë apo jo, pra është tjetër gjë. Anëtarët e tribunalit disiplinor duhet të japin llogari para dikujt nëse e kanë dhënë mirë apo jo, pra konflikti i interesit ndërmjet KLGJ-së dhe tribunalit disiplinor. Këtu mendoj se duhet të ndalemi, sepse nuk është çështje politike, por është çështje e parimit *checks and balances*.

Çfarë mendojmë ne për konfliktin e interesit ndërmjet ILD-së, Tribunalit Disiplinor dhe KLGJ-së? Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të inspektojë anëtarët e KLGJ-së.

Dakord, sepse anëtarët e KLGJ-së duhet të kontrollohen. Shumë dakord! Inspektori çështjen e KLGJ-së do ta çojë tek Tribunali Disiplinor. Kjo është rruga apo jo, në qoftë se dështon? Tribunali Disiplinor ka të drejtë të shkarkojë inspektorin e Lartë të Drejtësisë, pra inspektori e çon çështjen te KLGJ-ja, KLGJ-ja te Tribunali Disiplinor. Kur shkon inspektori tek Tribunali Disiplinor, ai e shkarkon direkt inspektorin, pra e emëron parlamenti dhe e shkarkon tribunali. Ky është konflikt i pastër interesi.

Inspektori nuk mund të bëjë asgjë kundër Tribunalit Disiplinor, sepse ata e shkarkojnë. Kjo është një çështje e kompleksitetit të sistemit.

Cila është zgjidhja? Ne mendojmë se ekspertët duhet të gjejnë kontrollin e balancave ndërmjet KLGJ-së dhe ILD-së, ndërmjet KLGJ-së dhe Tribunalit Disiplinor, si dhe ndërmjet inspektorit, Këshillit të Lartë Gjyqësor që ai inspekton dhe tribunalit, që e shkarkon inspektorin. Ky mekanizëm është kompleks. Në të gjithë këtë mekanizëm janë 18 gjyqtarë, përfshi këshillin e emërimeve, pra 12 gjyqtarë, që kanë përballë vetëm një njeri, që është inspektori i ILD-së. Ne duhet ta zgjidhim këtë proces, sepse ka dështuar gjatë gjithë kësaj kohe. Ne nuk sjellim asgjë pozitive, nuk e bëjnë llogaridhënës sistemin. Ky është problemi që ka të bëjë me pikën 3, pastaj vazhdojmë me pika të tjera.

Fatmir Xhafaj – Unë kam një merak. Për këto çështje ka ndonjë rezerve Komisioni i Venecias apo keni ju, sepse nuk po e lexoj këtu? Po shikoj shqetësimet që janë tek opinioni final i Komisionit të Venecias dhe nuk e gjej.

Eduard Halimi – Për ne kjo çështje adresohet te paragrafi i 11-të i Komisionit të Venecias, ku thuhet: “Nga pikëpamja teorike është e vështirë të themi se cila nga këto institucione të reja nuk është e nevojshme, pra ILD-ja është e re, KLGJ-ja është e re, TD-ja është e re, ILD-ja është e re e me radhë”.

Fatmir Xhafaj – Tani, ju flisni për ekzistencën apo për funksionin? Paragrafi 11 flet për ekzistencën, që të mos ngatërrojmë qepët me mollët.

Eduard Halimi – Ja qepët dhe mollët bashkë, po themi, hahen ngadalë-ngadalë.

Pra, thuhet: “Ka një argument të fortë për ekzistencën e këtyre institucioneve. Në përfundim, i takon ligjvënësit kombëtar të hartojë sistemin e kontrollit dhe të ekuilibrave”. Unë e kam te kontrolli dhe ekuilibrat, që na takojnë neve, si ligjvënës, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Pra, nuk keni gjë për strukturën?

Eduard Halimi – Për përbërjen e tribunalit...

Fatmir Xhafaj – Komisioni i Venecia e quan të mbyllur çështjen e tribunalit. Doni ta hapni?

Eduard Halimi – Unë po flas për paragrafin 11, pra kemi kontroll ...

Fatmir Xhafaj – Mos e përdorni paragrafin 11 si shpërdorimi i detyrës një herë e një kohë, si një thes që doni ta mbushni. Ju keni gjetur një thes dhe i fusni aty të gjitha.

Eduard Halimi – Lidhur me përbërjen, që përbërja e tribunalit do të jetë e fiksuar në Kushtetutë, kjo është në mënyrë të padiskutueshme, sepse po të thuash tani se do ta bëj me ligj të veçantë këtë gjë, kur të kalojë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po lexoj germën “F” të 147-ës, ku thuhet: “Dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit...”, pra që ta lëmë ne “sipas ligjit” kur kemi Kushtetutë, kjo gjë nuk ndodh, sepse duhet ta përcaktojmë në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Kë?

Eduard Halimi – Përbërjen.

Fatmir Xhafaj – Por e ke përbërjen.

Eduard Halimi – Po, pra kryetari i Gjykatës së Lartë, 2 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë sipas ligjit. Kush janë dy gjyqtarët e Gjykatës së Lartë...

Fatmir Xhafaj – Zgjidhen sipas ligjit.

Eduard Halimi – Sipas kujt ligj?

Fatmir Xhafaj – Ligjit që do të jetë për tribunalin.

Eduard Halimi – Po, pse? Unë e kam këtu Kushtetutën. Unë jam këtu, duke ...

Fatmir Xhafaj – Po pse, Rregullore do ta bësh Kushtetutën? Ti deri tani je ankuar për këtë gjë.

Eduard Halimi – Jo, duhet vendosur këtu në Kushtetutë si është përbërja, siç e ke edhe për të tjerët. Nuk do ta vendosësh në ligj, kur të bëhet ligji me 84 vota. E kemi këtu tani, ta vendosim tani këtu, jo te ligji me shumicë 3/5-ash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para, me përbërjen që do të përcaktohet këtu dhe jo ta përcaktoni ju nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, përbërja duhet përcaktuar tani, sepse nesër do të thuhet përsëri: gjyqtari më i vjetër në moshë, gjyqtari më i vjetër, ai që është me flokë, ai që është pa flokë, pra do të bëhet nesër përsëri, siç është bërë. Nuk kam besim se do të bëhet nesër, prandaj dua të bëhet sot, të vendoset sot përbërja.

Shqetësimi i dytë ka lidhje me kontrollin dhe balancën. Kështu siç është bërë këtu, dhe siç thotë Komisioni i Venecias, këta nuk i japin llogari askujt.

Fatmir Xhafaj – Më trego një paragraf te raporti i Komisionit të Venecias ku flitet për tribunalin e drejtësisë?

Eduard Halimi – Po këtu, te “kontrolli dhe balancat”.

Fatmir Xhafaj – Sipas kësaj pike, i bie që t’i kapësh të gjitha institucionet.

Eduard Halimi – Unë i kam rreshtuar, nuk kam pse të kap të tjera. Nuk kam të tjera.

Fatmir Xhafaj – Jo, thjesht duam ta dimë se mos na ka shpëtuar gjë dhe e keni lexuar ju më mirë.

Eduard Halimi – Dihet se kush e ka lexuar më mirë.

Tani, këto janë sistemet. Këto janë institucionet që kemi ngritur. Komisioni i Venecias thotë: kontrollo, *checks and balances*! Vendoseni ju!

Fatmir Xhafaj – *Checks and balances* është ndërmjet pushteteve, pushtetit gjyqësor dhe atij legjislativ.

Eduard Halimi – Ku është pushteti legjislativ te tribunali, te këshilli i emërimeve? Zero. E keni zero.

Fatmir Xhafaj – Jo, ishte raporti i madh ndërmjet pushteteve, nuk është në mekanizma. E ke kuptuar gabim parimin e *checks and balances*.

Eduard Halimi – Jo, nuk është te përbërja. Nuk e kam te përbërja, por e kam te llogaridhënia. Ata nuk i japin llogari askujt.

Fatmir Xhafaj – Por, kujt do t’i japin llogari ata?

Eduard Halimi – T’i japin llogari parlamentit. Çfarë thamë më parë për prokurorin e posaçëm, pra të japë llogari prokurori...

Fatmir Xhafaj – Ta thoshte dikush që është i ndonjë komisioni tjetër, do ta kuptoja, por ta dëgjoj nga ju, nuk e kuptoj dot. Po Gjykata Kushtetuese do të vijë të japë llogari në parlament? Tribunali është një institucion gati gjyqësor. Çfarë do të gjykohet? Do të vijë një trup që gjykon, pra trupa e gjyqtarëve do të pyesë: kë do të gjykoj unë? Do të gjykojë gjyqtarët. Tribunali gjyqësor janë gjyqtarë. Pra, është sjellje kundërgjyqësore.

Eduard Halimi – Do të gjykohen shkeljet administrative të gjyqtarëve, pra është një gjykatë, është një trup gati gjyqësore, që do të gjykojë shkeljet e korrupsionit.

Fatmir Xhafaj – Por, a mund të japë llogari një gjykatë për vendimet që ka marrë, pra të vijë para parlamentit, dhe parlamenti të merret me ato që ka gjykuar gjykata?

Eduard Halimi - Çfarë keni zgjidhur atëherë?

Fatmir Xhafaj – Po Gjykata Kushtetuese ku jep llogari?

Eduard Halimi – Gjykata Kushtetuese, në rastin konkret duhet t’i hyjë themelit. Nëse ...

Fatmir Xhafaj – Po çfarë rëndësie ka ...

Eduard Halimi – Është tjetër trupë gjyquese ajo.

Fatmir Xhafaj – Po gjykata janë të dyja.

Eduard Halimi – Gjykata Kushtetuese ka një përbërje, e cila shqyrton vendimmarrjen e parlamentit. Nëse parlamenti ndërhyr te Gjykata Kushtetuese, kjo përbën konflikt interesi.

Shkaku pse ne kemi dështuar me korporatizmin është, sepse kemi 18 gjyqtarë në të gjithë pjesën e kupolës së sistemit të drejtësisë. Kemi ngritur institucione, të cilat i japin llogari vetëm Zotit. Këtë po ju them: gjyqtari, kryetari i Gjykatës së Lartë, jep llogari për drejtimin e Gjykatës së Lartë dhe për çështje si gjyqtar, për çështje civile-penale dhe jo për çështjet e shqyrtimit administrativ në KLD. Po them, për pjesën e shqyrtimit administrativ, do të bëjmë një mekanizëm *checks and balances*, për ta çekuar jo për ta balancuar atë. Kush do të çekojë?

Fatmir Xhafaj – Po KLGJ-ja e gjykon gjyqtarin? Po, apo jo? Por, kujt i jep llogari?

Eduard Halimi – KLGJ-në e ke vetë të përbërë *check and balance*, sepse ke 5 dhe 6, pra ke një sistem aty, por ata japin llogari.

Fatmir Xhafaj – Po, ekzakt. Veprimet e tyre ankohen tek organi më i lartë dhe Gjykata Kushtetuese është në finale fare.

Eduard Halimi - Edhe ata ankohen ...

Fatmir Xhafaj – Ankohen për ankimin kundër vendimeve. Kontrolli i këtyre nuk bëhet nga parlamenti, por shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Japim llogari para Gjykatës Kushtetuese.

Eduard Halimi – Anëtarët e KLGJ-së ...

Fatmir Xhafaj – Tribunali jep llogari para Gjykatës Kushtetuese.

Eduard Halimi – Anëtarët e KLGJ-së kontrollohen nga inspektori, pra inspektohen nga inspektori për vendimet e tyre. Kjo çështje ka qenë që në fillim fare. Pra, para se të bëheshin ndryshimet kushtetuese, u kërkua që anëtarët e KLGJ-së për vendimet që jepnin, (të gjithë i kemi sharë, një herë ne, një herë ju: pse emëruan atë, pse emëruan këtë) jo si gjyqtarë, por për vendimet që jepnin si anëtarë KLGJ-je, duhet të inspektoheshin nga inspektori. E kemi zgjidhur këtë problem, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata mbajnë përgjegjësi personale për vendimet e tyre, apo jo? E kemi zgjidhur këtë problem. Po, tribunali, që është i gjithi i përbërë vetëm nga gjyqtarët, sepse KLGJ-ja është e përbërë, edhe andej edhe këtej, a do të japin llogari këta për vendimet e tyre?

Fatmir Xhafaj – Po, japin në Gjykatën Kushtetuese. Vendimet e tyre i shqyrton Gjykata Kushtetuese.

Eduard Halimi – Vendimet si vendime kolegjiale, jo si vendime personale.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka vendim personal, ka vetëm vendim kolegjial aty. Mblidhet trupa dhe vendos.

Eduard Halimi – Po vendimet e KLGJ –së janë kolegjiale, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Kolegjiale janë.

Eduard Halimi – Dhe nuk japin përgjegjësi aty. Çfarë inspektojnë anëtarët e KLGJ-së.

Fatmir Xhafaj – Ata mund të kenë raste etike, të gjitha çfarë kanë individualisht, raste korruptive e të tjera me radhë.

Eduard Halimi – Që të kenë lidhje me veprimtarinë e tyre si gjyqtarë.

Fatmir Xhafaj – Vendimet e tyre nuk i inspekton njeri. Anëtarët e KLGJ-së nuk i inspekton njeri për vendimet, për sjelljen e tyre, për ushtrimin e përgjegjësive që ata kanë.

Eduard Halimi – Pra, anëtarët e KLGJ-së nuk inspektohen për vendimet e tyre?

Fatmir Xhafaj – Patjetër. A the: kundër vendimeve të tyre. Pra, kundër vendimeve të tyre ankohen.

Eduard Halimi – Kjo është përsëri korporatë.

Pra, përbërja duhet të fiksohet në Kushtetutë dhe jo t'i lihet ligjit.

Fatmir Xhafaj – Si ta vendosim në Kushtetutë?

Eduard Halimi – Mënyra si do të bëhet; cilat janë kriteret. Pra, siç vendosëm për KLD-në, që do të jenë kriteret në Kushtetutë për anëtarë KLD-je, do të jenë edhe këtu për ...

Fatmir Xhafaj – T'ua lëmë si detyrë ekspertëve, sepse çështje teknike është.

Eduard Halimi – Pra, të vendoset në Kushtetutë për këta. Madje pjesën e të qenit të të gjithë udhëheqësve, nuk e çmoj si zgjidhje. Mund të vihet në pjesën e të qenit kryetar i Gjykatës së Lartë në tribunal disiplinor, kryetari i Gjykatës së Lartë te këshilli i emërimeve, kryetari i Gjykatës së Lartë në tre vende. Kështu mund të jetë më vunerabël. Ata duhet të kenë mandate 3 vjet, 5 vjet nuk mund t'i kenë. Le të jetë me rotacion. Mund t'i zgjedhë trupa, t'i zgjedhë Gjykata e Lartë: një vit njëri, një vit tjetri, të shmangim pjesën e bërjes shokë të gjithë, miq dhe hajde të mbrojmë njëri-tjetrin. Le t'i zgjidhim.

Ne, si opozitë, nuk kemi ndonjë shqetësim për këtë gjë. Kjo është për ta bërë më mirë sistemin: të mos jenë për 3 vjet, të jenë për një vit. Le të zgjidhet ai tjetri që do të jetë prapa, pra të mos jenë klubi i këtyre të gjashtëve, që do të zgjedhin atë.

Mund të jetë edhe një zgjidhje tjetër. Le të hidhet me short se kush do të jetë për tribunal disiplinor për gjashtë muaj, siç është te këshilli i legjislacionit, pa e ditur se kush do të jetë kryetari. Të shmanget çfarë të shmanget në këtë histori, pra dështimi i të gjithë procesit disiplinor, sepse dy gjëra janë: emërimi, procedimi. Këto të dyja kanë qenë në të gjithë pjesën e arkitekturës. Të shmangim pjesën e krijimit të një klubi atje.

Mundësisht, ekspertët ta shohin edhe një herë pjesën e përbërjes për çështjen e anëtarëve, pra të fiksohen në Kushtetutë kriteret se kush do të jetë anëtar. Mund të mos jetë kështu, (por meqenëse u emërova kryetar unë, prit se kam edhe këtë postin tjetër), le të jetë nga një vit e nga një vit, pra të rinovohet një herë në vit, ndoshta edhe kryesimin ta kemi me rotacion. Pra mekanizma, që marrin korporatizmin, pra mbrojtjen e gjyqtarëve të korruptuar. Po ndryshuan shpejt ata, ndoshta pastaj do t'i kapin shokët e miqtë, se nuk i dihet se kur vijnë përsëri, ndërsa kur e dinë që për 3 vjet është x-i, y-i dhe filani, atëherë mund të turren.

Lidhur me pjesën e kontrollit dhe balancave, kjo është një çështje tjetër jona. Jua thashë edhe paradite: nuk e kemi kusht që po nuk e ndryshuat, ne nuk japim votën. Nuk është kjo. Çështjet tona kanë të bëjnë më tepër me kapjen politike. Në momentin që zhvishen nga kapjet politike, opozita është më e lirë. Mendoj se kështu siç është, përsëri do të jetë korporatizëm, kurse ju mendoni se nuk do të jetë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në parim, ne kemi rënë dakord të ecim në bazë të dokumentit të Komisionit të Venecias. Kjo që ju sapo ngritët nuk përfshihet në ndonjë koment të Komisionit të Venecias, për t'u diskutuar si çështje politike, madje as teknike.

Lidhur me shqetësimin tuaj për korporatizmin, unë mendoj se një nga të mirat e gjithë këtij sistemi të propozuar është se shmang çdo unilateralizëm. Mendoj se ne duhet ta nënvizojmë faktin e unilateralizmit, që ekziston sot me funksionin aktual të sistemit gjyqësor. E kam fjalën te vendimmarrjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili edhe të emëron, edhe të shkarkon, pra në esencë, korporata krijohet kur kemi të bëjmë me të njëjtët njerëz që të emërojnë dhe të shkarkojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Po ta vini re, është ndarë procesi i rankimit, i emërimit dhe i dënimit.

Ju ngritët problemin se parlamenti ka të drejtë të propozojë inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe ngritët shqetësimin se ky inspektor, emërohet nga parlamenti dhe shkarkohet nga tribunali. E trajtuat këtë si problem që prek parimin *checks and balances*. Në fakt, unë mendoj se ky sistem i ri i balancimit brenda vetes në sistemin gjyqësor na thotë shumë qartazi

një gjë: në çështjet profesionale politika të mos fusë duart, çka do të thotë se inspektori i Lartë i Drejtësisë shkarkohet për dy arsye:

a) Kryhen shkelje të rënda profesionale.

b) Është dënuar me vendim të Gjykatës së Formës së Prerë.

Madje, aty ku thuhet: “edhe etike” më duket se mund të keqpërdoret. Nuk e di pse duhet të jetë këtu, sepse “profesionale” nënkupton edhe “etike”, pra dënimi i gjyqtarëve do të bëhet nga gjyqtarë. Pra, në esencë, emërim-çëmërim do të jetë brenda sistemit. Në të gjithë këtë sistem, politika duhet t’i ketë duart lart.

Për sa i përket inspektimit, po. Politika, bazuar në *checks and balances*, do të emërojë inspektorin e vet, por kur ndërrohen maxhorancat, për arsye të çuditshme, shkelje të rënda profesionale apo etike mund të përdoren nga maxhoranca të ndryshme për të goditur inspektorin dhe për të prishur balancën e brendshme të sistemit.

Prandaj, mendoj se duke vënë shkarkimin tek tribunali, në thelb, ne garantojmë më shumë, jo paprekshmërinë e korporatës, por mosndërhyrjen e politikës, sepse sot që flasim ndërhyrja e politikës ka krijuar korporatizmin.

Sistemi, kështu siç është bërë, në thelb, duket i komplikuar, por ai ka shmangur një fenomen, i cili ekziston sot, prepotencën. Në këtë sistem, kështu siç është shkruar këtu, nuk ka të fuqishëm, ose më saktë, të plotfuqishëm. Ka një varg detajesh, në pamje të parë të komplikuar, por që kanë dy esenca të thjeshta: shmang ndyrjen e politikës dhe i detyron të gjithë pjesëmarrësit në sistem, t’u referohen procedurave dhe standardeve të shkruara në letër.

Eduard Halimi – Kështu do të ngelemi sërish te rrethi vicioz. Një gjyqtar para disa ditësh, pra ajo trupë gjyqësore, liroi një trafikant të kërkuar nga Franca. Ministri kërkoi ndjesë. Ku do të shkojë? Do të shkojë tek inspektori i Lartë i Drejtësisë, do ta çojë në KLGJ? Do ta rrëzojë KLGJ-ja. Do të shkojë te tribunali? E rrëzon edhe tribunali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kush do të shkojë në Gjykatë Kushtetuese? Për çfarë do të shkojë? Do të shkojë ministri, se iu prek e drejta? Nuk ka nevojë të shkojë. Në Gjykatën Kushtetuese shkohet për çështje të së drejtës. Do të dalim sërish te pyetja: kush do ta mbajë përgjegjësinë për gjendjen e lartë të korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në sistemin gjyqësor? Ministri e ka bërë punën e vet: 20 i çon te njëri, 30 tek tjetri, 10 të tjerë diku tjetër, pra do të ngelemi te ky rreth vicioz, ku njerëzit e drejtësisë do të mbrojnë njëri-tjetrin. Pra, inspektorin do ta shkarkojë tribunali. Atëherë, çfarë do të bëjë inspektori? Do t’i kundërvihet tribunalit? Ata e shkarkojnë për 5 minuta, për shkelje etike, sepse ke ardhur pa kollare, por nuk është ky

problemi. Ata janë në konflikt interesi me njëri-tjetrin. Unë që të kontrolloj, dhe ti më shkarkon mua.

Është konflikt interesi në këtë pjesë, por mënyra se si do të funksionojë, që përsëri të gjitha pushtetet edhe të emërimit, edhe të shkarkimit i ka përsëri sistemi gjyqësor, pa dhënë llogari askund, madje inspektori nuk jep fare llogari as tek ty më, sepse nuk ka punë fare me ty, ka punë me ata, sepse ti as e shkarkon dot më, është absurditet më vete pastaj, por do të shkojmë atje dhe besoj do ta zgjidhin ekspertët. Por, nëse unë të emëroj, ti duhet të japësh llogari tek unë. Tani, unë të emëroj dhe ti sapo emërohesh thua: “Ik, nuk kam punë me ty, ta kem mirë me gjyqtarët, sepse ata më shkarkojnë, ti nuk më shkarkon dot. Ç’punë ke ti? Ik tutje!”

Ky është absurditet. Ne ecim me historinë: ç’të bëjmë, kështu na doli inspektori! E zgjodhëm inspektorin, por ç’të bëjmë, kështu na doli Eduard Halimi, i papërgjegjshëm apo i paaftë. Çfarë të bëjmë? E shtyjme edhe pesë vjet të tjera.

Tani, meqenëse është momenti për të marrë vendime të rëndësishme për të ardhmen, mendoj se duhet të ndalemi këtu, prandaj e kisha si shqetësim. Kështu siç është, nuk zgjidh asgjë.

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë, sepse po i kthehem një çështjeje që nuk është fare në raportin final të Komisionit të Venecias, ndërkohë që në raportin e ndërmjetëm ka pasur disa sugjerime, plot 6, dhe që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë i ka marrë në konsideratë të gjashta.

Çështja që ngre zoti Halimi, lidhur me konfliktin e interesit, nuk flitet në gjendjen aktuale që ka ardhur dispozita 147 “f”. Raporti i ndërmjetëm flet për një konflikt të mundshëm interesi, në mënyrën se si ishte neni 49 i draftit të mëparshëm, pra, jo draftit final, që ka shkuar për opinionin përfundimtar. Mendoj që konflikti i interesit është eliminuar dhe do t’ju jap shkurtimisht 5 arsytet:

E para, në qoftë se do t’i referoheshim formulimit si ka qenë dispozita, kryetari i Gjykatës së Lartë do të ishte në konflikt interesi nëse ne do të linim komisionet e pavarura të kualifikimit të shqyrtoheshin nga tribunali. Kjo gjë është hequr.

E dyta, është hequr prania e ministrit të Drejtësisë dhe e Prokurorit të Përgjithshëm. Në raportin e ndërmjetëm në paragrafin 73, Komisioni i Venecias thotë se prania *ex officio* e Prokurorit të Përgjithshëm si anëtar *ex officio* e tribunalit mund të ishte një konflikt interesi kur do të shqyrtonte masat për prokurorin e Përgjithshëm.

Në këtë kuadër, mënyra si është formuluar pika 1 e nenit 147/f, që i jep kompetencë tribunalit disiplinor të vendosë lidhur me masat disiplinore për Prokurorin e Përgjithshëm, ku

te grupi i ekspertëve të nivelit të lartë e kanë hequr Prokurorin e Përgjithshëm nga përbërja, ka shmangur një konflikt interesi.

E treta, në vendimin e ndërmjetëm Komisioni i Venecias ka shprehur shqetësimin lidhur me praninë e tri anëtarëve më të vjetër të gjykatave, por nuk thotë që nuk duhet të ketë anëtarë të gjykatave, por shprehet që anëtari jo detyrimisht duhet të jetë më i vjetri, por thotë, ai që ka shërbyer më gjatë në gjykatë.

Pra, shqetësimi që ju po ngrini, që ka një kryetar të Gjykatës së Lartë, ka edhe dy gjyqtarë, thoni ju, që nuk e dini si do të zgjidhen, dhe ata janë gjithmonë në konflikt interesi, Komisioni i Venecias nuk e ka gjetur në raportin e ndërmjetëm si konflikt interesi. Absolutisht, ka folur për profesionalizimin e tyre dhe jo detyrimisht duhet të jetë më i vjetri në moshë, por më i vjetri që ka shërbyer në gjykatë. Kjo, madje, hedh poshtë atë çfarë ju thatë në seancën e mbledhjes së mëngjesit. Ndërkohë, në paragrafin 71 dhe 73 të raportit paraprak Komisioni i Venecias e ka cilësuar si një arsye, në raportin e ndërmjetëm, te tribunali. Atëherë, lexoni paragrafin 71, ku thuhet: “Një opsion më i mirë është nëse përvoja e gjatë shihet si avantazh do të ishte që në çdo rast të emërohet anëtari që ka shërbyer më gjatë në gjykatë”. Flet për tribunalin disiplinor. Ju nuk e gjeni te raporti final i Komisionit të Venecias, sepse ai është shprehur qartë që ky problem...

(Diskutim pa mikrofon.)

Ju lutem, të mbaroj dhe pastaj ndërhyini!

Pra, në raportin e ndërmjetëm, po kërkoj ndjesë që po i rikthehem raportit të ndërmjetëm, sepse në raportin final kjo çështje nuk është në diskutim, por meqenëse ju po e ngrini problemin e konfliktit të interesit po jua citoj. Ka folur për konflikt interesi në paragrafin 73, meqenëse parashikohej që pjesë e tribunales ishte prokurori i Përgjithshëm eksoficio, dhe kompetencat e tribunalit disiplinor të drejtësisë ishin masat disiplinore kundër prokurorit të Përgjithshëm. Ky ishte konflikti i pastër i interesit. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë e ka shmangur këtë konflikt interesi. Biem dakord?

Marrim pjesën e dytë. Në diskutimin tuaj thatë që ka nja dy gjyqtarë aty që nuk dihen si do të zgjidhen dhe ata gjyqtarë do të krijojnë korporatë, sepse do të gjykojnë kolegët e tyre. Po t’i kthehemi raportit të ndërmjetëm të Komisionit të Venecias, tashmë, paragrafi 71, nuk thotë që pasja e këtyre gjyqtarëve këtu është konflikt interesi. Jo, sepse ky tribunal ka kompetenca shumë të rëndësishme dhe prania e tri gjyqtarëve më të vjetër të gjykatave nuk është domosdoshmëri zgjidhja më e mirë, por një opsion më i mirë. Nëse përvoja e gjatë shihet si avantazh, do të ishte që në çdo rast të emërohej anëtari që ka shërbyer më gjatë në

gjykatë. Pra, nuk thotë që është në konflikt interesi nëse një anëtar i Gjykatës së Lartë apo dy, është pjesë e këtij tribunali.

Gjithashtu, ajo që është pozitive dhe që e shmang konfliktin e interesit është që këtij tribunali i është hequr kompetenca të shqyrtojë ose të veprojë si instancë disiplinore mbi komisionarët e pavarur të kualifikimit. Edhe kjo e ka shmangur.

Gjithashtu, është hequr edhe ministri i Drejtësisë. Ky ka qenë debati më i madh që kemi bërë në mbledhjet e kaluara. Ndërhyrje politike nuk duam dhe bëjmë mirë që nuk duam. Pavarësi të qeverisë së gjyqësorit që në çdo mbledhje në Komisionin e Ligjeve ku do të thoni duhet të krijojmë qeverinë e gjyqësorit, qeverinë e pavarur të gjyqësorit etj, ja ku po vijmë te qeveria, edhe te mekanizmat si ta kontrollojë këtë qeveri të gjyqësorit dhe si do të funksionojë. Çfarë mund të kërkojmë më shumë?

(Mungesë incizimi.)

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, urdhëroni!

Arben Ristani – Së pari, duhet të biem dakord që për ne kapja politike është kusht. Kur themi që duhet ta përcaktojmë këtu përbërjen, pa e lënë që të caktohet nesër me ligj, kur themi që do të përbëhet nga dy gjyqtarë, po them unë, të Gjykatës së Lartë, ideja është se ne kështu përcaktojmë kriteret mbi të cilat do të zgjidhen këta dy gjyqtarë, sepse po e lamë nesër me ligj, ne dyshojmë që shumica mund ta bëjnë ligjin në mënyrë të atillë që t'ia vërë thesin sipas kokës së atij që ka në mendje.

Pra, le të themi, në qoftë se i duhet iks gjyqtar, i cili është 1,90 i gjatë, le të vendoset kushti që duhet të jetë 1,90 i gjatë. Ashtu sikurse ka ndodhur edhe tani. I kemi shembujt. Pra, ne këtë e kemi kusht. Kapjen politike nuk e tolerojmë.

Pjesa e korporativizmit është e lidhur me luftën kundër korrupsionit, sepse në mes është përgjegjshmëria. Përgjegjshmëria është një nga elementet e ekuacionit të korrupsionit. Sa më të përgjegjshëm të jenë qeveritarët, zyrtarët, gjyqtarët, aq më i ulët do të jetë niveli i korrupsionit.

Te niveli i përgjegjshmërisë ndikon shumë pjesa e korporativizmit, pjesa e llogaridhënies, por në logjikën e fundit është maxhoranca që po bën këtë reformë, pavarësisht se ne po japim kontributin tonë. Pra, do të jepni ju llogari nesër përpara popullit. Kështu që në këtë pjesë ne kundërshtojmë, por, gjithsesi, përgjegjësia e madhe është juaja.

Ne mendojmë se është më mirë ta bëjmë kështu: të vendosim mekanizma llogaridhënieje, në mënyrë që të rrisim përgjegjshmërinë, sepse duke rritur përgjegjshmërinë zvogëlojmë korrupsionin.

Edhe një herë po e përsëris, kapjen politike e keni kusht. Prandaj thamë që kriteret, përzgjedhjen, përbërjen e tribunalit duhet t'i vendosim këtu, në mënyrë që nesër të mos kemi diskrecion.

Fatmir Xhafaj - Ne kemi një shmangie nga parimi ose nga ajo që kemi rënë dakord të bëjmë në këtë debat, që të merremi kryesisht me ato çështje që i janë lënë parlamentit.

Kjo është një çështje që nuk duhet të hyjë në ato çështje, që do të duhet të diskutojë politikisht parlamenti, sepse mendoj që është zgjidhur në një farë mënyre nga propozuesit, dhe është mbështetur edhe nga Komisioni i Venecias në të dyja projektet, aq sa në projektin final nuk përmendet fare, sepse i quan çështje të kapërcyera si pjesë e arkitekturës, çështje të kapërcyera si funksione, çështje të kapërcyera për efekt të kontrollit ndërmjet institucioneve etj.

Për sa i përket konfliktit të interesit, ose më saktë të kapjes politike, që tha edhe kolegu Ristani, vetëm këtu nuk ka lidhje për kapje politike, nuk ka lidhje fare politika. Tani duhet ta pranojmë këtë gjë, ose ka, ose nuk ka. Në këtë rast nuk ka lidhje fare.

Për sa i përket çështjes se si do të zgjidhen ata nga Gjykata e Lartë, e vendosim. Koncepti nuk është se zgjidhet më i vjetri apo më i ri. Koncepti këtu është që zgjedhjen mund ta bëjnë me votim nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Ky është koncepti. Nëse duhet detajuar kjo, le t'i pyesim ekspertët. Nëse edhe ata mendojnë që ligji nuk jep garanci, le ta vendosim në Kushtetutë. Në vlerësimin tim është e mjaftueshme kështu siç është thënë, sepse është qartësisht e përcaktuar që do të zgjidhet një nga radhët e gjyqtarëve.

Çfarë konflikt interesi ka këtu? Kjo është e papranueshme për mua.

Së pari, sepse asnjëri nga këta nuk ka ndonjë konflikt interesi me Këshillin e Lartë Gjyqësor; asnjëri nga këta nuk është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo është e qartë. Besoj se nuk ka nevojë për t'u sqaruar më shumë. Kështu që nuk ka konflikt interesi.

Po të nisemi nga përvoja, ne nuk mund të gjejmë një ekstra trupë, sepse do ta marrim brenda radhëve të gjyqësorit, sepse është trupë gjykuesë. Ndryshe, gjykimin e gjyqtarëve do ta bënte një trupë jo gjyqtarësh. Kjo është e papranueshme, është absurde.

Çfarë ndodh sot me gjyqtarët që shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë? Shkojnë në Gjykatë të Lartë.

Eduard Halimi – Anëtarët e Gjykatës së Lartë, nuk mbikëqyren nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, apo jo? Prandaj nuk janë në konflikt ata.

Tribunali do të mbikëqyret nga KLGJ-ja dhe pastaj do të shqyrtohen edhe vendimet e KLGJ-së. Ky është konflikt.

Fatmir Xhafaj – Po edhe gjyqtarët kushtetues do të gjykojnë. Edhe sot çfarë ndodh? Edhe me parlamentin, po të marr një shembull. Kush i zgjedh gjyqtarët kushtetues sot? I zgjedh parlamenti. Kush i shkarkon?

Eduard Halimi – Parlamenti.

Fatmir Xhafaj - Çfarë bën Gjykata Kushtetuese? Rrëzon ligjet e parlamentit. Nuk ka konflikt interesi? Si? Çfarë po thua kështu? Po na çudit të gjithëve!

Pra, gjyqtarin kushtetues e zgjedh parlamenti, e shkarkon parlamenti, dhe sipas konceptit tuaj, nuk ka konflikt interesi. Një trup gjyqtarësh do të gjykojnë gjyqtarët. Çfarë do të gjykojnë? Një rreth të kufizuar gjyqtarësh. Kjo është mjaft e qartë.

Për sa i përket çështjes se a duhet specifikuar Tribunali, jam dakord. Në qoftë se është e nevojshme, ta sqarojmë.

Eduard Halimi – Lidhur me përbërjen ekspertët të përcaktojnë, të shkruajnë në Kushtetutë përbërjen e gjithë Tribunalit Disiplinor. Ta shkruajnë në Kushtetutë.

Lidhur me përbërjen të sugjerojnë që si në rastin e diskutimit, që bëmë paradite, për këshillin e emërimeve, të gjenden formula (ky është sugjerimi ynë), të cilat të shmangin për zgjedhjen apo përqendrimin për një kohë të gjatë në këto këshilla, qoftë në Këshillin e Emërimeve, qoftë në tribunalin disiplinor, në mënyrë që të rifreskohet sa më shpejtë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, ne ia kemi besuar kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të drejtë Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe nuk i besojmë të gjykojë një... I njëjti kriter është. Ata janë të përkohshëm në detyrë. Të gjithë.

Eduard Halimi - Lidhur me çështjen e dytë, unë shikoj konflikt interesi ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe tribunalit disiplinor. Pse? Sepse anëtarët e tribunalit disiplinor janë nën inspektimin e inspektorit dhe shkojnë te Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkelje në detyrë.

Nga ana tjetër, tribunali merr në shqyrtim vendimet e KLGJ-së ku ata vetë janë, po them, subjekt, janë vetë të pandehur te këshilli gjyqësor dhe kanë të drejtë edhe të drejtë të shkarkojnë.

Pra, këtë rreth, ju lutem shumë shiheni edhe një herë dhe na e zgjidhni. Këtu ka konflikt interesi. Sot nuk është konflikt interesi, e di pse? Sepse vendimet kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë i shqyrton Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë nuk është nën ombrellën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe japin mendime sipas vetes së tyre.

Fatmir Xhafaj – Këto do t'i gjykojë Gjykata Kushtetuese në finale. Është pika 3: “Ankimet kundër vendimeve tribunale gjyqësore, të cilat janë ankime kundër vendimeve të

Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.”

Eduard Halimi – Ta lashë Gjykatën Kushtetuese. Tani unë po them që këta i ke në konflikt interesi. Tribunalin disiplinor dhe KLGJ-në i ke. Kur unë jam subjekti yt që do të shkarkohem, unë marr dhe shqyrtoj vendimet e tua. Pra, këtë pjesë merreni dhe shikojeni. Nëse ju çmoni se nuk ka asnjë problem, asnjë konflikt interesi, respektohet parimi i paanësisë në këtë proces, dakord.

Gjëja tjetër që dua të përmend është llogaridhënia. A mund të fusim një komponent llogaridhënie përgjegjshmëri për procesin disiplinor?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se u qartësua. Mund të vazhdojmë me pikën tjetër?

Po, zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Për pikën 4, zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, drafti parashikon që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen me 36 vota. Ka qenë një konstatim edhe i ekspertëve tuaj kohë më parë, që nuk duheshin zgjedhur me 36 vota, siç zgjidhen edhe sot.

Komisioni i Venecias ka parashikuar që ata të mos zgjidhen me 36 vota. Në qoftë se biem dakord që të zbatohet rekomandimi i Komisionit të Venecias, të ecim përpara.

Fatmir Xhafaj – Ne këtu nuk jemi thirrur që të vëmë në diskutim Komisionin e Venecias. Do të merren ata që janë caktuar. Keni ndonjë gjë ?

Eduard Halimi – Ne jemi thirrur të bëjmë rishikimin e draftit në frymën e Komisionit të Venecias.

Fatmir Xhafaj – Për çështje politike.

Eduard Halimi – Emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – E ka thënë Komisioni i Venecias këtë gjë.

Eduard Halimi – Pra, nuk do të zgjidhen me 36 vota, por do të zgjidhen, siç e ka parashikuar Komisioni i Venecias.

Fatmir Xhafaj – Me shumicë të cilësuar.

Eduard Halimi – Me shumicë të cilësuar, siç e parashikon Komisioni i Venecias. Lidhur përsëri me Gjykatën Kushtetuese për çështjen e konstitucionalitetit. Komisioni i Venecias...

Fatmir Xhafaj – Atë e ka thënë Venecia.

Eduard Halimi – Për çështjen e Gjykatës Kushtetuese biem dakord që duhet të jetë me shumicë të cilësuar, siç rekomandohet në paragrafin 39. Të tre anëtarët e Gjykatës

Kushtetuese që zgjidhen nga parlamenti, si edhe ekspertët duhet të implementojnë paragrafin 41 dhe 42.

Paragrafi 43 ka të bëjë me një çështje super të konstitucionalitetit. Komisioni i Venecias ka thënë: “Në çdo rast...”

Fatmir Xhafaj – Komisioni i Venecias e ka mbyllur. Do ta hapësh ti, hape! Paragrafi 43 nuk ka gjë.

Eduard Halimi – Këtë po them edhe unë.

Fatmir Xhafaj – Mos na vono tani! Nuk e ke lexuar? Lexoje!

Eduard Halimi – “Në çdo rast Gjykata Kushtetuese kur zbaton ndryshimet e miratuara, tashmë, do të duhet të konsiderojë tekstin kushtetues në tërësi dhe të interpretojë ndryshimet nisur nga parimet e përgjithshme kushtetuese të përcaktuara në të drejtën themeloret Shqipërisë.”

Këtë çështje unë dua që ekspertët të na i projektojnë. Në cilën frymë? Në këtë frymë që thotë Komisioni i Venecias? Pra, në rast se ne do të miratojmë 50 nene, do të ketë të drejtë Gjykata Kushtetuese që për këto 50 nene të shprehet jo vetëm lidhur me procedurën, sepse me procedurën e miratimit e ka dhënë Komisioni i Venecias, por edhe për përputhjen e këtyre 50 neneve me parimet e përgjithshme kushtetuese të përcaktuara në të drejtën themelore? Këtë këshill të Komisionit të Venecias ne duhet ta implementojmë në pjesën e amendamenteve kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Ta ka sqaruar që në hyrje të këtij paragrafi.

Eduard Halimi – Pra, nëse amendamenti, që gjyqtarët nuk kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Kushtetuese... A ka të drejtë Gjykata Kushtetuese ta shqyrtojë këtë amendament në raport me parimet e përgjithshme? Ka të drejtë?

Fatmir Xhafaj – Jo nuk ka të drejtë. Ka vetëm procedurë.

Ta ka thënë qartë.

Eduard Halimi – Bën interpretim në rastin e mandateve. Pra, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të bëjë interpretimin paqtues. Pra, të paqtojë draftin e amendamenteve kushtetuese me parimet e përgjithshme. Në çdo rast, kur Gjykata Kushtetuese zbaton ndryshimet e miratuara, do të duhet të konsiderojë tekstin kushtetues në tërësi dhe të interpretojë ndryshimet që kemi bërë ne, nisur nga parimet e përgjithshme kushtetuese të përcaktuara në të drejtat themelore të Shqipërisë. Pra, gjykata duhet ta bëjë këtë verifikim.

Amendamenti u bë që gjyqtarët të mos kenë të drejtë të ankohen në Gjykatë Kushtetuese? Ja nuk shkuan në Gjykatë Kushtetuese... E mori Gjykata Kushtetuese dhe thotë: nuk e marr në shqyrtim. Ata do të shkojnë në Gjykatën e Strasburgut, ku do t’u thonë se është

shkelur neni 6 i Konventës. E kthen të gjithë paketën mbrapa dhe ne vijmë sërish njësoj si të çështja e Byrosë.

5-a, pushteti gjyqësor. Çështjen e dy gjykatave të larta. E di që do të më thoni se nuk është nga paragrafi 12 deri në 89 i Komisionit të Venecias. Unë dua t'ju lexoj paragrafin 11, për të qartësuar se çfarë problemi kemi ne me Gjykatën e Lartë Administrative. Ju në fillim keni shprehur që ta ngremë menjëherë, tani e keni shtyrë në vitin 2020. Ne shqetësim politik nuk kemi me thënë të vërtetën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Këtu kemi çështjen e dy gjykatave dhe çështjen e emërimit të anëtarëve në Gjykatën e Lartë jashtë sistemit gjyqësor.

Fatmir Xhafaj – E para, nuk është politike, the. Nuk e ke kauzë.

Eduard Halimi – Nuk është çështje e opozitës, po them. Politike e kam. Pse e them që është politike? Është politike, sepse ka të bëjë me marrëveshjet politike që duhet të bëjnë forcat politike për arkitekturën e sistemit. Sa gjykata do të bëjmë? Do të bëjmë 5, 10, 20? Kjo është politike. Do ta ndërtojmë tani apo pas 5 vjetësh, apo 3 vjetësh?

E para, pse duhet të kemi një Gjykatë tjetër të Lartë me kryetar më vete, me staf më vete dhe me gjithë shpenzimet pa fund më vete, së bashku edhe me infrastrukturën më vete, sepse kaq është numri i çështjeve që kemi. Ndërkohë, fare mirë anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative, në qoftë se do të duhen, mund të jenë brenda administratës së Gjykatës së Lartë. Nëse do të duhet të jenë 6, le të jenë 6. Do t'i shtojmë në vitin 2020? Në rregull, le të shtohen në vitin 2020, se ndoshta mund të duhen. Deri në vitin 2020 mund të jenë bërë aq shumë çështje, sa do të na duhet të vëmë edhe 12 të tjerë. Ejani, t'i shtojmë në vitin 2020 edhe 12 të tjerë, por pse duhet ta bëjmë tani me 12 veta, me harxhet dhe me kostot e jashtëzakonshme që ka ngritja e një Gjykate të Lartë më vete dhe me super rroga për të gjithë.

Ju e dini që, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë e kanë pagën njëloj si ministrat, piramida pastaj vjen edhe poshtë. Kryetari i Gjykatës së Lartë e ka pagën sa Kryeministri, në mos gaboj.

Nga ana infrastrukturore në 3 vjet ende nuk është ndërtuar gjykata. Le të bëjmë një gjykatë më vete. E nisëm Pallatin e Drejtësisë dhe u bllokua, sepse doli iksi apo ipsiloni, jo është apo nuk është, kurse paratë dhe fondet ikën për përmbytjet kur ndodhën në Jug para 2 vjetësh. Tani nuk ka as projekt se ku do të ndërtohet Gjykata e Lartë, sepse kjo që kemi ka vetëm 3 salla.

Gjykata e Tiranës është për faqe të zezë. Shqetësimi im është: a duhet të ngremë një gjykatë të re në të gjithë këtë sistem? Nuk më duket rationale. Mbani një gjykatë dhe nëse

janë 17 anëtarë, e jani t'i bëjmë 21. I njëjti diskutim ka qenë edhe para 5 vjetësh. Jam dakord që t'i bëjmë 21 anëtarë, disa i emërojmë tani dhe disa të tjerë në vitin 2020, që ta bëjmë kolegji. Kjo është joeficiente. Pse duhet ta bëjmë? Bëjmë një Kolegj Administrativ me vete. Tani është me 3, le ta bëjmë me 8 pas disa vjetësh.

Fatmir Xhafaj - Lekët njëlloj do të jepen.

Eduard Halimi - Nuk janë njëlloj, zoti Fatmir!

Ti e di shumë mirë, se një gjykatë...

Fatmir Xhafaj - Kolegji është me 6 anëtarë, do të bëhet me 8. Po kaç anëtarë do të ketë edhe Gjykata e Lartë. Kjo është një logjikë shumë e thjeshtë, ka të bëjë me substancën në interes të publikut.

Eduard Halimi - Gjykata e Lartë sot ka 15 gjyqtarë dhe 60 nëpunës në strukturën ndihmëse. Kjo gjykatë nuk do të transferohet se atje do të rrijë, por ne do të ndërtojmë një tjetër Gjykatë të Lartë, e cila do të ketë shumë kosto, siç është edhe kjo që kemi. Kjo është tërësisht e panevojshme për atë kohë sa ligjin "Për zgjidhjen e marrëveshjeve administrative" ia kemi dhënë si autoritet Gjykatës së Apelit, e cila është njëlloj si Gjykata e Lartë, sepse edhe ata kanë dhomë këshillimi që zgjidhin çështjet.

Ne më mirë të ngushtojmë rastet e çështjeve, të cilat shkojnë në Gjykatë të Lartë sesa të zmadhojmë pjesën e Gjykatës së Lartë, pra që të bëjmë dy Gjykata Larta të tjera. Ky është një shqetësim, i cili ka nevojë për një marrëveshje politike.

Ju doni patjetër që të bëjmë dy apo tre gjykata? Unë mendoj se nuk është as e dobishme, as efiçente dhe as në funksion të sistemit gjyqësor efiçent. Është më mirë të kemi një kolegji, është më mirë të kemi një unifikim të praktikës nga një gjykatë, se të merremi me konfliktin e kompetencave ndërmjet njëres dhe tjetres gjykatë, të cilat pastaj do t'i zgjidhë Gjykata Kushtetuese. Ato do të grihen me njëri-tjetrin, siç ka ndodhur edhe më parë, dhe kjo gjë nuk është efiçente. Kjo ishte pika e parë.

Pika e dytë ka të bëjë me hyrjen e njerëzve nga jashtë sistemit në Gjykatën e Lartë. Për këtë pikë ne kemi shprehur qëndrimin tonë, që në Gjykatën e Lartë nuk duhet të hyjnë njerëz nga jashtë sistemit. Në qoftë se duam të bëjmë një sistem gjyqësor të pavarur, le të bëjmë një Gjykatë të Lartë Karriere. Këtë debat ne e kemi bërë në vitet 2007-2008 dhe lamë një dritare me 10%. E bëmë në vitin 2013 dhe lamë një dritare me 25%. Në të dyja rastet ju ishit në opozitë dhe këtë gjë e kërkua ne që ishim në pushtet. Tani jemi ne në opozitë dhe kërkujmë të njëjtën gjë sërish, që ta lemë një gjykatë karriere.

Kjo është një çështje e vullneteve politike. Në sistem nuk ka vetëm magistraturë, por ka edhe të tjerë. Përzgjedhja për magistraturën nuk ka rëndësi se nga kush bëhet,

pavarësisht se kush ka qenë drejtor atëherë, por edhe Sokoli që është sot, sepse unë nuk kam asnjë pikë dyshimi, që përzgjedhja do të jetë tërësisht në përputhje me standardet më të mira. Për 20 vjet nuk kam pasur dyshim fare, prandaj e lemë atje, se nuk do të fusin duart as njëri dhe as tjetri. Sa herë është lënë një dritare, kanë hyrë njerëz, të cilët nuk kanë qenë të përshtatshëm, qoftë nga ne apo edhe nga të tjerët. Unë jam i pari që ju kërkoj ndjesë dhe të tjerët me radhë para dhe pas meje. Prandaj kur ligji është strikt, ia zë dorën ministrit, qeverisë, anëtarëve të KLGj-së dhe të tjerëve me radhë. Le të jemi strikt, Gjykata e Lartë, gjykatë karriere.

Këto dy çështje kisha unë për pikën 4.

Arben Ristani - Lidhur me pjesën e karrierës, ne duhet të bëjmë shumë kujdes, që gjyqtarët, të cilët rriten në detyrë dhe shkojnë në Gjykatën e Apelit, të kenë disa vite eksperiencë në gjyqësorin e Shkallës së Parë, që kur të shkojnë në Apel të jenë të përgatitur dhe me përvojë, në mënyrë që të japin drejtësi.

Për hir të së vërtetës, Gjykata e Lartë është shtylla e sistemit, është ajo që i jep drejtim sistemit për shkak të vendimeve unifikuese, për shkak të kualitetit që duhet të ketë, për më tepër kur jemi në kuadrin e reformës.

Reforma ka konsistuar ose idetë kanë qenë që ajo të kthehet në një gjykatë karriere, pra që njerëzit të shkojnë atje pasi janë pjekur ndër vite, kanë fituar eksperiencën e nevojshme. Kështu që edhe mua personalisht do të më pëlqente dhe kam mendimin që do të ishte vërtet reformë nëse do ta bëjmë pjesë të karrierës, ndryshe, po abuzuar me këtë pjesën jurist i shquar apo i pashquar, sa i shquar, si i shquar, sepse të gjithëve mund t'u themi juristë të shquar kur kanë mbi 15 vjet përvojë pune.

Për sa u përket dy gjykatave, ndarja klasike, për shembull, është penalja dhe civilja. Pse duhet një Gjykatë e Lartë Administrative? E rëndësishme është se mund të jenë: Gjykatë e Lartë Civile apo Gjykatë e Lartë Penale dhe po t'i futësh rëndësisë së gjërave mund ta gjesh edhe këtu këtë lloj ndarjeje.

Ndoshta, në një të ardhme të afërt ne do të shkojmë dhe duhet të shkojmë drejt specializimit të mirëfilltë të gjykatave, ashtu siç do të duhet të kishim gjykatë për minorenët, ashtu sikurse janë bërë edhe ndarjet. Pse duhet patjetër një Gjykatë e Lartë Administrative më vete? Çfarë ndryshimi ka kjo nga një gjykatë penale apo nga një gjykatë civile? Unë nuk e gjej të plotë argumentin se pse duhet patjetër një Gjykatë e Lartë Administrative? Megjithatë, si ta çmoni ju këtë pjesë.

Ka edhe një gjë tjetër: në rast se kjo do të bëhet në vitin 2020, si do t'ia bëjmë tribunalit pastaj? Në tribunal kemi thënë që...

(Ndërhyrje e deputetit Eduard Halimi pa mikrofon)

Arben Ristani - Në rregull, se unë nuk e kam këtu.

Fatmir Mediu - Pa dyshim, duke mbështetur edhe opinionin e kolegëve të mi, do të na duhet ta shikojmë në disa momente.

E para, dua të jap një eksperiencë, të cilën e kam diskutuar me zotin Halimi kur kemi qenë në qeveri. Për mendimin tim ai ka qenë një moment i pakëndshëm për një kohë, kur nga e drejta për të filluar Magjistraturën provoheshin studentë, të cilët kishin mbaruar shumë mirë shkollën në Francë apo në Itali, në universitete prestigjioze, me mesatare 8 dhe 8.5 dhe e drejta për të vazhduar Magjistraturën u jepej atyre, të cilët kishin mbaruar studimet në universitet private këtu me notë mesatare 10. Në universitet private këtu çmoheshin opinionet dhe janë çmuar edhe më pas si universitete jofunksionale. Pra, përcaktimin e këtyre kriterëve duhet ta shikojmë në mënyrë më racionale se si është zhvilluar i gjithë sistemi në Shqipëri. Kjo ishte pika e parë.

E dyta, ka edhe një moment, i cili është paksa paradoksal. Kjo për faktin, sepse nëse flasim që sistemi i drejtësisë në Shqipëri është i korruptuar, atëherë ne po përpiqemi të themi se janë vetëm nga brenda sistemit. Këtë e kam për konsultim, që do ta diskutoj pak më gjatë edhe me kolegët e opozitës.

Unë nuk mendoj se ngushtimi i hapësirës do të na japë atë që është më racionale, por përcaktimi i kriterëve strikte të meritës do të ishte gjëja më e mirë që do të mund të bënim. Cilat janë kriteret e meritës, unë nuk mund t'i them dot. Kurse për sa i përket përjashtimit të njerëzve, të cilët janë marrë me politikë, do të duket sikur, nga njëra anë, ne do të bëjmë reformën në drejtësi, por, nga ana tjetër, nënçmojmë atë çka jemi vetë.

Karriera në politikë nuk duhet marrë si diçka negative, por pozitive, si një aset i shtuar dhe një vlerë e shtuar, kurse kriteret pastaj se kush duhet të jetë nga ajo pjesë, që është marrë me politikë, për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, kjo duhet bërë në mënyrë strikte dhe rigoroze. Pra, në të gjithë këtë ne duhet të qartësojmë veten në atë çka keni ju parashtruar në raport me Gjykatën Administrative.

Unë do të kërkoja nga ana juaj, siç e thanë edhe kolegët, që të paktën të ketë një shpjegim më të qartë: pse duhet Gjykata e Lartë Administrative? Çfarë jep si element apo vlerë të shtuar? Sepse ne e mendojmë si një hallkë, e cila nuk shton ndonjë vlerë, por më tepër shton barrën financiare, burokracinë dhe këtë mund ta bëjë shumë mirë Gjykata e Lartë. Të gjitha argumentet janë parashtruar nga ekspertët e nivelit të lartë dhe nga ju vetë në draftin final.

Lidhur me të tjerat, mendoj se është nevoja për një debat më të gjerë dhe më të hapur ndërmjet nesh, për të përcaktuar edhe një herë kriteret e meritës më tepër se kufizimet brenda llojeve. Kriteret e meritës duhet të jenë më të qenësishme, për të pasur mundësi të përzgjedhjes sa më të drejtë të atyre që duhet të jenë në sistemin e drejtësisë.

Oerd Bylykbashi - Unë do të ndalem përsëri te Gjykata Administrative, duke ndjekur logjikën e kolegëve, por edhe të Komisionit të Venecias, i cili është shumë i qartë në raportin *interim* që ka nxjerrë.

Përveç komentit të qartë të raportit *interim*, që duket një koment me një dozë të fortë ironie, në lidhje me kapacitet ndoshta të pamjaftueshme të Shqipërisë për të përmbushur këto lloj vakancash që do të na krijohen në sistem, duke e nënvizuar edhe vështirësitë që kemi hasur gjatë gjithë kësaj periudhe.

Përtej asaj, Komisioni i Venecias ngre një seri pikëpyetjesh shumë të forta në lidhje me faktin se pse duhet një Gjykatë Administrative dhe rrezikun që mund të sjellë ajo për shkak të një operimi në konflikt midis Gjykatës së Lartë Administrative dhe Gjykatës së Lartë? Gjithashtu, dualitetin e interpretimit, që është më keq akoma, të së njëjtës normë nga dy gjykata të ndryshme. Nëse ka një gjë që e vret perceptimin mbi drejtësinë, përveç korrupsionit, janë edhe standartet e dyfishta në sistemin e drejtësisë. Këtë problem e ka ngritur Komisioni i Venecias dhe nuk ka ndryshuar sot e kësaj dite në draftin që kemi këtu. Dy gjykatat do të bëjnë interpretime të ndryshme të së njëjtës normë, ndaj do të kemi një konflikt dhe jo vetëm në çështjen e kompetencave, është e imja apo është e jotja, dhe këtu do të hyjë në lojë Gjykata Kushtetuese.

Komisioni i Venecias thotë: “Gjykata Kushtetuese nuk mund të futet për të parë çështjen në substancë, por do të kemi një situatë kur e njëjta normë është aplikuar ndryshe, nëse ka ndodhur një gjë e tillë.”

Pse duhet të krijojmë në gjithë këtë rrëmujë në sistemin tonë të lartë të drejtësisë kur e kemi një Gjykatë të Lartë, ku modeli tipik europian dhe amerikan po ashtu është një gjykatë e vetme. Ne mund të krijojmë, ashtu siç e kemi parashikuar deri më sot, kapacitete të specializuara brenda Gjykatës së Lartë. Pra, për gjithë këtë ne do të krijojmë një gjykatë tjetër paralele, madje atipike në sistem, në shkallë të parë dhe Gjykatë të Lartë? Po pse? Ndërkohë, ne sot i kemi të tria shkallët e gjyqësorit, edhe për pjesën administrative. Kështu që në këtë aspekt pikëpyetja është shumë e madhe dhe të gjithë ata që diskutojmë ngrenë supet dhe thonë: “Çfarë është kjo?”

Për çfarë duhet Gjykata e Lartë Administrative? Për të krijuar një pol tjetër pushteti gjyqësor dhe kontrollesh të brendshme. Pse duhet ta komplikojmë sistemin? Ne duhet të

mendojmë se një ditë nuk do të jemi këtu dhe ndoshta të gjithë mund të kemi licencën e avokatit, duke u përpjekur të kuptojmë atë që kemi bërë vetë, duke kaluar mbi kurrizin tonë hallin e madh, të cilin e kemi shpikur me duart tona. Pse të mos e mbajnë të thjeshtë sistemin? Unë besoj se kjo çështje kërkon një rishikim të ftohtë, nëse nuk ka ndonjë prapavijë tjetër nga pas, sepse askush nuk është në gjendje ta shpjegojë utilitetin e kësaj se për çfarë i duhet këtij sistemi kjo mballomë tjetër reformash.

I bëj thirrje logjikës, racionalitetit tonë të përbashkët dhe ta largojmë për një moment veten nga ky fakt, të cilin po e vendosim sot në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ne do të jemi konsumatorë të sistemit të drejtësisë si avokatë, si qytetarë të thjeshtë dhe do ta gjejmë veten në një sistem që njëra gjykatë që mund ta operojë ndryshe nga tjetra.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Majko!

Pandeli Majko - I vlerësoj të gjitha komentet e kolegëve të opozitës.

Do ta nisja logjikën time nga një fakt i thjeshtë. Për t'u bërë gjykatës i çështjeve administrative duhet të japësh provimin. Sipas ligjit kjo do të thotë se duhet të kesh disa aftësi të veçanta. Kjo nuk ndodh për gjykatësit e çështjeve civile apo penale.

Ajo që shtroj në parim është: a do t'i lejojmë gjykatësit penalistë dhe civilistë të unifikojnë vendimet, në vazhdim të çështjeve që janë marrë nga gjykatat Administrative? Kjo ishte e para.

E dyta, ne kemi 7 vetë sot në Gjykatën e Apelit për çështjet administrative. Në bazë të ligjit, në mos gaboj, dhe dua të më korrigjojë zoti Halimi, ata duhet të japin vendimin brenda një muaji. Shkoni atje dhe shikoni se sa është numri i mosdhënies së vendimeve!

Domethënë, ne do ta fillojmë duke pohuar, së pari, krizën që kemi në menaxhimin e çështjeve administrative teknikisht dhe parimisht në unifikimin e gjykimit për këtë çështje. Prandaj, para se ta shohim problemin si një qendër e re pushteti, sepse mua më duket shumë simpliste dhe e pavend, duhet të shikojmë anën tjetër të problemit. Mendoj se edhe për këtë çështje Komisioni i Venecias është shprehur qartë. Prandaj krijimi i Gjykatës së Lartë Administrative do të kishte efekte lehtësuese për sistemin nga pikëpamja teknike dhe do të sillte një risi shumë pozitive në funksionimin e sistemit, sidomos për sa i përket unifikimit të çështjeve.

Për sa i përket futjes së njerëzve nga jashtë sistemit, në mos gaboj, në periudhën e qeverisjes suaj, nuk e di se kush ka qenë ministër i Drejtësisë, në mos gaboj, kufiri i lejimit ka qenë deri te 1/4-ta.

Eduard Halimi - Kam qenë unë në vitin 2013.

Pandeli Majko - Pra, keni qenë ju! Ne ramë dakord në parim që të njëjtët njerëz, por në role të ndryshme kufiri i lejimit ka qenë deri te 1/4-ta. Tani në draftin e përgatitur është 1/5-ta, në mos gaboj. Zoti Xhafaj, më korrigjoni!

Fatmir Xhafaj - Po, është 1/5-ta.

Pandeli Majko - Është 1/5-ta. Pra, ne e njohim dhe e kuptojmë dhe këtu duhet të jemi të qartë. Mbi të gjitha, unë po e ngre si një shqetësim, sepse jemi në diskutim teknik, neve na duhen juristë me përvojë akademike europiane. Imagjinoni sa do të na duhen këta në vazhdim, për t'u lënë një hapësirë, të cilët nga 1/4-ta të bëhen 1/5-ta. Megjithatë, ky është një gjykim që do ta diskutojmë së bashku në vazhdim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zonjë Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Mua më vjen mirë që kolegët e opozitës kanë ndryshuar qëndrim, sepse fillimisht ngritja e Gjykatës së Lartë Administrative është parë në aspektin e një vlerësimi politik, kurse tashmë kanë kaluar në një aspekt më praktik. Pra, e lidhim me burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare, pavarësisht se kjo do të ngrihet në vitin 2020.

Unë do të doja ta ktheja çështjen në argumentet e natyrës juridiko-kushtetuese, meqenëse edhe gjatë diskutimit me kolegët e opozitës u tha se nuk shohin ndonjë argument, pa dashur të përsëris kolegun Majko.

Pa dashur të godas dhe të fyej dikë, unë dua ta nis, në radhë të parë, me çështjen e ngrehinës ose të piramidës gjyqësore administrative që kemi aktualisht në Shqipëri.

Ne kemi gjykata Administrative të Shkallës së Parë dhe një Gjykatë Administrative të Apeli. Kur e krijuam këtë gjykatë me ligjin “Për gjykatat Administrative” kishim shumë diskutime nëse ishim të përgatitur dhe nëse duhej ngritur. Të gjithë së bashku, por sidomos kolegët që në atë kohë ishin në pushtet, ngritëm si argumente: nevojën e natyrës së veçantë të gjykimit administrativ; nevojën e një gjykatë të specializuar; nevojën e specializimit të gjyqtarëve; theksuan ngarkesën e madhe që kishte Gjykata e Lartë; problematikën që kishin vendimet unifikuese dhe ne e kaluam ligjin “Për gjykatat Administrative”.

Ndërkohë, kemi miratuar Kodin e Procedurës Administrative, që sinqerisht është një ndër Kodet më të mira falë asistencës që dha SIGMA dhe kryesisht ekspertët gjermanë, të cilët asistuan grupin e punës. Për të bërë këtë Kod procesi ka qenë shumë i hapur prej dy vjetësh.

Ku jemi sot që ne po flasim? Sot kemi një sistem të përzier. Deri te Gjykata e Apelit ne kemi gjykata të specializuara, por kur vjen puna te Gjykata e Lartë, nuk kemi më Gjykatë të Lartë Administrative të specializuar, por kemi një seksion. Ju do të thoni: “Meqenëse ka një kolegji, pse nuk e ka zgjidhur ai problemin? Unë do ta jap këtë përgjigje: “Nuk e ka zgjidhur problemin”.

Ajo që unë dua të theksoj është: a do të vazhdojmë me këtë sistem të përzier? Për mendimin tim, kështu siç është tani, ka dështuar.

Kolegu Majko e përmendi: 30 ditë është afati i përfundimit të një procesi në gjykatën e Shkallës së Parë, 30 ditë në shkallë të dytë, por sot që ne flasim në Gjykatën e Apelit Administrative ende ka çështje që presin prej 1 viti ose më shumë, sepse kemi vetëm një gjykatë të tillë. A ju kujtohet kur ju thamë se duhet që të ngremë më shumë? Ishit ju që kundërshtuat, por nuk po i hyj këtij problemi, sepse nuk është objekt i këtij komisioni.

Në këtë komision Komisioni i Venecias nuk po diskuton se sa gjykata Apeli duhet të ngremë, sepse ky është problemi ynë, është gabimi ynë. Ndaj, ejani ta gjykojmë, sepse është bërë pa asnjë studim, pa pasur infrastrukturë, pa pasur parasysh kapacitetet e të tjera.

Kalojmë te problemi: pse duhet të kemi një Gjykatë të Lartë Administrative? Argumenti i parë është: a biem dakord se gjykimi administrativ ka një natyrë të veçantë, që nuk e ka gjykimi penal dhe gjykimi civil? Pra, gjykohet në bazë të një Kodi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbaroj unë, pastaj më kundërshto! Pra, gjykohet në bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit “Për gjykatat administrative”.

Në Kodin e Procedurave Administrative kemi futur disa parime shumë të rëndësishme. A ju kujtohet kur kemi futur si risi barrën e provës, e cila është një risi shumë e mirë, apo jo? Kemi futur shqyrtimin *ex officio* në shumë çështje, kemi futur parimin e disponibilitetit dhe shumë parime të tjera. Tani, a mundet një gjyqtar në Gjykatën e Lartë, i cili nuk është i specializuar në çështjet administrative, t’i gjykojë ato?

Në bazë të ligjit organik “Për Gjykatën e Lartë” dhe ligjit “Për gjykatat Administrative” ndodh që një gjyqtar, që sot është në Kolegjin Penal nesër të kalojë në Kolegjin Civil ose një gjyqtar, i cili është në Kolegjin Civil, mund të kalojë në Kolegjin Administrativ. Çfarë ndodh? Me të drejtë kolegu Majko tha: “Kur e ngritëm Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit kemi bërë një shtojcë të detajuar për konkursin, për kriteret, për rolin e Shkollës së Magjistraturës, kërkuam ekspertë të huaj”, pavarësisht se ju i prekët ato dhe nuk i respektuat. Pra, kemi kërkuar specializimin e këtyre gjyqtarëve për çështjet administrative. Tani, për Gjykatën e Lartë

themi: “Jo, nuk ka nevojë, se një gjyqtar civilist dhe penalist mund të kalojë në Gjykatën Administrative”

Problemi i tretë që dua të theksoj dhe besoj se biem dakord: a kemi pasur ne probleme me unifikimin e praktikave në Gjykatën e Lartë? Unë kam dëgjuar me shumë vëmendje kryetarin e Gjykatës së Lartë (unë personalisht dhe zoti Xhafaj kemi qenë në tryezat që ka organizuar), që shpesh ka ngritur problemin që Gjykata e Lartë ka me unifikimin e praktikave gjyqësore. Shpeshherë vendimet e kolegjeve të bashkuara ose vendimet unifikuese vetëm unifikuese nuk quhen, sepse ndahen 9 me 7, 9 me 8, ose kanë krijuar jashtëzakonisht probleme. Atëherë, për aq...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po të mbaroj njëherë! Për aq kohë sa kryetari i Gjykatës së Lartë ka të drejtë të ndryshojë përbërjen e kolegjeve me ligjin aktual (unë nuk e di si do të bëjnë ekspertët e nivelit të lartë tani e tutje në kuadër të paketës), çfarë do të ndodhte me praktikën e çështjeve administrative? A do të kemi problem? Po, do kemi.

A e kuptoni ju, në qoftë se qëndron edhe ajo që tha Ministri i Drejtësisë, që Gjykata Administrative është kthyer si qeveri më vete dhe konkurren qeverinë në dhënien e vendimeve. Pra, kemi ende praktika nga më të ndryshmet që ndiqen.

Ju ngritët një shqetësim për dyzimin midis Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Po t’i referohemi raportit të ndërmjetëm, por edhe raportit final, Komisioni i Venecias e ka thënë qartazi sesi duhet të veprohet në këtë rast. Ajo ka shqyrtuar raportin që duhet të ketë Gjykata e Lartë me Gjykatën e Lartë Administrative.

Unë dua të theksoj se kjo reformë kërkon që ne të kemi një sistem efektiv. Shumica e problemeve që kemi sot janë: kontratat publike, marrëdhëniet me qeverinë, marrëdhëniet me ministrinë, pra ka shumë probleme që janë në kompetencë të Gjykatës Administrative. E pra, në qoftë se duam ta rregullojmë që kjo gjykatë të funksionojë si e tillë, si piramidë, nga baza deri në qendër, ne duhet ta rregullojmë.

Unë nuk mund të bëj një propozim dhe të them: “Ejani t’i shkrijmë. Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit Administrativ t’i kthejmë në Kolegje”, sepse kjo do të ishte një kthim pas. Kurrësi jo, sepse ka investuar BE-ja, ka filluar të krijohet një praktikë, veçse këto gjykata duhet të vazhdojnë specializimin deri në majën e piramidës.

Po i kthehem argumentit të dytë. Ju folët për burime të mjaftueshme njerëzore, burime financiare e të tjerë. Pikërisht, e tha shumë mirë kolegu Majko dhe njëkohësisht po i përgjigjem edhe shqetësimin të kolegut Mediu.

Në ka gjykatë që kërkon profesionistë, që të mos jenë vetëm nga gjyqësori, por të vijnë edhe nga jashtë gjyqësorit, por me meritë dhe me kritere pikërisht, është Gjykata Administrative. Pse e ka këtë nevojë? Sepse natyra e çështjeve që ajo gjykon është disi ndryshe dhe nuk lidhet vetëm me Kodin e Procedurave Administrative, por shpesh gjykohen me Kodin e Procedurës Civile, pasi çështjet janë të natyrave të ndryshme.

Nga përvoja ime, sepse më është dhënë mundësia të bëj një vizitë zyrtare nga Kuvendi i Shqipërisë, kur kam takuar gjyqtarët e Gjykatës së Lartë Administrative, mësova se ata vinin nga KLSH-ja, ose ishin inspektorë, ishin kontabilistë, pra kishin një përvojë shumë të mirë për të gjykuar çështjet administrative në të gjitha problematikat që çështjet administrative kanë.

Dua të theksoj edhe një argument tjetër. Zoti Mediu nuk mund të flasë lidhur me kufizimin e të qenurit politikanë, që po të jesh i përfshirë në politikë nuk mund të jesh gjyqtar. Personalisht nuk mund të flas, sepse jam në konflikt interesi, pavarësisht se vij nga një karrierë akademike edhe unë, 31 vjet karrierë akademike. Kjo është një gjë që nuk e zgjidhim dot ne. Megjithatë, kriteret e meritës janë më se të përcaktuara në ligj. Personalisht jam në konflikt interesi. Problemi që keni për studentët e ekselencës që kanë mbaruar jashtë, që nuk konkurrojnë dot në Shkollën e Magjistraturës pas konvertimit të diplomave, njohjes e të tjera, për shkak të mesatares, mendoj se zgjidhet shumë mirë nëpërmjet kësaj hapësire që lihet dhe ata i keni sot pedagogë nëpër universitete. Pjesa më e madhe e studentëve të ekselencës kanë mbaruar jashtë. Unë i kam pasur kolegë në Fakultetin e Drejtësisë, edhe te publiku, janë edhe te privati. Ata janë një aset, të cilëve ne nuk duhet t'ua mbyllim derën, sidomos kur vjen çështja për ligje dhe praktika, ku bota është shumë e mirë. Ata mund ta kenë të vështirë të jenë prokurorë dhe civilistë, sepse nuk e njohin aq mirë ligjin penal dhe civil shqiptar, por në aspektin administrativ është ligji për gjykatat administrative gjermane” shumë më i mirë se ligji që kemi ne ose Kodi i Procedurave tona.

Ndaj, do të thosha se duhet ta shikojmë në një spektër pak më të gjerë këtë problem dhe se e rëndësishme është që Komisioni i Venecia e ka vlerësuar si një aset këtë pluralizëm të përbërjes së trupave gjyqësore me gjyqtarë dhe jo gjyqtarë në paragrafët e tij 15, 16 dhe 17, por kujdesi që duhet t'u kushtojmë ne është për procesin e nominimit dhe metodën e zgjedhjes së tyre.

Pra, të jetë një proces transparent, të jetë një proces i hapur, të ketë një konkurrim, një garë të ndershme, që të vijnë njerëzit më të mirë. Të tillë njerëz nuk na mungojnë në të gjitha fakultetet e drejtësisë në Shqipëri, apo ata që kanë ardhur nga jashtë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Ka tjetër?

Unë kam një koment lidhur me çfarë u tha.

Së pari, po e filloj nga doza e ironisë që përmendi zoti Bylykbashi. Meqenëse ju referuat opinionit të Komisionit të Venecias, unë po i referohem po atij opinionit, por pikës 36, që shprehimisht thotë: “Ndryshimi kryesor është krijimi i një Gjykate të Lartë Administrative të re. Ky ndryshim mund të ketë efekte të caktuara pozitive”, - thotë Venecia. Si çdo specializim, do të rrisë profesionalizmin e gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjet administrative.

Në opinionin e tij për amendamentet e Kushtetutës së Ukrainës lidhur me gjyqësorin, Komisioni i Venecias mbështeti idenë për të krijuar gjykata të ndara administrative duke theksuar se rrënjosja kushtetuese e gjykatave administrative, të cilat ekzistojnë tashmë në Ukrainë, është, gjithashtu, i mirëpritur. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, drejtësia administrative është një element i rëndësishëm në procesin e kontrollit mbi performancën e administratës publike. Pra, nuk ka ironi.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Dakord. Ke paragrafin më lart, që thotë: “Ky ndryshim mund të ketë efekte të caktuara pozitive si çdo specializim”.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Po, ky ndryshim, krijimi i Gjykatës së Lartë Administrative. Kështu e thotë pika 36.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Nisemi po prapë nga praktika që ka, pa vajtur tek arsytimi i situatës që kemi ne.

Më tregoni një vend që ka sistemin e gjykimit administrativ, dy sistemet që i kemi të ndara më vete, që nuk ka Gjykatë të Lartë Administrative! Kë doni? Gjermaninë? Francën? Italinë? Austrinë? Kudo ku ka dy sisteme gjykimi, mbyllet me Gjykatë të Lartë Administrative, sepse ne kemi krijuar dy piramida. Pra, ne kemi krijuar dy gjykimi, të cilat, njërin e çojmë deri në fund, njërin e bllokojmë te Apeli. Ndarja e dy Gjykatave të Lartë Administrative është një çështje teknike, (jam dakord me zotin Halimi) nuk është një çështje politike, por ka nevojë për një gjykim politik.

Sa është në interes të gjykimit dhe sa është në interes të qytetarit? Në vlerësimin tim, është në interes të gjykimit. Pse? Ne jemi të interesuar për të pasur gjykata të specializuara dhe kemi ndërtuar sot një gjykatë të specializuar, siç është Gjykata Administrative në Shkallë të Parë dhe në Apel. Do të duhet që këtë cikël ta mbyllim në Gjykatën e Lartë edhe për një arsye tjetër, sepse ne sot, të gjithë unifikimin e praktikës nga Gjykata e Lartë, që po i vëmë theksin me reformën e re, e dërtuar në këtë mënyrë, trupa mikse e Gjykatës së Lartë nuk i

shërben shumë unifikimit të praktikës. Përfytyroni që këta janë 1/3-ta e Gjykatës së Lartë sot, kurse qenia më vete do të ndihmojë unifikimin nga një trup e specializuar gjyqtarësh administrativ. Përveç kësaj, karriera do të jetë piramidale, nga Shkalla e Parë, në Gjykatën e Apelit, në Gjykatën e Lartë. Pra, do të kemi edhe karrierë administrative në gjykim administrativ të garantuar.

Çfarë avantazhi tjetër kemi? Kemi shpejtësinë e gjykimit, gjë për të cilën është i interesuar qytetari, por është shumë i interesuar biznesi. Në qoftë se ju kujtohet, një nga presionet e mëdha që ka bërë komuniteti i biznesit kur bëmë këtë diskutim, ka qenë pikërisht mbyllja e ciklit të gjykimit me Gjykatën eLartë Administrative.

Tjetra, cili është avantazhi? Kontrolli i gjykimit administrativ mbi performancën e administratës publike është shumë i rëndësishëm. Logjikisht, qeveria nuk do ta dëshironte këtë, sepse do të krijonim një gjykatë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Sistemi do të ishte i mbyllur, një sistem shumë më eficient, shumë më profesional dhe do ta vendoste çdo administratë publike përpara një përgjegjësie të veçantë, sepse e gjithë praktika jo thjesht dhe vetëm do të unifikohet, por ajo që është shumë shumë e rëndësishme, do të vendoste standarde për mënyrën e sjelljes së administratës publike. Ne kemi nevojë për këtë lloj administrate publike që kemi, për ta përballur me këtë gjë. Pra, janë argumente që kanë të bëjnë me profesionalizmin, janë argumente që kanë të bëjnë me eficientësinë, janë argumente që iu është ngritur edhe shpejtësia, janë edhe argumente që kanë të bëjnë me efektivitetin e gjykimit, që e mbështesin idenë e ndarjes së Gjykatës së Lartë në një gjykatë, duke hequr më vete, duke e ndarë Kolegjin Administrativ, duke e kthyer Kolegjin Administrativ që kemi sot në

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, nuk e ke menduar, por do ta gjykojmë në ligj se si do të jetë, patjetër, sepse ata nuk do t'i hedhësh në rrugë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, patjetër. Nëse kemi nevojë, do ta bëjmë. Do të shikojmë se sa është numri i tyre. Numri që kemi në gjykimin civil dhe penal, nuk ka pse të jetë 17, 18. Këta që janë në kolegji, do t'i çosh në Gjykatën e Lartë Administrative dhe neve nuk na interesojnë shumë njerëzit që janë sot, apo nesër, ne na intereson sistemi që duam të ndërtojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ekzakt edhe kjo. Gjithë ky sistem do të jetë i tillë, që do t'i shërbejë pikërisht një drejtësie administrative shumë më efektive sesa është sot. Kjo është logjika që ne e mbështesim këtë gjë.

Për sa i përket...

Eduard Halimi – Kam dy gjëra për të thënë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Eduard Halimi – Kam dy çështje, për të cilat dua mendimin e maxhorancës. Hyrjen në Gjykatën e Lartë nga jashtë sistemit, e para. Pra, kriteret që kanë të bëjnë me nenin 136.

Fatmir Xhafaj – Neni 24 i projektit, apo neni 136 ekzistues.

Eduard Halimi – Po.

Çështja e dytë ka të bëjë me hyrjen, me sistemin gjyqësor në Shkollën e Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Po.

Eduard Halimi – Në paragrafin 27 të Komisionit të Venecias është thënë se ne e mirëpresim ndryshimin që është bërë, që si gjyqtarët, edhe prokurorët të vijnë nga ata. Mirëpo, ka një shqetësim që dua ta them tani, që ka të bëjë me 179-ën, që ti thua transitore. Ju keni thënë se edhe ata ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë mund të futen nga jashtë sistemit, pra të bëjnë betimin dhe të bëjnë një kurs të përshpejtuar atje. Ka ndonjë reflektim nga ana juaj lidhur me këto dy çështje, që ta mbyllim kapitullin e kësaj?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi – Është këtu brenda sistemit gjyqësor për hyrjen nga jashtë sistemit.

Fatmir Xhafaj – Kemi dy çështje të shtruara për diskutim.

E para, është çështja nëse do të kemi një numër të kufizuar futjesh në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Lartë Administrative nga jashtë sistemit, jo me karrierën e zakonshme? Pra, njerëz që vijnë nga praktika, nga bota akademike e të tjerë. Ne mendojmë se po, duhet të ketë. Pse duhet të ketë dhe çfarë ndihmon kjo, si te gjykimi administrativ, ashtu edhe te gjykimi civil dhe penal?

E para, jo sepse e kemi sot, por këtë qëndrim unë e kam mbajtur edhe kur kemi bërë shqyrtimet për ligjet për Gjykatën e Lartë në vitin 2013. Pse? Për një arsye të thjeshtë fare: gjykimi në Gjykatën e Lartë Administrative është gjykim ligj, që do të thotë se është shumë e rëndësishme çështja doktrinare kur gjykon Gjykata e Lartë. Unifikimi i praktikës është doktrinë.

Ne jemi dëshmitar të një fakti: niveli i gjyqësorit që kemi sot nuk na i mundëson këtë nivel dhe këtë cilësi gjykimi. Kjo është arsyeja që vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë sot janë shumë të dobëta, ky është koncepti im. Janë të pakta, janë edhe të dobëta. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, të mbaroj unë.

E para, do të na duhej për t'i dhënë më shumë mendim vendimmarrjes unifikuese të Gjykatës së Lartë, kemi një numër të kufizuar me kritere rigorozisht të përcaktuara.

Jam dakord me shqetësimin tuaj, jam shumë dakord që të jem edhe mbështetës, që kjo nuk duhet të shërbejë për mundësi abuzimi, le ta rregullojmë në mënyrë të tillë, të vendosim kritere të qarta edhe në Kushtetutë, pastaj t'i detajojmë edhe në ligj për një numër shumë të kufizuar prurjesh nga jashtë sistemit për ta pasuruar vendimmarrjen, sidomos vendimmarrjen unifikuese të trupave gjyqësore të dy gjykatave të larta.

Për sa u përket gjyqtarëve që vijnë nga Shkalla e Parë, e para, biem dakord në parim. Nëse ka ndonjë gjë që nuk është... Unë ndoshta e kam kuptuar gabim, në qoftë se ka ndonjë dritare që kalon jashtë Shkollës së Magjistraturës, unë jam shumë dakord ta mbylлим.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord. Ta mbylлим, në qoftë se ka. Absolutisht duhet të kalojnë nga Shkolla e Magjistraturës. Madje - madje, ne duhet t'i japim status sa më të fortë Shkollës së Magjistraturës, që të mos e ndryshojmë sipas oreksit të partive politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, kur të vijë puna aty, ta vëmë me 81, që të jetë një gjë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nuk e di, nuk ka rëndësi. Por, bie dakord.

Pavarësisht defekteve që mund të ketë pasur prurja e Shkollës së Magjistraturës, ka edhe aty gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që sot përfliten apo akuzohen për korrupsion, një gjë ka shumë rëndësi: kultura juridike është cilësisht e ndryshme, kanë futur elemente të rëndësishme të formimit juridik në sistem dhe ne nuk duhet të çëdojmë nga kjo. Fakti që ka çeduar nga pikëpamja morale, nga pikëpamja e integritetit të tyre, nuk lidhet me bazat profesionale juridike që kanë marrë nga shkolla, gjykoj unë, por me mënyrën se si është ndërtuar sistemi, se si e ka lehtësuar sistemi që edhe një pjesë e këtyre të bien pre e sistemit korruptim që ekziston brenda trupës. Kjo nuk duhet të na bëjë që të çëdojmë nga parimi i përgjithshëm. Përkundrazi, duhet ta forcojmë fort se Shkolla e Magjistraturës është e vetmja

prurje. Sot, po guxuam shumë që të themi jo vetëm e vetmja prurje për këshilltarët, edhe për pjesën administrative, mund ta ...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, më vonë, sot nuk e bëjmë dot, sepse kam frikë se mos hapim portë dhe nga kjo hapje porte mund të na krijohen probleme. Jam dakord me ju.

Tani, vetingu mund të krijojë një vakum. Si mund të mbushet kjo gjë? Pa kaluar nga Shkolla e Magjistraturës nuk do të mbushet. Atëherë do të duhet... Pse? Unë e mbështes idenë që është dhënë aty. Çfarë janë këshilltarët në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë? Janë njerëz që kanë shkruar vendime, janë njerëz që kanë mbajtur një peshë të rëndësishme në vendimmarrjen e këtyre gjykatave.

Tjetra, ata që kanë qenë ish-gjyqtar, por që nuk janë hequr për korrupsion, për...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, një sekondë, ju lutem!

Ne mund të vëmë një kufi, për shembull, gjyqtarë nga vitet '90 e këtej, ku e di unë se çfarë, një gjë të tillë, nuk ka rëndësi, mund të gjejmë një kufi. Unë nuk po flas për gjyqtarë që e kanë ushtruar detyrën para viteve '90, sepse janë 25 vjet. Edhe nëse do të ketë qenë ai para viteve '90, po del në pension tani, nuk do të jetë gjyqtar. Megjithatë, e ke këtë merak?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Doni ta keni këtë merak? E gjejmë një klauzolë që ta frenojmë. Më falni, nuk dua t'i them fare, do t'ju lutesha të mos më keqkuptoni, zoti Ristani. Nuk dua të më keqkuptojë zoti Alibeaj, që nuk është këtu, por po e marr për kazus pozitiv. Ka ikur nga politika, është në punën e tij dhe në vlerësimin tim është profesionist. Unë nuk them dot që ti nuk je profesionist si gjyqtar. Kalon një farë kohe dhe thua: unë dua të jem në sistem.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, pa votim.

Në qoftë se nuk e ke bërë Shkollën e Magjistraturës, do të shkosh që ta bësh, do të jepet mundësia që ta bësh Shkollën e Magjistraturës. Në qoftë se e ka bërë Shkollën e Magjistraturës, nuk kemi pse t'i themi atij ndonjë ditë që të mos kthehet, siç është Alibeaj, për shembull. Ai ka karrierën e vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E ka bërë. Po them si rasti i Alibeajt. Më falni, unë ju kërkoj ndjesë, pasi zotëria nuk është këtu, por po e marr si shembull, në pamundësi për të marrë një shembull tjetër.

Pra, le të gjejmë një zgjidhje, që t'u japim një mundësi këtyre njerëzve të kthehen në sistem. Unë nuk po them të rrijë jashtë. Ai erdhi, bëri një shërbim, i tha shoqërisë që po

shërbente në politikë, në një moment të caktuar iku, ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Unë them se është një njeri me dije, edhe për shkak se ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Pikërisht, këtë po them edhe unë. Ne po e trajtojmë kështu për një arsye. Edhe Venecia e ka trajtuar. Atëherë, mund të gjejmë një zgjidhje. Ai që nuk e ka mbaruar, të kalojë nga Shkolla e Magjistraturës, jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, nuk ka rëndësi. Ideja është që kjo kategori njerëzish, ai njeri... Të jemi të ndërgjegjshëm të një fakti: një njeri që ka shërbyer 10 vjet, 7 vjet, 9 vjet në Gjykatën e Lartë, që ka shkruar 70, 80, nuk gaboj fare të them edhe 100% të vendimeve të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, nuk qenka i zoti, në qoftë se i nënshtrohet shkollës, ose një vlerësimi të Shkollës së Magjistraturës, në një mënyrë, apo në një mënyrë tjetër, të fillojë gjyqtar në shkallën e parë, sesa një që duhet të presim ne? Kjo është logjika që ka qenë. Nuk biem dakord? Nuk biem dakord. Teknikisht, gjeni një zgjidhje! Unë nuk kam asgjë, mjafton që të gjejmë një zgjidhje dhe të jemi...

Kjo është logjika që kishim ne dhe besoj, qoftë për Gjykatën e Lartë Administrative, qoftë për prurjet në Gjykatën e Lartë, që e ngriti si çështje zonja Hysi, zoti Mediu dhe zoti Majko, qoftë edhe për kazusin që diskutuam së bashku.

Fatmir Mediu – Më falni, kam pasur rast konkret. Madje, zoti Halimi e ka pasur vartës, nuk po e nxjerr me emër. Kishte mbaruar shumë mirë në Francë, por nuk i jepej e drejta për shkak të mesatares për të mbaruar Magjistraturën.

(Diskutime pa mikrofon).

Çështja është: a do t'i kemi në rivlerësim një pjesë të këtyre njerëzve, të cilët kanë mbaruar, që kanë kredite dhe meritë shumë të mirë për t'u futur në gjyqësor, qoftë edhe për t'i rikthyer edhe nëpërmjet Magjistraturës?

Eduard Halimi – Ky është shqetësimi. Me sa di unë, ka marrë rrugë, ose duhet të marrë me një propozim që, ata që kanë mbaruar jashtë nuk kanë nevojë të kenë mesataren e njëjtë me këtë që kanë. Ose është në rrugë, ose ka marrë rrugë, nuk jam shumë i sigurt, por që është racional dhe duhet pranuar.

Lidhur me Gjykatën e Lartë Administrative, diskutimet përgjithësisht janë racionale, nuk dua të ngulem shumë në pjesën e saj. Gjykata Administrative ka si parim gjithmonë qeverinë dhe në pozitën që ne jemi si opozitë duam që çështjet administrative të marrin rrugë shumë shpejt. Pra, jemi në krahun e qytetarëve dhe të bizneseve që kanë konflikt me qeverinë që të marrin rrugë, edhe pse fati i keq, i sjellë edhe nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së

Lartë në vitin 2014 bëri që Gjykata Administrative të mbytej, e them me qëllim këtë, që të mundësonte evadimin e shpejtë të çështjeve të gjobave në mënyrë të drejtë, në mënyrë që edhe administrata të vihej përballë, edhe buxheti i shtetit të fundosej. Gjithsesi, nuk janë çështje të këtij komisioni. Opozita nuk ka konflikt politik, edhe për faktin që Gjykata e Lartë ngrihet nga qeveria e re që do të jetë. Pra, nuk ka asnjë shqetësim në këtë pikë....

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Çështja është, dhe përsëri koha është e shkurtër për ta ndërtuar dhe për ta vënë në funksionim. Po ju them se edhe 3 vjet e keni. Megjithatë, nuk dua të insistoj. Këto janë çështje që sërish, ditën që në do t'i miratojmë, mund të reflektojmë dhe të bëjmë ndonjë ndryshim. Jam dakord për këtë pjesë.

Lidhur me qenien anëtar i Gjykatës së Lartë, kriteret kur nuk ke qenë gjyqtar karriere, ky është një debat, sa jetë profesionale ka njëri, sa keni ju, i kemi pasur këto debate. Ka argumente nga të dyja anët, qoftë ajo që thotë zoti Fatmir, qoftë nga ajo që thotë zoti Xhafaj me argumentin që ka mbrojtur që vërtet ka profesionistë, ka një debat të hershëm për këtë, ka profesionistë, profesorë, si, për shembull, Vasilika Hysi, për të qenë në Gjykatën e Lartë dhe racionaliteti, po, dakord, se vlen më shumë ai se sa një kalama që do të ketë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Por, ai për të cilën Partia Demokratike ka insistuar që kur është bërë ligji për Shkollën e Magjistraturës në vitin '96, edhe pas vitit 2005, kur kemi qenë në pushtet, ka qenë mekanizmi që ofron Shkolla e Magjistraturës për dy çështje.

E para, depolitizimi total në përzgjedhjen e kandidatëve dhe formimi profesional. Se çfarë dalin më pas, kanë ardhur duke u përmirësuar. Madje, në mos gaboj, është vënë kriter edhe testi i inteligjencës. Kanë ardhur duke u përmirësuar edhe provimet, kanë filluar të bëhen me *scan-tron-ik*, në mos gaboj, që kur ka qenë Beni, nuk e mbaj mend mirë. Pra, ajo pjesë ka ardhur duke u përmirësuar, por në të gjitha vitet ka qenë ky parimi që prevalon. Racionale është edhe ajo që thuhet, që një profesor nuk mund të jetë anëtar i Gjykatës së Lartë. Kjo është çështje vendimmarrjeje politike, besoj unë, siç ka qenë gjithmonë. Ne kemi thënë se ai që do të bëjë interpretimin në Gjykatë Kushtetuese, nuk ka nevojë që të ketë qenë gjyqtar. Pra, atyre ua kemi lënë, ua kemi hapur 100%, le t'i marrin nga të duan, sepse ata që do të bëjnë interpretimin nuk do të bëjnë shkencë.

Në situatën që jemi tani, ne e kemi futur Gjykatën e Lartë brenda ombrellës së KLGJ-së, pra brenda ombrellës së karrierës, që deri dje nuk e kishim. Argumenti është deri diku edhe i saktë. Deri sa e kemi futur brenda sistemit të karrierës, unë mendoj se nuk duhet të vazhdojë më diskutimi për të marrë nga jashtë, sepse marrja nga jashtë ka rrezik të madh, që është ndërhyrja politike, pra, të futen nga xhepi. Cedojmë ndonjëherë te cilësia, por për

mua, më mirë një gjyqtar më pak i aftë, se sa një gjyqtar i kapur politikisht, është konsideratë personale. Prandaj synoj më tepër te kjo. Po nëse përsëri kjo çështje deri në ditën e fundit të miratimit të amendamenteve kushtetuese do të jetë *pending*, pra do të ngelet kështu, në qoftë se nuk do të ketë diskutime të tjera, unë do të propozoj që të mos jetë në kriter 1/5-ta e numrit të gjyqtarëve, por të jetë 1/5-ta e numrit të vendeve vakante, sepse kjo dritare, flas edhe nga eksperiencia, ka krijuar shpesh hapësirë për instruksionin që ka pasur mundësi për t'u futur nga brenda sistemit, 1/5-ën e numrit, 25% apo 45% të numrit.

Ne kemi futur shumë nga jashtë sistemit në Gjykatën e Lartë sot dhe nuk janë më të mirë se ata që janë nga brenda sistemit, as më profesionalë dhe as më pak të përfolur për korrupsion. Unë nuk i ndaj dot, nuk është se i njoh aq mirë, të mos i bie ndonjërit më qafë kot, por vendimet për lirim trafikantësh kanë dalë edhe nga njëra anë, edhe nga ana tjetër e me radhë gjithë të tjerët. Kështu që supozimi, që të vijnë nga jashtë është më mirë se të vijnë nga brenda, nga ana profesionale jo gjithmonë cedon, sepse ecën. Gjithsesi, do të bëja një propozim për të qenë pak më fleksibël, që të ishin nga 1/5-ta e numrit të vendeve vakante. Pra, do të jenë, për shembull, 5 vende vakante? Kur është 1, nuk ka, do të vijë nga brenda sistemit, sepse do të krijohet vazhdimisht një numër më i madh. Kur ka një, do të futet një nga brenda sistemit. Po u krijuan 5, një nga këta të pestë do ta zgjedhim nga jashtë sistemit, sepse po e lamë kështu, sa herë do të hapen 3 vende, do të themi: t'i mbushim vendet me vrap nga ata që janë jashtë sistemit. Kjo ka ndodhur dhe do të ndodhë.

Fatmir Xhafaj - Ne mund të vëmë një kufi, të themi se asnjëherë brenda gjykatës nuk duhet të jetë më shumë se kaq. Në qoftë se është 1/5-ta...

Eduard Halimi – Po, ju thoni të kemi përsëri 3 gjyqtarë. Në qoftë se janë 15...

Fatmir Xhafaj - 3 janë gjithmonë. Nuk ka vend? Lëreni!

Eduard Halimi – Kjo të jep mundësi, që në mbledhjet e para që do të bëhen të jenë nga 3 gjithmonë. Shikojeni, sepse kjo gjë mund të krijohet! Të shikohet nga ana e ekspertëve.

Fatmir Xhafaj – Krijon abuzim.

Eduard Halimi – Mundet që të mos jemi dakord për këtë. Unë këtë qëndrim kam pasur edhe në vitin 2008 me kolegët e mi, edhe në vitin 2013.

Lidhur me hyrjen nga jashtë Shkollës së Magjistraturës, ajo që tha Fatmiri është e zgjidhur, të vijnë, të konkurrojnë dhe të futen në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me problemin që mund të krijohet, siç thotë Fatmiri, nga vetingu, sipas të gjitha gjasave do të fillojë pas 3-4 muajsh, pra në shtator dhe do të zgjasë 5 vjet, siç e kemi parashikuar. Nuk besoj se vitin e parë të vetingut do të ikin 100 vetë, apo do të shkarkohen, sepse do të zgjasë 5 vjet, ka kohë për këtë gjë. Ndaj, propozimi mund të ishte që të gjenim për

sivjet dhe të hapen sa më shumë vende në Shkollën e Magjistraturës. Ne gjithmonë kemi hapur 4-5, ose 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edhe prokurorë.

Pse kam unë hallin e këtyre? Sepse duhet të prevalojë kriteri që ata të përzgjidhen në mënyrë strikte nga Shkolla e Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Të konkurrojnë nga shkolla.

Eduard Halimi – Po them e e di që ke besom, por mund të kem besim tek integriteti i shkollës, e kam thënë këtë gjë. Kam më shumë besim tek integriteti i zotërisë dhe i postit që mban. Domethënë, të hapen vende atje, të konkurrojnë që sivjet, kush ka ndërmend të konkurrojë, të konkurrojë tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Është 5 vjet. Vitin tjetër, në qoftë se krijohen vende vakante, ku e di unë, 40, 50, 60, shkolla hap 40 vende vakante. Le të jenë më mirë... Nuk kanë studentët... Shkolla e Magjistraturës vitin e tretë e ka vit stazhi, në mos gaboj, që i bie, ata që fillojnë sivjet, kur të jenë në vitin e dytë të vetingut, nëse kemi 5 vjet përpara, do të jenë në vitin e dytë aty. Ju japim të drejtë atyre që të vazhdojnë t'i gjykojnë çështjet, por filtrin e ruajmë dhe e kemi gjithmonë nga Shkolla e Magjistraturës. Ata do të jenë aty, të gjithë mund të venë të konkurrojnë. Sa më shumë të jenë, të bëjnë konkursin, le të jenë 30 vetë, le të jenë 40 vetë. Le të hapë shkolla ndonjë kurs tjetër, se nuk u bë kiameti. Na ikin 100 vetë... Ishalla ikin! Atëherë mblidhet Këshilli, në mos gaboj, gjyqësor, i thotë Shkollës së Magjistraturës: “Do të hapësh edhe kaq vende, nuk do ta hapësh vitin shkollor në shtator, por do ta hapësh në janar. Hajdeni dhe konkurroni të gjithë”. Zgjidhje të mos u jepet vetëm këtyre, por t'u jepet edhe atyre që kanë mbaruar jashtë, të konkurrojnë të gjithë. Shkolla e Magjistraturës mund të hapë një kurs të veçantë për një vit shkollor të veçantë, me 40 vetë apo me 50 vetë, sa të jetë nevoja, duke dhënë provim për 1 vit, ose 2 vjet, sipas parimit të Shkollës së Magjistraturës. Pra, ta mbajmë këtë sistem në qoftë se do të ndodhemi në një situatë kolapsi... Sepse në qoftë se ndodhemi, është logjike, racionale, ta kundërshtoj. Por ama jo t'i fusim nga jashtë, sepse po i futëm...

Fatmir Xhafaj – Po, edhe ata, them unë, kanë qenë...

Eduard Halimi – Ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët.

Fatmir Xhafaj – Edhe ata në Shkollën e Magjistraturës do të venë të japin provim...

Eduard Halimi – Jo, nuk kanë pse ta ngushtojnë te ish - gjyqtarët. Ju thoni se këta gjyqtarët i ushtrohen vetingut, po dolën këta, bëhen gjyqtarë...

Fatmir Xhafaj – Ndhmësit në Gjykatën e Lartë. Një njeri që ka ndenjur 7 vjet, është njësoj me atë që vjen nga bankat e shkollës?

Eduard Halimi – Le ta hapim, le ta lëmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nuk e dimë, nuk i njoh ndihmësit, të them të vërtetën.

Fatmir Xhafaj – Nuk i njoh as unë.

Eduard Halimi – Nuk e njoh rolin e tyre.

Fatmir Xhafaj – Jo, rolin e njoh.

Eduard Halimi – Ndhmësin e emëron ministri.

Fatmir Xhafaj – Në Gjykatën e Lartë?

Eduard Halimi – Në Gjykatën e Apelit.

Fatmir Xhafaj – Po them për në Gjykatën e Lartë.

Eduard Halimi – Do t'i emërojë ministri, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese i emëron gjykata ndihmësit e tyre.

Eduard Halimi – Ata le të jenë të barabartë me gjithë të tjerët, të shkojnë në shkollë, të konkurrojnë, të fitojnë dhe të vazhdojnë të bëhen gjyqtarë të përjetshëm, me integritet dhe me të gjitha, në qoftë se gjendemi në këtë kolaps, siç thoni. Pra, mblihet shkolla dhe hap vendet, jam dakord. Nuk jam që të bëjmë çështje që krijojmë racionalitet, këtë them. Unë e kam për 147/b atë që kisha.

Fatmir Xhafaj – Dakord. E mbyllim këtë?

(Diskutime pa mikrofon).

Oerd Bylykbashi – Çështja që unë ngrita më parë me gjysmë komenti, që ju thatë se mund të vendosim kufizime në lidhje me ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët, besoj se është një çështje që duhet trajtuar, duke vënë disa kritere për ata që do të rikthehen, sepse dikush mund të mos jetë më gjyqtar apo prokuror sot, sepse ndaj tij është marrë një masë administrative disiplinore.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, por duke mos e thënë këtë, siç mund ta ketë thënë në vend tjetër, dikush mund të interpretojë që në ligj ti ke vënë një kufizim, të cilin ai nuk e ka hequr.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord me ju.

Oerd Bylykbashi – I qëndroj asaj përtej çdo lloj, po themi... Nuk është shaka ajo që thashë, që sot mund të na kthehen në sistem gjyqtarë, të cilët kanë prodhuar dënime politike.

Po të lexosh rezolutën e Këshillit të Europës kupton se është kështu siç them unë. Megjithatë, unë besoj se kjo është çështje e rëndësishme.

E dyta, çështja e vlerësimit dhe e rivlerësimit të këtyre personave ka një problem. Në qoftë se unë e vlerësoj dhe e rivlerësoj një gjyqtar dhe një prokuror sot, desha të kuptoj se çfarë nënkuptohet me rivlerësim, sepse flasim për vlerësim dhe cili është rivlerësimi. Megjithatë, nuk ka rëndësi. Nëse një gjyqtar ose një prokuror unë kam ku ta mas, për t'i bërë vlerësimin e performancës, të pasurisë, këta që nuk janë gjyqtarë dhe nuk janë prokurorë, pra janë avokatë, supozojmë...

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk kanë pse të jenë avokatë.

Oerd Bylykbashi – Marrim një shembull.

Fatmir Xhafaj – Do të vejë në Shkollën e Magjistraturës, si të gjithë.

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk po flas për atë, por për rivlerësimin, sepse ai bëhet përpara, më pas bëhet Shkollën e Magjistraturës. Një avokat, i cili ka qenë avokat penalist, dikur gjyqtar apo prokuror, me vendimin e tij ka dalë nga sistemi, por ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me kriminelë, sepse i ka pasur klientë, ka pasur edhe komunikime telefonike, ka krijuar pasuri. Ose mund ta ketë shumë të thjeshtë të flasë për pasuri të krijuara, por që, në fakt, ka ricikuar pasuri eventualisht të krijuara në mënyrë të përkohshme ndërmjet korrupsionit, për të cilat ka thënë se i ka krijuar me të ardhurat e veta nga ky aspekt. Pra, nëse ne sot kemi me çfarë t'i masim një gjyqtar dhe një prokuror, për avokatët nuk na funksionojnë kriteret. Pra, duhet gjetur një zgjidhje në lidhje me këtë.

Fatmir Xhafaj – Ky është rasti i avokatisë.

Oerd Bylykbashi – Po marrim rastin e atyre që, në një mënyrë ose në një tjetër thonë: “Unë i kam bërë këto, por nuk i kam bërë në atë kohë”. Pra, nuk kemi si t'i masim këta, e para.

E dyta, u japim mundësinë që, nëpërmjet një trajnimit 1-vjeçar, siç thotë dispozita: “Ata emërohen gjyqtarë ose prokurorë”. Desha të di nëse kur flasim për një term të tillë, “emërohen” është automatike, apo është diskrecionale? Sepse me 1 vit pranimit në Shkollën e Magjistraturës, këta persona e paskan të thjeshtë të hyjnë në sistem. Ndoshta janë çështje të një karakteri teknik, por nuk kemi pse të lëmë gjëra, sepse kemi të bëjmë me prurjet që po na hyjnë në sistem: duhet të jenë nga politika, nuk duhet të jenë nga politika, duhet të jenë nga jashtë sistemit, duhet të jenë brenda sistemit. Pra, këtu mund të kemi probleme.

Çështja e fundit që dua të ngre, ndoshta ekspertët do t'i shikojnë këto elemente, është pika 2 e nenit 179/b-së, ku thuhet: “Subjektet e parashikuara në paragrafin 1, që përfundojnë me sukses procesin e vlerësimit dhe të rivlerësimit, konsiderohen gjyqtarë dhe

prokurorë të emëruar”. Pra, çfarë ndodh në këtë situatë? Këta janë shkarkuar për shkak të ligjit, pra të Kushtetutës në momentin kur u filloi vetingu dhe vetëm, pasi e kalojnë këtë, konsiderohen të emëruar, apo janë sot e kësaj dite të emëruar dhe në momentin kur e superojnë me sukses, vazhdojnë sikur nuk ka ndodhur gjë dhe, kur nuk e kalojnë, ikin? Pra, ç’është ky term “konsiderohen të emëruar”? Çfarë ishin deri në atë moment?

Kjo histori është sa teknike, aq e rëndësishme në sistem. Ju lutem, merreni parasysh. Pra, ne po u ndërpresim mandatin gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve sot.

Fatmir Xhafaj – Jo.

Oerd Bylykbashi – Dakord. Unë me kaq e mbylla. Kjo ishte pika e fundit që kisha.

Eduard Halimi – Jo, këta quhen menjëherë të emëruar gjyqtarë, më pas quhen prokurorë. E thashë: “të bëjnë një trajnim në Shkollën e Magjistraturës”.

(Diskutime pa mikrofon).

Problemi që kemi ne është 179/b, pika 2: “Subjektet e parashikuara, pasi e kalojnë me sukses procesin e vetingut, konsiderohen gjyqtarë dhe prokurorë të emëruar”. Pra, këta që mund të kenë qenë ish-gjyqtarë.

Fjalja e dytë është: “Subjektet, që sipas këtij paragrafi, nuk ushtrojnë detyrën e gjyqtarit dhe prokurorit (që mund të jenë këshilltarë ish - gjyqtarët, ish - prokurorët, e të tjerë) konsiderohen menjëherë”. Pra, këta që nuk e ushtrojnë, emërohen gjyqtarë dhe më pas ndjekin një trajnim 1-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të këtij ligji. Pas përfundimit me sukses të trajnimit, emërohen gjyqtarë dhe prokurorë.

Tani, këta nuk mund të emërohen gjyqtarë dhe prokurorë, por duhet të saktësohet në qoftë se do të biem dakord për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Duhet saktësuar.

Eduard Halimi - Këta nuk futen si gjyqtarë, por duhet të konkurrojnë në Shkollën e Magjistraturës, si gjithë të tjerët; të fitojnë dhe të vazhdojnë, nuk i përjashtojmë ata, të hyjnë në procedura normale dhe Shkolla e Magjistraturë, siç e thashë, që e ka vitin e III-të praktikë, t’i fusin në sistem. Edhe kur kemi qenë ne është bërë, sepse kishte mungesa dhe na futën të gjithëve nëpër çështje më ’99. U bë konkursi dhe ikën, por meqenëse ndodhi kjo, studentët e Magjistraturës u futën me fuqi të plotë, punonin dhe i merrnin të gjitha çështjet, ato 2-3 muaj, aq sa ishin në atë kohë. Pra, le të përdoren nëse krijohen vende, por jo të bëhen automatikisht. Për këtë gjë biem dakord që të shkojmë.

Fatmir Xhafaj – Ta shikojnë dhe të na thonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E mbajtëm shënim.

Oerd Bylykbashi – Po përsëris të njëjtën gjë: midis momentit të fillimit të vetingut dhe momenti të mbarimit të vetingut, cili është statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve? Sepse fjalia e parë e pikës 2 nënkupton se këta janë gjyqtarë dhe prokurorë pasi kanë kaluar procesin e vetingut. Është pikëpyetje që mund të vërë në dyshim funksionimin e gjykatave në të gjithë Shqipërinë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Atëherë, e mbyllim për sot këtu dhe nesër takohemi në orën 10:30.

Faleminderit, të gjithëve, në mënyrë të veçantë zonjave që janë në përkthim!

Natën e mirë!

MBLEDHJA MBYLLET